

# DITURIA ISLAME

*O Allah,  
Ti je Falës, e do faljen,  
na fal ne!*



## URIMI I MYFTIUT NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E FILLIMIT TË MUAJIT TË BEKUAR RAMAZAN

Të nderuar vëllezër e motra,  
Të dashur qytetarë!

Nesër fillon muaji i bekuar Ramazan, muaji i agjërimit, i mirësisë dhe i faljes. Çdo vit, të gjithë ne e presim këtë muaj me padurim, ngase Zoti na ka nderuar me të. Është muaj në të cilin me të madhe përçohen mesazhe urimi e përgëzimi, është muaj i lutjeve dhe adhurimeve, ku shtohen dashuria për fenë dhe Zotin, muaj me mirësi dhe begati më të shumta seç dikush mund t'i numërojë. Është muaj në të cilin besimtari i sinqertë, përmes agjërimit, synon përsosjen e tij morale dhe etike, synon ngritjen e nivelit të solidaritetit material në pikat më të larta, muaj që me veprat dhe përkushtimin e lartë, synon lehtësimin e rrugës së besimtarit për në Xhenet.

Në çdo Ramazan, ne mbushemi me më shumë shpresë e dhembshuri, ngase ky është një muaj i bujarisë dhe mirësisë, një muaj madhështor në të cilin përkushtimi dhe devotshmëria shtohen dhe besimtarët ndjejnë gëzim edhe më të madh në zemrat dhe shpirtrat e tyre, muaj i cili edhe më shumë na bashkon dhe na e forcon unitetin ndërmjet nesh.

Ramazani vjen për t'i rikthyer shpirtrat e uritur në tryezën e Mëshirëplotit, për të futur mëshirë dhe devotshmëri në zemra, për të forcuar krijesën njeri me durim, qëndresë, vullnet, bujari e vendosmëri, për t'i rrënjësuar në kraharorët e fëmijëve tanë dashurinë, bindjen dhe besimin në Zotin e Madhëruar.

Muaji i bekuar Ramazan është muaj që Zoti xh.sh. e veçoi nga muajt e tjerë të vitit, duke e dalluar atë me virtyte të larta dhe mirësi të pakufishme. Në Ramazan, që me të drejtë quhet zotëria i muajve të tjerë, përmes melekut Xhibril, tek i Dërguari Muhamed a.s., u zbrit edhe shpallja fisnike, siç Zoti xh. sh. e thotë: "Muaji Ramazan është muaji në të cilin zbriti Kurani, udhërrëfyes për njerëzit."

Në Ramazan, bashkë me Kuranin, zbriti dhe zbret mëshira, shumëfishohen



shpërblimet e veprave dhe punëve të mira, falen mëkatet dhe veprat e liga, hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen ato të Xhehenemit.

Ramazani, përveçse është muaj kur shpallja e qiellit ndriçoi errësirën e tokës, është gjithashtu edhe një epokë e re në të cilën njerëzimi mori mesazhet e fundit nga Zoti, mesazhe këto që përfaqësojnë një pikë kthese në rrugën e njerëzimit.

Është muaji agjërimit që konsiderohet një nga pesë shtyllat e Islamit, pasi besimtarët abstenojnë nga ushqimi dhe pija dhe qëndrojnë larg nga gjërat e ndaluara nga agimi deri në perëndim.

Agjërimi është një adhurim specifik që bëhet vetëm për Zotin xh.sh., është një nga veprimet më të mëdha të afërsisë, është praktikë e të drejtëve dhe simbol i të devotshmëve, pastron shpirtin dhe përsosë karakterin, është shkolla e devotshmërisë dhe vendbanimi i udhëzimit. Kushdo që hyn në këtë muaj me qëllim të sinqertë dhe duke e ndjekur rrugën e drejtë, do të dalë prej tij me një dëshmi të drejtë dhe do të jetë me të shpërblyerit në këtë dhe në botën tjetër.

Të nderuar vëllezër e motra,

Në këtë natë të madhe dhe në këtë atmosferë hyjnore, ftoj besimtarët tanë kudo që janë, që këtij muaji të bekuar t'i përkushtohen me bindje, adhurim, sinqeritet dhe solidaritet, duke i ruajtur

e kultivuar lidhjet familjare dhe duke e shtrirë dorën e ndihmës ndaj të varfërve dhe skamnorëve, duke thirrur në forcim të unitetit dhe vëllazërisë dhe duke refuzuar të gjitha format e ndasisë dhe përçarjes ndërmjet vete.

Përmbajuni porosive të Zotit xh.sh. dhe të Muhamedit a.s., të dijetarëve të mirëfilltë dhe institucioneve fetare islame në shtetin tonë, e mos i kushtoni vëmendje thirrjeve devijuese nga njerëz të papërgjegjshëm e të pandërgjegjshëm!

Të nderuar vëllezër e motra,

Njerëzit në nevojë janë amaneti i Zotit mbi supet tona, mos i privoni ata nga të drejtat e tyre në pasurinë tonë që Zoti na e dhuroi! Ndhmoni dhe mbështetni ata duke e ruajtur krenarinë dhe dinjitetin e tyre!

Lutemi që i Plotfuqishmi ta pranojë agjërimitin dhe lutjet tona, t'i japë kombit, shtetit e fesë sonë, siguri dhe stabilitet! Lutemi që konfliktet, luftërat dhe gjakderdhja ndërmjet njerëzve pa dallim race, ngjyre, feje apo kombi, të marrin fund!

Zoti xh.sh. na bekoi dhe na nderoi që e arritëm këtë muaj, andaj, lutemi që, o Zot ashtu siç na begatove me Islamin fe, në muajin Ramazan, të na dhurosh mëshirën dhe faljen Tënde në të dy botët!

*Myftiu Naim ef. Tërnavë  
Prishtinë, 10.03.2024*

**EDITORIAL**

4 Sihariqet e agjëruesve në vigjilje të festës së Bajramit

**FETARE**

5 Nata e Kadrit në dritën e kaptinës El-Kadër  
Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

9 Ramazani dhe shpresa e formimit të myslimanit shëmbëlltyrë  
Mr. Vedat Shabani

13 Besimtari dhe mirësia e tij e përhershme  
Isa Tershani

16 Namazi i bajrameve dhe normat juridike islame  
Dr. Flamur Sofiu

19 Virtytet e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të  
Fitim Flugaj

23 Vëllazëria islame në periudhën medinase dhe mësimet për kohën tonë  
Suhejb Hashani

26 Etika dhe tregu  
Dr. Zenel Hajdini

29 Doracakët më të njohur të Fikht Hanefi (5)  
Hazir D. Selmani



**KULTURË**

33 Efektet shëndetësore pas agjërimit të Ramazanit  
Dr. Edita Blaka

35 Materiet ushqyese  
Dr. Agron M. Rexhepi

41 Sami Frashëri, një erudit dhe enciklopedist i përmasave botërore  
Mimoza Sinani

45 Kontributi i librit "Siaset Nameh" në fushën e administrimit  
Klodiana Xhaferraj

**HISTORI & CIVILIZIM**

48 Medresetë osmane përgjatë historisë  
Agon Krasniqi



52 Amalekitët - armiqtë e përjetshëm të izraelitëve<sup>1</sup>  
Prof. dr. Nuh Arslantaş

**PERSONALITETE**

55 80 vjet nga vdekja e hafëz Abdullah ef. Telakut (1896-1943)  
Faik Miftari

**AKTIVITETE**

57 Myftiu Tërnavë priti në takim zëvendësministrin e Jashtëm të Turqisë, z. Yasin Ekrem Serim



**DITURIA ISLAME**

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 401 • viti 37 • Prill 2024

• Ramazan / Sheval 1445

• çmimi 1 €

**Boton**

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

**Redaksia**

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:

Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,

Mr. Muharrem Tërnavë,

Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

**Adresa**

"Dituria Islame",  
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024

E-mail: redaksia@dituriaislame.net

www.dituriaislame.net

Shtypi:

IliriPrinti, Prishtinë



*“...në këtë muaj është një natë që ka vlerë më të madhe se një mijë muaj të tjerë, e kush privohet nga mirësitë e saj, ai vërtet është i privuar.”*

*(Muhamedi, a.s.)*

## Sihariqet e agjëruesve në vigjilje të festës së Bajramit

Premtimet hyjnore të Allahut të Lartëmadhëruar për mbulimin e agjëruesve me bekime e mirësi mbesin shtytësit kryesorë që i bëjnë ata të garojnë me vepra të mira pa ndalur gjatë gjithë muajit Ramazan. Shtegu fisnik i garës së virtyteve në këtë muaj, si kurrë njëherë më parë mbushet me aspiruesit e faljes e amnistisë së Zotit Fuqiplotë. Asnjëri nga ta nuk dëshiron që të hyjë në një muaj brenda së cilit është një natë më e vlefshme se sa një mijë muaj – nata e Kadrit – e të mos arrijë diçka nga vlerat e saj. Privimi nga mirësitë e bekimet e muajit Ramazan, në përgjithësi, e të Natës së Kadrit, në veçanti, është privimi më brengosës për një besimtar vizionar. Andaj, në këtë sens duhet kuptuar edhe ato fjalë që na i drejtoi i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. kur tha: “...në këtë muaj është një natë që ka vlerë më të madhe se një mijë muaj të tjerë, e kush privohet nga mirësitë e saj, ai vërtet është i privuar.” (Nesaiu, 2106; Imam Ahmedi, 7148). Ne, me agjërimin tonë, abstenojmë nga gjëra të nevojshme në një segment kohor të përbalueshëm, me shpresën që ky privim të mos mbetet thjesht një privim yni fizik, pra i pa shoqëruar me ndryshime substanciale në karakterin tonë. Ky abstenim, që nuk bënë diferencën në mes ditëve para Ramazanit dhe atyre brenda dhe pas tij, nuk mëton të realizojë synimet fisnike të një ibadeti hyjnor që Ligjvënësi i Urtë na ka ngarkuar me të. Xhabir ibën Abdullahu r.a. thoshte: “...mos e bëjë ditën tënde të agjërimit të mbetet e njëjtë me ditën tënde që nuk je agjërueshëm...”. S’mund të fliste ndryshe ai që u edukua nga edukata profetike e Muhamedit a.s.. Ai dhe të tjerët nga shokët e tij fisnikë dëshmuar se kurrë në jetën e tyre nuk janë mjaftuar me gërvishtjen e lehtë në koren e kuptimësive të ibadeteve islame. Ata lëvronin thellë në urtësitë dhe porosinë madhështore, dhe nga të tillat hulumtime gjithnjë dilnin të furnizuar me urtësi e dobi që ata i kishin përfituar.

Vazhdimi i trendit të nëpërkëmbjes së porosive të Zotit Fuqiplotë dhe mosgatishmëria për t’u larguar nga traseja e mëkatimit ndaj Tij nuk janë pritjet e aspiruara nga asnjëri prej nesh. Për më tepër, ky është një ogur jo i mirë dhe tregon se të tillët agjërues, për mëri të fatit, qenkan mjaftuar me urinë e etjen si arritje të shënuar nga ajo sakrificë, që do të duhej të kishte tjetër qëllim. Kjo ngase, nëse ritualet fetare islame nuk kanë produkt të natyrshëm të vetin sjelljen e mirë dhe transformimin pozitiv brenda njeriut, ato mbesin pa shije dhe s’kryejnë funksionin për çka janë destinuar.

Një besimtar i mirëfilltë, që thesarin e veprimtarisë së tij gjatë Ramazanit e ka të mbushur me namaz, lutje, agjërim, sadaka, bamirësi, shtruarje të iftareve, fuqizim të lidhjeve familjare e farefisnore, buzëqeshje në fytyrën e vëllait, etj., i tilli është njeriu më i denjë që meriton t’i gëzohet arritjes së festës së Bajramit të Fitrit. Ai që ka çiltërsuar shpirtin e tij në këtë muaj dhe ka arritur të gdhendë në shpirtin e tij virtytet e përsosura morale në këtë muaj, i tilli është triumfuesi i vërtetë. E zezë mbi të bardhë është thënë në ajetin kuranor: “Me të vërtetë ka shpëtuar (do të jetë i lumtur), ai që e pastron atë (shpirtin). Dhe, me të vërtetë do të zhgënjehet ai që e ka lajthitë atë (shpirtin)!” (Esh Shems, 9-10).

Të dalësh në festën e Bajramit, duke e përjetuar një paqe të munguar me vetveten, por dhe duke dhuruar rehati, paqe e siguri për të gjithë njerëzit që ty të rrethojnë, kjo po që është fitorja më e madhe që neve na është premtuar. Ç’lumturi mund të ndiej njeriu në ditën e Bajramit, nëse në rrethin e tij shoqëror nuk ka luajtur asnjë rol për t’ia tejkaluar një brengë një njeriu të sprovuar. Apo, nëse nuk ka shprehur gatishmëri që të harrojë e të falë keqberjen e mizorinë e tjetrit që në lëkurën e tij ai e ka përjetuar. E nëse faljen e Zotit dhe mëshirën e Tij e shpresojmë, ne duhet që këto dy tipare, së pari ne vetë t’i aplikojmë me të tjerët.

E kështu, ai që amnistinë e Zotit në këtë muaj ka rritur ta fitojë, i tilli është i denjë që Ditën e Bajramit me ngazëllim e lumturi edhe ta festojë.

*Mr. Driton Arifi*

# Nata e Kadrit në dritën e kaptinës El-Kadër

(EKZEGJEZA ANALITIKE E KAPTINËS EL KADËR)

Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

Kjo kaptinë, duke promovuar besimin, paqen, mëshirën për gjithë botën dhe njerëzimin, manifeston mirëqenie dhe harmoni të shpirtave dhe largim të mbarë shoqërisë nga të ligat.

Kaptina El Kadër, e cila në radhitjen Kuranore zë vend në xhuzin e fundit të Kuranit, respektivisht si kaptina e nëntëdhjeteshtatë e tij, shtjellon tematikën e natës më të begatë dhe të dalluar të vitit, natës së Kadrit, në të cilën zbriti Kurani, thekson vlerën e saj, mëshirën që e shtrin Zoti i Madhërishëm dhe zbritjen e engjëjve në të. E zbritur në Meke, kjo kaptinë e shkurtër, por e një rëndësie të veçantë, përbëhet nga vetëm pesë ajete, që është veçori e kaptinave mekase. Kjo kaptinë, duke promovuar besimin, paqen, mëshirën për gjithë botën dhe njerëzimin, manifeston mirëqenie dhe harmoni të shpirtave dhe largim të mbarë shoqërisë nga të ligat.

## LIDHMËRIA E KËSAJ KAPTINE ME KAPTINAT E TJERA

Lidhmëria mes kaptinave është një interpretim i përgjithshëm i Kuranit, i cili jep një shembull të mirë në aspektin e harmonisë kuranore. Nga ky aspekt shihet se edhe kaptina El Kadër përmban një lidhmëri të ngushtë me disa kaptina të tjera kuranore. Lidhmëria e saj me kaptinën paraprake, kaptinën Alek, kuptohet nga fakti se në kaptinën paraprake, Zotit i Madhërishëm e urdhëroi Pejgamberin a.s. që të lexonte Kuranin në emër të Zotit të tij, ndërsa në fillim të kaptinës El Kadër përmend momentin e shpalljes së Kuranit në natën e Kadrit si një natë me vlerë të lartë, e të veçantë nga çdo natë tjetër.<sup>1</sup> Në të njëjtën kohë, kaptina Alek, duke

zënë vend para kaptinës El Kadër, mbështet faktin që në ajetin e parë të kësaj kaptine: “Ne e zbritëm atë në natën e Kadrit” edhe pse nuk është përmendur Kurani me emër të veçantë, megjithatë përemri “atë” ka për qëllim vetë Kuranin, kuptimi i të cilit mund të jetë: “Lexo Kuranin, të cilin e kemi zbritur në natën e Kadrit dhe fuqia e të cilit është e lartësuar.”<sup>2</sup> Po ashtu përfundimi i kaptinës Alek me frazën: “Vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit me të”<sup>3</sup>, vë në pah harmoninë në mes të këtyre kaptinave, ngase në kaptinën El Kadër flitet mbi natën e begatë që qëllimi i saj është afrimi dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit duke bërë ibadete të shumta që përfshijn edhe sexhden.

Sa i përket kuptimit dhe përmbajtjes, shihet se kaptina El Kadër për nga qëllimi ka një lidhje të ngushtë dhe të pathyeshme edhe me kaptinën që zë vend pas saj në radhitjen kuranore atë Bejjineh. Në kaptinën El Kadër duke theksuar se shpallja e Kuranit, pasqyron mëshirën e Allahut ndaj njerëzve, shpëtimin e tyre, dhe në mënyrë indirekte shpreh faktin se kthimi me besim te libri dhe profeti i fundit është gjithashtu një ndjenjë absolute e mëshirës dhe e shpëtimit, kaptina Bejjineh, këto tematika i shqyrton në mënyrë të detajuar duke treguar se Muhamedit a.s. i erdhi Kurani, që ta kumtonte atë.<sup>4</sup> Kaptina Bejjineh, ashtu siç nënkuptohet edhe nga vetë emri i saj, kaptina e argumentit të prerë, mund të thuhet është si një kaptinë sqaruese e kaptinës El Kadër.



### KUPTIMI I NATËS SË KADRIT

Shprehja El Kadër në leksik përmban kuptimin e fuqisë, aftësisë, sasisë, gjykimit, vlerës, nderit dhe madhësisë, ndërsa në aspektin terminologjik, paraqet një natë të veçantë, të dalluar, madhështore, të nderuar, të lartë dhe si një mundësi për vlerësim.<sup>5</sup>

Nata e Kadrit e përmendur në kaptinë El Kadër, është prej netëve që e dallon muajin e bekuar Ramazan dhe ia shton edhe më shumë vlerën këtij muaji të bekuar. Ajo dallohet nga çdo natë tjetër, ngase në këtë natë Zoti i Madhërisëm e zbriti Kuranin, fakt ky që evidenton edhe vetë fillimi i kaptinës ku thuhet: “Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit.” Interpretuesit e Kuranit janë unanim se përemri “atë” në këtë ajet ka për qëllim Kuranin, madhështia e të cilit nënkuptohet edhe pa e përmendur me emër të veçantë, dhe se zbritja e tij i takon vetëm Allahut të Lartësuar.<sup>6</sup> Kurse komentatori Zemahsheri, në interpretimin e ajetit në fjalë, thekson se i Gjithmëshirshmi e lartësoi Kuranin në tri aspekte: Së pari, atë, ia atribuoi vetes së Tij dhe me këtë e bëri të qartë hyjnitetin e Kuranit. E dyta, përdori përemër pa cekur emrin, si dëshmi e madhësisë së tij që nuk ka nevojë për theksim. E treta, lartësoi dhe nderoi kohën kur u shpall ai, pra natën e Kadrit.<sup>7</sup> Dijetarët janë ndarë në disa qëndrime rreth momentit të zbritjes së Kuranit në këtë natë, e në lidhje me këtë, qëndrimi më i saktë është ai që transmetohet nga Ibën Abasi, i cili ka thënë: “Në Natën e Kadrit, Kurani famëlartë, ka zbritur komplet prej Levhi Mahfudhit në

Nata e Kadrit e përmendur në kaptinë El Kadër, është prej netëve që e dallon muajin e bekuar Ramazan dhe ia shton edhe më shumë vlerën këtij muaji të bekuar.

qiellin e kësaj bote, dhe pastaj prej aty, i është shpallur Muhamedit a.s. pjesë-pjesë për 23 vjet.”<sup>8</sup>

Më pas rrëfimi në këtë kaptinë vazhdon me pyetjen e parashtruar Pejgamberit a.s: “E ç’të bëri ty të dish, se ç’është Nata e Kadrit?” Dijetarët potencojnë se kjo lloj forme e shprehjes është një mënyrë inkurajuese për të treguar madhësinë e natës së Kadrit, sikurse të ishte thënë: “Çfarë është ajo që ju njofton për vlerën dhe epërsinë e kësaj nate?” Qëllimi i kësaj është të vë në dukje madhësinë, vlerën dhe virtytin e kësaj nate dhe të theksojë se njohuritë njerëzore nuk janë të mjaftueshme për ta perceptuar atë, po ashtu edhe mendja nuk mund të arrijë të konceptojë ngjarje të tilla pa u mbështetur në shpallje. Sidomos kur bëhet fjalë për një skenë që lidhet me metafizikën, mendja njerëzore dhe shkenca janë të pamjaftueshme në konceptimin e saj. Si rrjedhojë, mund të thuhet se këtu ka një argument të prerë si për Kuranin që është zbritur nga Zoti Fuqplotë, ashtu edhe për madhësinë, nderin dhe fuqinë e natës kur u shpall ai. Andaj është njohur si “lejletu’l-Kadër/nata e Kadrit”. Në lidhje me këtë, Raziu, thekson se kjo natë njihet si nata e Kadrit, ngase libri më madhështor, Kurani, zbriti mbi të dërguarin më madhështor, Muhamedin a.s., me gjuhën e një engjëlli të fuqishëm. Këtë e dëshmon edhe vetë përsëritja e fjalës “Kadër” tri herë në këtë kaptinë.<sup>10</sup>

Sejjid Kutub duke iu qasur këtij vargu kuranor me një qëndrim sociologjik, përmend se kjo është nata në të cilën vendosen



Paralajmërimi në këtë ajet qëndron në faktin se jo vetëm veprat e mira dhe adhurimet numërohen shumëfish, por edhe mëkatet e bëra në këtë natë do të shkruhen si shumëfishta.

vlerat, parimet dhe përcaktohet fati i individëve, madje edhe i kombeve dhe i shteteve.<sup>11</sup> Pra është quajtur Nata e Kadrit, ngase në këtë natë Zoti i Madhërishëm cakton rrëskun, gjërat që do të ndodhin, të mirën dhe të keqen, veprat e njerëzve etj.. Disa prej dijetarëve theksojnë gjithashtu se Nata e Kadrit e mori këtë emër nga pozita e saj e lartë, ose nga pozita e lartë e atij që ngjallë këtë natë me adhurime, sepse veprat që bëhen në këtë natë janë më me vlerë se veprat që bëhen në një mijë net të tjera dhe zënë pozitë të lartë te Krijuesi.<sup>12</sup>

### NATË E MADHËSHTISË DHE NDERIT

Zoti i Madhërishëm njohurinë dhe vlerën mbi Natën e Kadrit e shpreh duke thënë: “Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!”, që lë të kuptohet se adhurimi dhe namazi i kryer në këtë natë do të jetë më i vlefshëm se një mijë muaj, si dhe ata që bëjnë adhurime me bindje në këtë natë do të jenë të nderuar. Sipas Raziut, ky

varg kuranor, përveç që përçon një lajm të mirë, shpreh edhe një paralajmërim. Lajmi i mirë është se i Gjithëmëshirshmi thekson se kjo natë është një natë madhështore pa deklaruar shumën e shpërblimit që do të japë. Kushdo që e gjallëron këtë natë me namaz dhe ibadete do të jetë sikur të ketë adhuruar Atë mbi tetëdhjetë e tre vjet, dhe ai që e përtërinë atë çdo vit, do të ketë jetuar shumë jetë. Paralajmërimi në këtë ajet qëndron në faktin se jo vetëm veprat e mira dhe adhurimet numërohen shumëfish, por edhe mëkatet e bëra në këtë natë do të shkruhen si mëkate të shumëfishta.<sup>13</sup>

Vlera e kohës përcaktohet nga ngjarje të rëndësishme që ndodhin brenda saj. Nata e Kadrit është një ndër netët e bekuara të muajit Ramazan, e cila gjendet në dhjetëshen e fundit të tij dhe dëshmon mëshirën e të Gjithëdijshmit mbi robërit e Tij besimtarë, të cilët i nënshtrohen me sinqeritet vullnetit të Tij dhe kërkojnë mënyrat për t’iu afruar Atij. Ajo promovon mirësi dhe bekime që nuk gjinden në një mijë muaj dhe shpërblim që besimtarët e denjë të popujve të mëhershëm mund ta arrinin vetëm me adhurim të vazhdueshëm gjatë jetës së tyre duke qenë se jetonin më gjatë.<sup>14</sup> Në lidhje me këtë, në një hadith të Pejgamberit a.s. thuhet: “Ju erdhi muaji Ramazan, muaj i bekuar. Allahu xh.sh. ua ka bërë detyrim agjërimin e tij. Në këtë muaj hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangohen djajtë. Në këtë muaj është një natë më e vlefshme se një mijë muaj; ai që privohet nga kjo natë, ai është privuar nga mirësi të shumta.”<sup>15</sup> Andaj besimtarët nuk duhet të jenë indiferentë dhe të paditur nga vlerat e kësaj nate, përkundrazi duhet ta kërkojnë atë me anë të ibadeteve dhe kërkimfaljes.

Rrëfimi mbi cilësitë e kësaj nate në kaptinën El Kadër vazhdon: “Me lejen e Zotit të tyre zbresin engjëjt dhe shpirti për secilën çështje.” Dijetarët pohojnë se shprehja “Ruh/shpirt” në ajetin kuranor nënkupton Xhibrilin, ngase në shumë ajete kuranore ky engjëll i madh përmendet si “ruh/shpirt”, ndonjëherë “ruhu’l-kudus/shpirt i shenjtë”, nganjëherë dhe si “ruhu’l-emin/shpirti besnik”.<sup>16</sup> Po ashtu, nocioni “ruhu’l-kudus” është i përmendur edhe në disa hadithe të Pejgamberit a.s..<sup>17</sup>

Ibën Kethiri, në interpretimin e këtij vargu kuranor, sqaron se në këtë natë të bekuar shtohet zbritja e engjëjve për shkak të shtimit të bereqetit të kësaj Nate. Ata zbresin me begati dhe mëshirë, ashtu sikurse zbresin kur lexohet Kurani, si dhe qarkojnë grupet e njerëzve që e përmendin Allahun dhe i lëshojnë krahët e tyre në shenjë madhërimi dhe respekti për atë që kërkon dijen e vërtetë.<sup>18</sup> Pra, në këtë natë, me urdhrin e Zotit, zbresin në tokë engjëjt me detyra të ndryshme, e në krye të tyre zbret edhe vetë engjëlli më i madh, Xhibrili. Disa nga to i vrojtojnë punët e besimtarëve dhe ibadetin e tyre në këtë natë, duke u lutur për ta, kurse ca të tjerë merren me zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Zoti për realizimin e shumë gjërave që kanë të bëjnë me njerëzit. Kjo do të thotë

se ata, me urdhrin e Zotit, i marrin shënimet e shkruara në “Levhi Mahfudh” për gjërat që duhet të realizohen (materializohen) gjatë një viti në sferën e rrëskut, ngjarjeve dhe afateve të lindjeve e të vdekjeve.<sup>19</sup>

### NATË E PAQES DHE MIRËSISË

Në vazhdim të rrëfimit, Zoti i Madhëruar, përshkruan rezultatit e zbritjes së engjëjve në krye me Xhibrilin si vijon: “Ajo është paqe deri në agim të mëngjesit.” Kjo natë është një natë paqeje ku nuk do të ndodhin gjëra të dëmshme dhe gjëra që nuk do t’u sjellin dobi besimtarëve. Sipas një transmetimi kjo natë njihet si nata e shpëtimit që nga fillimi deri në mbarim të saj, sepse shejtanët nuk do të mund të bëjnë asgjë të keqe, ajo është plotësisht mirësi.<sup>20</sup> Sejjid Kutub, sqaron se në mëngjesin e Natës së Kadrit, si rezultat i shpalljes së Kuranit, dielli përmban një ndriçim në harmoni me dritën e shpalljes dhe të engjëjve, dhe se kjo dritë është drita që përhapet në shpirtrat që enden në sferën e ekzistencës.<sup>21</sup> Se kur bie kjo natë, nuk dihet me saktësi, mirëpo duke u bazuar në fjalët e Krijuesit: “Muaji Ramazan (është muaj) në të cilin filloi të (të shpallej) Kurani...”,<sup>22</sup> kuptohet se kjo natë është njëra prej netëve të muajit të begatë Ramazan, ndërsa i Dërguari i Allahut, na ka bërë me dije se kjo natë është njëra prej netëve tek të dhjetë netëshit të fundit të Ramazanit.

Dijetarët po ashtu janë të pajtimit se e tërë urtësia në mos përcaktimin e kësaj nate nëpër netët e Ramazanit është që besimtari të shtojë ibadetin e tij gjatë tërë kohës, duke kërkuar njëherësh që besimtarët të tregojnë qëndrueshmëri në adhurime, lutje dhe sakrificat e tyre, dhe të shtojnë përpjekjet për të fituar mirësinë dhe kënaqësinë e Plotëfuqimshmit. Po të mos ishte kjo natë e fshehtë dhe e ditur saktësisht, ndoshta njerëzit do të përpqeshin të bënin adhurim vetëm në këtë natë, dhe pastaj në netët e tjera apo gjatë tërë vitit do të mos kujdeseshin për namazin dhe adhurimin e tyre aq shumë, me çka do të humbte ekuilibri i arsyes në ibadete. Ebu Hanifë, thekson se Nata e Kadrit nuk është vetëm në disa net të caktuara, por çdo natë brenda treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditëve të vitit, nëse gjallërohen me ibadete ashtu siç

e meritojnë, me lutje dhe sakrificë, atëherë në të gjitha këto net, Zoti i Madhërishtëm do të dërgojë shumë mirësi dhe begati ndaj besimtarit. Në një hadith të Pejgamberit a.s. thuhet: “Vepra më e virtytshme tek Allahu është ajo që është e vazhdueshme, qoftë edhe e vogël.”<sup>23</sup> Çdo natë e vitit dhe e tërë jetës se besimtarit duhet të vlerësohet dhe të gjallërohet sikurse të ishte Nata e Kadrit.

Zoti i Madhërishtëm e krijoi njeriun si qenien më me vlerë, e çmoi duke e dalluar nga të gjitha krijesat e tjera, atij i dhuroi një natë të veçantë, pra Natën e Kadrit. Nata e Kadrit është natë ku feja islame u promovua përsëri në tokë. Nga ky këndvështrim, ajo duhet të jetë një pikë kthese në jetën e myslimanit, të mos jetë një natë e zakonshme dhe të mos kalohet vetëm me disa adhurime të zakonshme. Gjëja më rëndësishme këtu është të gjallërohet kjo natë me ibadete dhe lutje, por dhe e gjithë jeta e besimtarit të jetë në përputhje me këtë natë.

- 1 El Bikai, *Nazmu'd-Durrer*, Egjipt, XXII/177.
- 2 Alusi, *Ruhu'l-Meani*, Bejrut, 1415/1995, XV/411.
- 3 Alak 96/19.
- 4 El Bikai, *Nazmu'd-Durrer*, XXII/185.
- 5 Ibën Mandhur, *Lisanu'l-Arab*, Bejrut, 1414 h., V/76-79.
- 6 Shevkani, *Fethu'l-Kadir*, Bejrut 1414 h., V/575.
- 7 Zemahsheri, *el-Keshshaf*, Bejrut 1407 h., IV/780.
- 8 Ibën Kethir, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, III/659.
- 9 El Hazin, *Lubab-Te'vil fi Meani'l-Tenzil*, Bejrut, IV/450.
- 10 Razi, *Mefatihul-Gayb*, XXIII/281.
- 11 Sejjid Kutub, *Fi Dhilali'l-Kur'an*, VI/3945.
- 12 Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, XXIV, 533.
- 13 Razi, *Mefatihul-Gayb*, XXIII/286.
- 14 Malik, *Muvatta*, Itikaaf, 15.
- 15 Nesai, *Mesaxhid*, 24.
- 16 Bakara, 2/87; Maide, 5/110; Nahl, 16.2.102; Gafir, 40/15; Mearic, 70/4; Nebe, 78/38.
- 17 Buhari, Salat, 68, *Edeb* 91; Muslim, Fedhaili-i Sahabe 151,153.
- 18 Ibën Kethir, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, IV, 568.
- 19 Sabri Bajgora, *Komentimi i Kaptinës el-Kadër*.
- 20 Ibën Kethir, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, VIII/4-44-445.
- 21 Kutub, *Fi Dhilali'l-Kur'an*, VI/3945.
- 22 Bekare, 2/185.
- 23 Buhari, Rikak, 18; Muslim, Salatu'l-Musafirin, 216.

Urtësia në mos përcaktimin e kësaj nate nëpër netët e Ramazanit është që besimtari të shtojë ibadetin e tij gjatë tërë kohës, duke kërkuar njëherësh që besimtarët të tregojnë qëndrueshmëri në adhurime, lutje dhe sakrificat e tyre, dhe të shtojnë përpjekjet për të fituar mirësinë dhe kënaqësinë e Plotëfuqimshmit.



# Ramazani dhe shpresa e formimit të myslimanit shëmbëlltyrë

Mr. Vedat Shabani

Adhurimet në Islam, figurativisht mund t'i llogarisim si stacione në rrugën e jetës, ku njeriu ndalet dhe në mënyrë të drejtpërdrejt i drejtohet Zotit të tij dhe i lutet Atij, në mënyrë që të fitojë devotshmëri dhe drejtësi, t'i mposhtë egot dhe dëshirat e tij dhe t'u drejtohet atyre sa herë që e shqetëson ose e brengosë ndonjë çështje.

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: *“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm...”* (El Bekare, 183).

Koncepti i adhurimit (El Ibadeh) në Islam ka një ndikim të madh në edukimin-formimin e anës shpirtërore, në orientimin e sjelljes, pastrimin dhe lartësimin e shpirtit, reformimin e tij dhe përtëritjen e kthimit për te Zoti xh.sh.. Ky koncept ka një ndikim të qartë në orientimin e drejtë të karakterit të myslimanit, në pastërtinë e shpirtit të tij dhe në kryerjen me përpikëri të detyrave që i janë besuar.


Adhurimet të cilat Zoti xh.sh. i ka urdhëruar për krijesat e Tij, realiteti dhe forma e tyre janë që ato të krijojnë lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet njeriut dhe Krijuesit të tij, dhe nëpërmjet tyre të njihet myslimani që është i

përkushtuar ndaj fesë së tij nga ai që nuk përkushtohet fare.

Adhurimet në Islam, figurativisht mund t'i llogarisim si stacione në rrugën e jetës, ku njeriu ndalet dhe në mënyrë të drejtpërdrejt i drejtohet Zotit të tij dhe i lutet Atij, në mënyrë që të fitojë devotshmëri dhe drejtësi, t'i mposhtë egot dhe dëshirat e tij dhe t'u drejtohet atyre sa herë që e shqetëson ose e brengosë ndonjë çështje.

Adhurimet, përveçse që janë një lidhje ndërmjet robit dhe Zotit të tij, ato janë një mjet për të krijuar një lidhje të mirë midis individit dhe shoqërisë. Ato e edukojnë individin, e përgatisin atë për jetën dhe mënyrën e ballafaqimit me çështjet e kësaj bote.

Meqë jemi në muajin Ramazanit dhe besimtarët janë duke shijuar ditët e fundit të këtij muaji, atëherë themi se agjërimi është



njëri nga pesë shtyllat e fesë islame, dhe njëri nga aktet e adhurimit që ka ndikimin më të madh në jetën e një myslimani, si nga aspekti shpirtëror, ashtu edhe nga aspekti moral dhe shoqëror. Kjo sepse muaji Ramazan është një momentum i madh i mirësisë. Në të pastrohen shpirtat, zemrat afrohen me Krijuesin e tyre dhe hapen dyert e Xhenetit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Është muaj në të cilin hapen dyert e mëshirës dhe dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit, dhe lidhen shejtanët.”<sup>1</sup> Në këtë muaj, Zoti ia shpalli Kuraniin Pejgamberit të Tij, Muhamedit a.s. si udhërrëfyes për njerëzit, një dallim midis së vërtetës dhe të pavërtetës dhe një sqarim i rrugëve të mirësisë. Allahu xh.sh. thotë: “Muaji i Ramadanit që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria).” (El Bekare, 185).

Agjërimi si rit është prej ibadeteve të cilat Zoti ua ka bërë obligim edhe popujve të mëhershëm. Edhe pse forma dhe mënyra kanë qenë të ndryshme, mirëpo qëllim dhe efekti sigurisht janë të njëjta.

Muaji Ramazan është muaj i begatshëm dhe një moment madhështor, i cili në veten e tij përmban virtyte dhe begati që nuk mund të numërohen. Nuk ka dyshim se është muaji i Kuranit famëlartë dhe në të është “Nata e Kadrit”, e cila është më e mirë se njëmijë muaj, është muaj që ngulit te njeriu shumë virtyte dhe efekte të shkëlqyera, të tilla si mëshira, dhembshuria dhe mirësia ndaj të varfërve, nevojtarëve dhe të mjerëve. Është muaji i durimit, sepse agjërimi është gjysma e durimit, kurse durimi është gjysma e besimit, gjithashtu është muaji i devotshmërisë. Kjo sepse agjërimi është një shkollë e madhe islame, e cila e edukon njeriun me të gjitha komponentët e tij psikologjike, fizike, shpirtërore, morale dhe sociale. Agjërimi ka shumë rregulla dhe shumë dobi nga aspekti social dhe nga aspekti individual, duke përfshirë kështu dhembshurinë për të varfrit. Kjo sepse kur agjërujesin e godet uria, ai kujton gjendjen e tij gjatë gjithë kohës dhe kjo e shtyn atë të mëshirojë të varfrit, ngase mëshira te njeriu lind nga dhimbja, kurse agjërimi është një mënyrë praktike për të ngritur mëshirë në shpirt dhe kur arrihet



**Ramazani është muaj që ngulit te njeriu shumë virtyte dhe efekte të shkëlqyera, të tilla si mëshira, dhembshuria dhe mirësia ndaj të varfërve, nevojtarëve dhe të mjerëve.**

mëshira e të pasurve për të varfrit dhe të uriturit, atëherë fjala e brendshme njerëzore bëhet e fuqishme dhe me ndikim.

Agjërimi ia mëson myslimanit durimin me të gjitha format e tij. Ia mëson durimin gjatë veprimit të punëve të mira, dhe durimin me rastin e braktisjes së punëve të liga. Gjithashtu ia mëson durimin në caktimet-kaderet e Zotit. I Dërguari a.s., pikërisht këto virtyte kishte për qëllim kur ka thënë në një hadith të tij lidhur me agjërimin e Ramazanit: “...ai është muaji i durimit, ndërsa shpërblimi për durimin është Xheneti.”

Agjërimi e forcon vendosmërinë e besimtarit dhe aftësinë e tij për të duruar, e përgatit atë që të përballet me vështirësitë dhe fatkeqësitë me të cilat mund të ballafaqohet në jetën e tij, me një shpirt pozitiv dhe vendosmëri të lartë. Agjërimi gjithashtu forcon prirjen e natyrshme të besimtarit ndaj shoqërisë, kështu që ai punon për t’u kujdesur për të drejtën e shoqërisë, dhe është i prirë për bashkëpunimin, solidaritetin, dhembshurinë dhe kohezionin e tij, siç është e zakonshme. Agjërimi përhap në mesin e shoqërisë drejtësinë, barazinë, dashamirësinë dhe dhembshurinë.

Nëse dikush bën një pyetje se si ndikon agjërimi në formimin e një myslimani ideal, atëherë ne mund të themi se ndikimi i agjërimin në sjelljen dhe përsosmërinë e një besimtari mund të shfaqet përmes disa pikave:

## NË RAPORT ME KRIJUESIN E TIJ

Fillimisht do të fokusohemi te ndikimi që ka agjërimi i Ramazanit në raport mes robit dhe Krijuesit të tij.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në ngritjen e devotshmërisë në zemrat e besimtarëve dhe ripërtëritjen e besimit – imanit.

Këtë e potencon Allahu xh.sh. në Kuran, kur flet për qëllimin e agjërimit: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm...” (El Bekare, 183). Nuk ka dyshim se agjërimi i Ramazanit ka ndikim të thellë në parandalimin e shumë veprave të liga dhe të ndaluara. Këtë e vëren çdo besimtar i cili agjëron gjatë muajit Ramazan. Së këndejmi, kur një besimtar largohet nga veprat e ndaluara dhe vepron punë të mira që i ka porositur Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij, kjo ndikon në ngritjen e të qenët të tij si besimtar i përkushtuar dhe besimtar shëmbëllturyrë.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në rritjen e ndjenjës së përcjelljes së Zotit xh.sh. ndaj robit.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në fuqizimin e lidhjes shpirtërore mes robit dhe Zotit të tij, kjo lidhje e fuqizon ndjenjën e përcjelljes së Zotit ndaj robit në çdo aspekt. Si rezultat i kësaj ndjenje, ai largohet nga çdo punë, vepër e cila është e ndaluar dhe sjell dëme, gjithashtu ai mundohet që të bëjë çdo punë, vepër e cila është e dobishme dhe Zoti është razi me të.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në konceptimin e mirësive të shumta që i ka robi.

Natyrshëm njeriu e koncepton vlerën e një dhuntie atëherë kur ajo i mungon ose privohet prej saj. Për këtë arsye, edhe agjëruesi arrin ta konceptojë edhe më vlerën e ushqimit, pijeve, dhe intimitetit, pikërisht gjatë agjërimit, për shkak të privimit të tij prej tyre për një kohë të caktuar.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në edukimin e besimtarit që vazhdimisht të jetë korrekt në fjalë dhe vepër.

Kjo arrihet përmes përkushtimit të besimtarit gjatë muajit Ramazan, që të jetë sa më korrekt dhe i përkushtuar në adhurime. Të jetë në kontiunitet dhe përputhje të plotë mes fjalëve dhe veprave të tij. Pejgamberi a.s.

Njeriu e di vlerën e një dhuntie atëherë kur nuk e posedon atë, dhe kjo e shtyn atë që ta falënderojë Zotin për dhuntitë dhe begatitë e Tij. Këtë e vërejmë në momentin kur agjëruesi e çel agjërimin e tij duke pirë një gotë ujë e cila e flladitë atë, dhe në momentin kur ha ushqimin. Çështja e falënderimit është potencuar tërthorazi në ajetet e agjërimit, “... dhe që të falënderoni.”

ka thënë: “Nëse dikush nuk i braktis fjalët e kota dhe veprat e këqija, Allahu nuk do që ai ta braktisë ushqimin dhe pirjen.”<sup>22</sup>

## NË RAPORT ME VETVETEN E TIJ

Agjërimi i Ramazanit është një shkollë e madhe, e cila në karakterin e besimtarit lë gjurmë të thella, prej të cilave mund të veçojmë:

Agjërimi i Ramazanit ndikon në përfundimin e vullnetit dhe gatishmërisë së besimtarit.

Kjo për arsye se agjërimi e edukon besimtarin si ta përmbajë vetën e tij dhe si t'i shmanget dëshirave dhe egove të tij. Përmes agjërimit, arrin të avancohet edhe nga aspekti i sjelljeve të tij me të tjerët, sepse ai e dinë se sjellja e mirë e ka vlerën e agjëruesit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Me të vërtetë besimtarit ka mundësi që përmes sjelljeve të mira ta arrijë gradën e agjëruesit dhe namazfalësit.”<sup>23</sup>

Agjërimi i Ramazanit ndikon në edukimin e besimtarit duke përfunduar durimin e tij.

Kjo realizohet përmes frenimit të vetës së tij dhe ndalimit të saj nga ushqimet dhe pijet gjatë ditëve të Ramazanit, me qëllim të arritjes së kënaqësisë së Allahut xh.sh.. Agjërimi gjithashtu kultivon durimin, i cili ndërlihet me çështjen e braktisjes së mëkateve dhe veprave të liga. Në këtë mënyrë, besimtarit, i cili agjëron dhe largohet nga mëkatet e shijon vlerën e durimit ndaj mëkateve.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në krijimin e shprehisë së falënderimit ndaj Allahut xh.sh.

Agjërimi është një mjet i cili të çon deri te krijimi i shprehisë për të shprehur falënderim ndaj mirësive dhe dhuntive të Allahut xh.sh., kjo sepse abstenimi nga ushqimi, pijet dhe gjërat e tjera që e prishin agjërimin, është abstenim nga begatitë më të mira që i ka njeriu. Së këndejmi, njeriu e di vlerën e një dhuntie atëherë kur nuk e posedon atë, dhe kjo e shtyn atë që ta falënderojë Zotin për dhuntitë dhe begatitë e Tij. Këtë e vërejmë në momentin kur agjëruesi e çel agjërimin e tij duke pirë një gotë ujë e cila e flladitë atë, dhe në momentin kur ha ushqimin. Çështja e



falënderimit është potencuar tërthorazi në ajetet e agjërimit, “... dhe që të falënderoni.” (El Bekare, 185).

### NË RAPORT ME SHOQËRINË DHE RRETHIN KU JETON

Agjërimi i Ramazanit, siç u theksua edhe më lartë, është një shkollë gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Ai ka ndikimin e tij edhe në shoqërinë e cila e praktikon këtë adhurim.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në edukimin e shoqërisë myslimane për solidaritetet.

Kjo veti arrihet duke ndjekur shembullin e Pejgamberit a.s., i cili ishte shumë solidar dhe dorëdhënë gjatë muajit Ramazan. Abdullah ibën Abasi r.a. tregon se Pejgamberi a.s. ishte njeriu më dorëdhënë, ndërsa në Ramazan, për çdo natë kur takohej me Xhibrilin për përsëritje të Kuranit, ishte akoma edhe më dorëdhënë. Kjo për arsye se edhe shpërblimi gjatë muajit Ramazan është i shumëfishuar, prandaj është një element nxitës, i cili ndikon në rritjen e solidaritetit dhe humanizmit ndërmjet njerëzve gjatë këtij muaji.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në promovimin e unitetit mes niveleve të shoqërisë myslimane.

Ky unitet shfaqet qartazi gjatë muajit të bekuar Ramazani, ku myslimanët, varësisht prej dallimeve që kanë në përkatësinë e tyre, nivelet, gjuhën dhe përgjegjësitë e tyre, ata që të gjithë agjërojnë në kohë të njëjtë dhe bëjnë iftar në të njëjtën kohë. Nuk ka dallime ndërmjet të varfrit apo të pasurit, ndërmjet femrës apo mashkullit. Që të gjithë në mënyrë të unifikuar e përmbushim këtë obligim ndaj Krijuesit të tyre me qëllim të arritjes së kënaqësisë së Tij dhe përkushtimit ndaj kryerjes së obligimeve të tyre.

Agjërimi i Ramazanit ndikon në arritjen e barazisë ndërmjet shtresave të shoqërisë dhe eliminimin e dallimeve mes tyre.

Agjërimi është një faktor i rëndësishëm dhe efektiv në ngritjen e nivelit të individëve dhe shoqërive në të gjitha nivelet; shpirtërore, psikologjike, edukative, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë. Agjërimi ndikon te të gjithë në ngritje dhe lartësimin më të madh material e moral. Me këtë efekt avancohen lidhjet vëllazërore dhe realizohet kuptimi i hadithit të Pejgamberit a.s., në të cilin ka thënë: “Do të shohësh se besimtarët janë si një trup në dhembshurinë ndaj njëri-tjetrit, në dashurinë ndaj njëri-tjetrit dhe në butësinë ndaj njëri-tjetrit!.. Kur një gjymtyrë e këtij trupi të ndjejë dhimbje, edhe gjymtyrët e tjera nuk flenë dhe përpëlitën me dhimbjen që ndjen ajo.”<sup>4</sup>

Si përfundim, agjërimi është një adhurim madhështor, të cilin Zoti xh.sh. fillimisht e ka detyruar për të arritur devotshmërinë. Mirëpo, nëse një mysliman e kryen atë në mënyrë më të mirë të mundshme, atëherë ndikimi i tij do të reflektohet në të gjitha aspektet e jetës. Për shkak të efektit të tij të mirë në rritjen e nivelit të besimit, edukimin e shpirtit dhe mësimin e tij me durim dhe përpjekje, agjërimi me të vërtetë konsiderohet një shkollë stërvitore-trajnuese që e afron myslimanin me Krijuesin e tij. Efekti i agjërimit nuk kufizohet vetëm tek individi, ky efekt shtrihet përtej kësaj edhe në nivel social. Gjatë këtij muaji vëmë re një rritje të manifestimeve të solidaritetit social, dhe rritjen e lidhjeve të vëllazërisë dhe unitetit ndërmjet anëtarëve të shoqërisë.

1 Transmeton Imam Muslimi, hadithi nr. 1039.

2 Transmeton Imam Buhari, hadithi nr. 1903.

3 Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 4798.

4 Transmeton Imam Buhari, hadithi nr. 6011.



# Besimtari dhe mirësia e tij e përherëshme

Isa Tershani

I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Mos u bëni imitues e të thoni: Nëse njerëzit na bëjnë mirë edhe ne u bëjmë mirë, nëse na bëjnë padrejtësi edhe ne u bëjmë padrejtësi. Por mësohuni që kur njerëzit t’ju bëjnë mirë, t’ua ktheni me të mirë, dhe kur t’ju bëjnë keq, ju të mos u bëni padrejtësi.”

Allahu xh.sh. na nderoi me këtë fe, me qëllim që të na edukojë, e kjo edukatë të manifestohet me sjellje të mira në vetveten, familjen dhe në shoqërinë tonë. Sjellja e mirë është një prej elementeve më të rëndësishme të personalitetit të besimtarit mysliman. Islami është fe e besimit dhe e sjelljes së mirë, fe e etikës dhe e moralit. Me një fjalë, Islami është fe përmbledhëse e të gjitha të mirave, si dhe garantuese e çdo vlere të lartë. Kjo fe urdhëron dhe porositë gjithçka që e ngrit dhe e nderon njeriun, kurse e ndalon atë që e ulë, e poshtëron dhe e njollos personalitetin e tij. Sipas transmetimit të Hudhejfe bin Jemamit, i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “*Mos u bëni imitues e të thoni: Nëse njerëzit na bëjnë mirë edhe ne u bëjmë mirë, nëse na bëjnë padrejtësi edhe ne u bëjmë padrejtësi. Por mësohuni që kur njerëzit t’ju bëjnë mirë, t’ua ktheni me të mirë, dhe kur t’ju bëjnë keq, ju të mos u bëni padrejtësi.*”<sup>1</sup>

## Ç’ËSHTË MIRËSIA?

Sipas transmetimit të Shedad bin Evsit, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu, në çdo punë, ka urdhëruar mirësinë...”<sup>2</sup>

Mirësia - ihsani nënkupton njohjen dhe përmbushjen në mënyrën më të mirë të asaj që duhet bërë. Që një punë e kryer të arrijë nivelin e mirësisë, duhet që njeriu së pari të jetë i vetëdijshëm për atë që e bën dhe ta bëjë atë në mënyrën më të duhur e më të mirë.

Shprehja “ihsan” ndonjëherë përkufizohet si begatim dhe mirësi, porse kuptimi i saj i

vërtetë zgjerohet edhe përtej kësaj. Nëse iu referohemi fjalorëve të gjuhës, do të gjejmë se shprehja “ahsene” ka kuptimin e bërjes së një vepre të mirë, pra e kundërta e shprehjes “esaaë”, që ka kuptimin e bërjes së një vepre të keqe. Kështu shprehja “El Hasenetu”, e ka kuptimin e një veprimi të mirë.

Andaj veprat e mira përfshijnë çdo mirësi dhe çdo trajtim ose bashkëveprim që e ngrit dhe e lartëson dinjitetin njerëzor, si dhe e edukon personalitetin e njeriut, duke e afruar kështu afër Krijuesit të tij. Në këtë kuptim kanë ardhur porositë e Kuranit, duke ftuar kështu në mirëbërësi dhe duke nxitur në kryerjen e veprave të mira.

Mësimet e Kuranit rreth mirëbërësisë dëshmojnë se Kurani është libër hyjnor që ngrihet në nivelet më sublimë dhe që ato mësimet qëndrojnë më lartë se cilado shkollë apo ideologji moraliste ose religjioze, ngase Kurani e ka trajtuar mirëbërësinë në atë formë që të ketë ndikim në personalitetin njerëzor duke i përmendur edhe motivet e veprës, pastaj i ka shtjelluar tiparet e mirëbërësve të vërtetë, si dhe ka specifikuar disa kategori njerëzish, të cilët janë më të denjë për mirëbërësi se sa të tjerët. Ai (Kurani) ka ftuar për atë mirëbërësi që njerëzimit i ofron vlere të larta sublimë, për çka angazhohen edhe filozofët dhe reformatoret gjithandej nëpër botë.<sup>3</sup>

Konceptin e “ihsanit” mirësisë, më së miri na e tregon Omeri r.a.: “Një ditë teksa ndodhesha pranë të Dërguarit të Allahut, u



paraqit dikush. Rrobat i kishte të bardha si bora, flokët të zeza si abanozi dhe nuk i vihej re ndonjë shenjë udhëtimiti. Veç kësaj, mes nesh, askush nuk e njihte. U ul pranë të Dërguarit të Allahut, i afroi dhe i mbështeti gjunjët pranë gjunjëve të tij, dhe duart i vendosi mbi kofshët e tij e i tha: “O Muhamed, më trego për Islamin... për imanin... për ihsanin-mirësinë.” I Dërguari i tha: “Mirësia është t’i bëhesh rob Allahut sikur ta shohësh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty...” “Ai ishte Xhibrili. Erdhi t’ju mësoj fenë tuaj,” - tha Pejgamberi a.s..<sup>4</sup> Xhibrili i kishte ardhur në formën e njeriut.

Në këtë hadith, koncepti i ihsanit-mirësisë, është kur njeriu ndihet se Allahu e sheh dhe ia ndjek veprimet teksa ai përmbush detyrën e tij si rob. Ata që kësajsoj veprojnë me mirësi, do të bartin ndjesinë se Allahu në çdo moment i sheh, di gjithçka që bëjnë, di edhe atë që ua përshkon zemrën.

Disa prej njerëzve i kryejnë obligimet e tyre vetëm për të hequr qafe përgjegjësinë. Kurse ata që vërtet e kanë arritur nivelin e mirësisë, për çdo gjë që bëjnë janë shumë të vetëdijshëm se Allahu i Madhërishëm i sheh ata dhe i ka nën vëzhgimin e Tij dhe me këtë vetëdije e me sinqeritetin më të madh i kryejnë obligimet e tyre. Në një ajet kuranor na bëhet e qartë se: “...Ai është me ju kudo që të jeni, Allahu është përcjellës i asaj që punoni.” (El Hadid, 4). E njëjta gjë është edhe në ajetin 58 të sures El Muxhadele, e shumë të tjerë.

Kështu mirësia i jep njeriut mendim të hollë dhe ndjeshmëri të lartë. Ajo e dëlirëson njeriun, e pastron dhe i jep pjekurinë e ndjenjës së të qenit gjithnjë në prani të Zotit. Ajo bën që përmes sinqeritetit dhe

përkushtimit, të kryhen të gjitha punët në mënyrën dhe formën më të mirë.<sup>5</sup>

### ISLAMI FE VETËM E RREGULLAVE APO...!?

Feja islame nuk është vetëm fe rregullash, siç mund të reklamohet sot prej shumë personave që nuk e njohin siç duhet. Ajo është fe e besimit, fe e moralit dhe e sjelljes së mirë. Vepra e mirë për myslimanin nuk është një rrugë që sjell vetëm lumturinë e jetës së amshuar, po edhe mundësinë për një jetë plotë me bukuri të kësaj bote.

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Kush bën veprë të mirë, goftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (En Nahl, 97). Siç shihet në këtë ajet, theksohet se besimi dhe veprat e mira, para se gjithash, do të sjellin një jetë të mirë të kësaj bote. Në këtë kuadër, edhe urdhri i Allahut të Madhërishëm: “Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehvi mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë,” (El Enbija, 105), shpalos faktin se sovraniteti i tokës është e drejtë që u takon ekskluzivisht individëve dhe shoqërive vepërmira.<sup>6</sup>

Andaj ata që duan të nderohen e të respektohen në këtë jetë dhe në të përtejshmen, për ta arritur këtë pozitë, Zoti i Madhëruar na i mësoi dy rrugë: fjalë të bukura dhe vepra të mira. Në Kuran thotë: “... tek Ai ngritët fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë...” (Fatir, 35). Besimi dhe veprat e mira janë dy kriteret më të rëndësishme që tregojnë vlerën e njeriut tek Allahu i Madhëruar.

### VLERA E MIRËSISË

Myslmani i vërtetë ka sjellje të mirë në marrëdhëniet me të tjerët. Ai është i thjeshtë, i butë, i mëshirshëm, i arsyeshëm, i mirësjellshëm dhe i këndshëm kur flet me të tjerët. E gjithë kjo duke e ndjekur shembullin e Pejgamberit a.s.. Do ta përmendim pjekurinë e Hatixhes r.a., pasi Pejgamberi a.s., i kishte treguar për takimin e parë me Xhibrilin a.s., në muajin e bekuar Ramazan, në shpellën Hira. Me këtë rast, Muhamedi a.s., kishte përjetuar një emocion të përzier me ankth, dhe kur kthehet në shtëpi i kërkon Hatixhes ta mbulojë. Pasi kishte pushuar pak Muhamedi a.s., bashkëshortja e tij, duke i dhënë kurajë për një ardhmëri të lumtur që e pret, i drejtohet me fjalët: “Mos u friko, Zoti yt nuk të dëshpëron, sepse ti sillesh mirë me të

Hatixheja, r.a., duke i dhënë kurajë për një ardhmëri të lumtur që e pret, i drejtohet me fjalët: “Mos u friko, Zoti yt nuk të dëshpëron, sepse ti sillesh mirë me të afërmit, e mbron të dobëtin, i jep atij që është i nevojshëm, i nderon mysafirët, e flet të vërtetën dhe bën mirë ku mundesh.”

afërmit, e mbron të dobëtin, i jep atij që është i nevojshëm, i nderon mysafirët, e flet të vërtetën dhe bën mirë ku mundesh.”<sup>7</sup> Këto fjalë të Hatixhes, duke ia përmendur vetëm disa nga cilësitë e bekuara Muhamedit a.s., e që i posedonte edhe para profetësisë e qetësuan. Muhamedi a.s., respektohej dhe nderohej në Mekë, ngase posedonte moral dhe sjellje të mirë.

Nëse sjelljet dhe qëndrimet e mira të jomuslimanët janë rezultat i edukimit të mirë dhe solid, atëherë sjelljet e mira të muslimanëve vijnë nga udhëzimi islam, i cili e ka bërë sjelljen e mirë karakteristike themelore të muslimanit, e që do ta ngritë statusin e tij në këtë botë dhe do të peshojë rëndë për veprat e mira në Ditën e Gjykimit.<sup>8</sup> Andaj muslimani çdoherë duhet të udhëhiqet nga mësimet hyjnore në jetë. Për sjelljen e mirë-mirësinë, na ka treguar Pejgamberi a.s., duke thënë: “Ditën e Kiametit, në peshoren e besimtarit nuk do të ketë gjë më me peshë se sa morali i mirë. Vërtet, Allahu zemërohet fort me ata që fjalët dhe veprimet i kanë të liga (këqija).<sup>9</sup> Islami e ka bërë sjelljen e mirë ndaj të tjerëve pjesë të rëndësishme të besimit, siç na ka treguar i Dërguari i Allahut, a.s.: “Besimtarët me besim më të përsosur janë ata që kanë sjellje më të mirë ndaj të tjerëve.”<sup>10</sup>

Nuk është çudi që njeriu me sjellje të mirë ndaj të tjerëve të jetë me besim të përsosur dhe më i dashur tek Allahu, pasi trajtimi i mirë i të tjerëve është tipar i Islamit. Ajo – mirësia – është e barabartë me namazin dhe agjërimin, dy shtylla të Islamit, siç na ka treguar Muhamedi a.s.: “Vërtet besimtari me karakter të mirë e arrin gradën e atij që agjëron dhe fal namaz (vullnetar).”<sup>11</sup>

Mirësia është obligim i natyrshëm dhe virtyt që nuk mund të përkufizohet vetëm me disa kategori njerëzish apo qenie të gjalla, por për të gjithë pa dallim. Mirëpo Kurani i ka përcaktuar disa kategori njerëzish që janë më të denjë se sa të tjerët për mirësi, e kjo për shkak të lidhjes së afërsisë ose fqinjësisë që e lidhë mirëbërësin me ata, ose i specifikon disa të tjerë për shkak se ata kanë humbur ndihmëtarin e përkrahësin, andaj bëhet obligim që të fillohet mirëbërësia me ta.

I Lartmadhërisëmi ka thënë: “Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjët të afërt, ndaj fqinjët të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. Allahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.” (En Nisa, 36).

Ky ajet ka përmbledhur brenda vetes llojet e mirëbërësisë, sa që po të bënte njeriu vepra të tilla, do të mbretëronte mirëqenia në mesin e shoqërisë. Prej këtyre veprave të mira theksohet adhurimi ekskluziv ndaj Allahut xh.sh., mirëbërësia ndaj prindërve, të afërmeve qoftë ai vëllai, axha, daja, fëmijët e tyre, por edhe të gjithë të afërmit e tjerë, dhe në këtë formë

vihet në rend e tërë shoqëria, sepse edhe shoqëria është e përbërë nga grumbuj familjesh. Pastaj Allahu urdhëroi mirëbërësi për jetimët, ngase ata e kanë humbur ndihmëtarin, siç është babai i tyre, dhe rrallë ndodh që nëna të këtë mundësi e vetme ta bëjë edukimin dhe sigurimin e mirëqenies së tyre. E nëse anashkalohet jetimi, atëherë ekzistenca e tij bëhet e dëmshme për shoqërinë për shkak të injorancës së tij dhe për shkak të prishjes së moralit të tij. Allahu po ashtu ka urdhëruar me mirëbërësi ndaj fqinjëve të afërm, por edhe ndaj fqinjëve të largët, pra atyre që janë larg nesh me shtëpi, ngase në këtë formë forcohen lidhjet e dashurisë ndërmjet banorëve të një lagjeje dhe ata pastaj bashkëveprojnë në harmoni në mes vete. Pastaj Allahu ka porositur mirëbërësi ndaj shokut, që është shoqëruar gjatë udhëtimit, ose shokut në shkollë, në fabrikë, në punë etj., ngase mirëbërësia ndaj tij shpie në miqësi të fortë nga e cila rezultojnë frytet më të begatshme. Më pas Allahu ka porositur për mirëbërësi ndaj udhëtarit, i cili e ka humbur pasurinë e tij në rrugë para se të arrijë në vendin e vet. Por Ai ka urdhëruar mirëbërësi edhe ndaj robërve, pra ndaj atyre që njeriu i ka në pronësi të vet, dhe mirëbërësia ndaj tyre përfshinë: lirim të tyre, heqjen e skllavërisë prej tyre dhe sjelljen me mirësi ndaj tyre.<sup>12</sup>

Kurani na e ka bërë të qartë se mirëbërësia duhet të jetë obligim i natyrshëm për njeriun, dhe ashtu siç është Allahu Mirëbërës dhe dhurues i begatave për njeriun, edhe njeriu duhet që të jetë mirëbërës me ato begati që i ka ndaj të tjerëve. Allahu në Kuran thotë: “...dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty...” (El Kasas, 77.) Me këtë ajet, besimtarëve të sinqertë ju kërkohet të sillen me mirësi ndaj të tjerëve, ashtu siç Allahu sillet me mirësi ndaj robërve të Tij.

Përfundimisht mirësia nënkupton kryerjen e ibadeteve, ashtu edhe të gjitha punëve, duke synuar kënaqësinë e Allahut, me zemër e pa interes. Kjo është rruga që të gjitha punët të bëhen kuptimplote e të vlefshme, të dobishme për personin dhe shoqërinë.

1 Tirmidhiu, 2007, *Sunen et Tirmidhi*, Mektebetu el Mearife lineshri ve tevzi, Botimi i tretë, Rijad, 2008.

2 Muslimi, 5055, *Sahih el Muslim*, Er Risale nashirun, Bejrut, 2013.

3 Afif Abdul Fet-tah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja, mr. Driton Arifi, Prishtinë 2020, f. 280.

4 Muslimi, 93, *Sahih el Muslim*, Er Risale nashirun, Bejrut, 2013.

5 *Islami nëpërmjet haditheve*, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, 3, f. 152.

6 *Islami nëpërmjet haditheve*, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, 3, f. 36.

7 Dr. Bashkim Aliu, *Muhamedi a.s., pishtari ndriçues*, Prishtinë, 2021, f. 130.

8 Dr. Muhammed Ali el Hashimi, *Muslimani ideal*, Prishtinë, 2008, f. 210.

9 Tirmidhiu, 2002, *Sunen et Tirmidhi*, Mektebetu el Mearife lineshri ve tevzi, Botimi i tretë, Rijad, 2008.

10 Tirmidhiu, 1162.

11 Ebu Davudi, 4798, *Sunen Ebi Davud*, Mektebetu el Mearife lineshri ve tevzi, Botimi i dytë, Rijad, 2008.

12 Afif Abdul Fet-tah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja, mr. Driton Arifi, Prishtinë, 2020, f. 284.

# Namazi i bajrameve dhe normat juridike islame

Dr. Flamur Sofiu

## HYRJE

**P**a dyshim së është nderi më i madh dhe lavdia më e lartë për besimtarët që Allahu i Lartësuar t'ua caktoj atyre se kur e kanë festë – Bajram. Kjo ngase besimtarit është i sigurt se zgjedhja e Zotit të Madhëruar për njerëzit është më e mirë se zgjedhja e tyre për veten e tyre. Zoti i Madhëruar tha: *“Për secilin prej jush kemi bërë ligj dhe mënyrë të jetesës.”* (El Maide, 48).

Festat janë nder dhe privilegj për shoqëritë në përgjithësi. Për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Çdo popull ka festën e vet, ndërsa (Bajrami) është festa jonë.”*<sup>1</sup> Festat janë veçori që e dallojnë çdo popull dhe shoqëri, e ne myslimanët në këtë aspekt dallohem me dy bajramet.

Bajrami në Islam është një manifestim i gëzimit dhe një mundësi e madhe për pastërtinë e shpirtave, bashkimin e fjalës dhe

përtëritjen e jetës. Bajrami nuk nënkupton që besimtari të tregojë neglizhencë ndaj obligimeve fetare, apo të heq dorë nga morali dhe etika gjatë festimit.

Myslmanët festat e tyre i manifestojnë duke e madhëruar dhe lartësuar Allahu e Madhërishëm, duke i bërë ibadet dhe duke i rikujtuar të gjitha të mirat dhe begatitë e Tij. Prandaj, edhe në rastet e bajrameve, myslimanët e fillojnë festën e Bajramit duke e falur namazin e bajramit, e më pastaj duke i ndihmuar dhe përkrahur ata që kanë nevojë, me qëllim që edhe të varfrit të jenë të gëzuar e të lumtur gjatë festave të Bajramit.

Namazi i bajramit ka vlerë të madhe dhe se kjo vlerë bëhet e qartë nga fakti se Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij i kanë kushtuar shumë rëndësi falje së namazit të bajrameve. I gjithë ky përkushtim ndaj namazit të bajrameve është bërë me të vetmin qëllim, që t'i shprehet

Festat janë nder dhe privilegj për shoqëritë në përgjithësi. Për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Çdo popull ka festën e vet, ndërsa (Bajrami) është festa jonë.”*







falënderimi Zotit për begatitë dhe mirësitë e mëdha që sjellin dy bajramet te besimtarët.

Prej urtësive të kryerjes së namazit të bajrameve mund të përmendim atë se si namazi, po ashtu edhe hytbeja e bajrameve, përfshijnë në vete bashkimin dhe tubimin e besimtarëve për ta përmendur dhe lavdëruar Krijuesin e Madhërishëm. Tjetra urtësi është se me faljen e namazit të bajrameve, besimtarët përveç adhurimit, shprehin gëzimin dhe lumturinë e përbashkët që e kanë në jetën e tyre fetare islame.

Pa dyshim se dijetarët e jurisprudencës islame kanë ndarë mendimet e tyre rreth normave dhe rregullave që kanë të bëjnë me namazin e bajrameve dhe rregullat që kanë të bëjnë me vetë dy bajramet.

Ne në këtë temë modeste do të përmendim vetëm shpjegimet dhe sqarimet e medhhebit hanefi duke mos u thelluar në detaje.

### **NORMA E NAMAZIT TË BAJRAMEVE**

Namazi i bajrameve është vaxhib, duke u bazuar në ajetin kuranor: “Falu për Zotin tënd dhe ther kurban.” (El Keuther, 2). Hanefitë, duke u bazuar në këtë, kanë sjell normën se namazi i bajrameve është vaxhib.

Namazi i bajrameve është vaxhib për atë, për të cilin është farz xhumaja. Pra, namazi i bajrameve është vaxhib për këta persona:

1. Për mashkullin. Femra nuk e ka vaxhib namazin e bajrameve.
2. Ata që janë vendës në atë vend ku ka prijës, kadi apo myfti. Namazi bajrameve nuk është vaxhib për atë që konsiderohet udhëtar dhe që jeton në ato vende ku nuk ka prijës, kadi apo myfti.
3. Që personi të mos jetë i sëmurë. Personi i cili është i sëmurë dhe nuk mund të shkojë në xhami nuk e ka obligim faljen e namazit të bajrameve.<sup>2</sup>

### **KOHA E NAMAZIT TË BAJRAMEVE**

Namazi i bajrameve mund të falet afërsisht njëzetë minuta pasi të ketë lindur dielli e deri para se të hyjë koha e namazit të drekës. Rekomandohet që të shtyhet pak koha e namazit të Fitër Bajramit, ndërsa të namazi i Kurban Bajramit rekomandohet që të falet namazi në kohën e parë.

### **MËNYRA E TË FALURIT TË NAMAZIT TË BAJRAMEVE**

Për namaze të bajrameve nuk këndohet ezani e as ikameti. Ky namaz përbëhet prej dy rekateve, njëjtë sikur namazi i sabahut, por dallon në atë se në këtë namaz është vaxhib të këndohen tekbiret. Këto tekbire këndohen në këtë mënyrë: tri tekbire këndohen pas leximit të subhanekes në rekatin e parë, pastaj lexohet fatihaja dhe surja, ndërsa kur të ngrihemi në rekatin e dytë, pasi të lexohet fatihaja dhe surja, këndohen tri tekbire. Po që se tekbiret lexohen para leximit ose pas leximit, namazi konsiderohet i vlefshëm. Sa herë që të bëhen tekbiret, duhet të ngrihen duart.<sup>3</sup>

### **DISA RREGULLA QË KANË TË BËJNË ME NAMAZIN E BAJRAMEVE**

1. Namazi i bajrameve ka shartet dhe ruknet, sikur edhe namazet e tjera të zakonshme, mirëpo, nëse namazi i bajramit është duke u falur, musaliu nuk ka abdest dhe nuk i mjafton koha për të marrë abdes, atëherë, i tilli, duhet të marrë tejemum për shkak se i është ngushtuar koha e faljes së bajramit.
2. Kur ndodhë që musaliu të arrijë imamin pasi të ketë kryer tekbiret, në këtë rast musaliu do ta bëjë tekbirin fillestar e pastaj do t'i bëjë tekbiret e namazit të bajramit pa lexuar fare subhaneken. Nëse e arrin imamin në ruku, nëse ka mundësi i kryen tekbiret dhe shkon në ruku, e nëse nuk mundet, i bën në ruku.
3. Po që se musaliu e arrin imamin në rekatin e dytë, ai duhet ta plotësojë rekatin duke i kënduar edhe tekbiret.

4. Kur ndodhë që imami të këndojë më tepër se tri tekbiere, muktediu duhet ta ndjekë doemos imamin.

5. Atij që i kalon namazi i bajramit pa e falur me imam, nuk duhet ta falë kaza.

6. Konsiderohet mekruh i lehtë të falurit e namazeve nafile qoftë në shtëpi apo në xhami para se të falet bajrami, po ashtu, mekruh është të falet nafile pasi të jetë falur bajrami në xhami, ndërsa, në shtëpi, nuk është mekruh të falësh namaz nafile pasi të jetë falur bajrami.

7. Është sunet që pasi të falet bajrami të mbahet hytbeja.

### KENDIMI I TEKBITIT TË TESHRIKUT

Me shprehjen tekbiere teshrik, nënkuptohen ato tekbiere të cilat fillojnë të këndohen pas namazit të sabahut të ditës së Arafatit d.t.th., natës së Kurban Bajramit dhe këto tekbiere vazhdojnë të këndohen pas çdo namazi farz deri në farzin e ikindisë të ditës së katërt.

Forma e tekbitit teshrik është kjo:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ  
أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَاللَّهُ أَحْمَدُ

“Allahu është më i Madhi. Allahu është më i Madhi. Nuk ka zot tjetër pos Allahut. Allahu është më i Madhi. Allahu është më i Madhi. Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut!”<sup>4</sup>.

Të kënduarit e tekbiere teshrikut është vaxhib vetëm një herë, e po që se këndohet më tepër është mustehab. Gruaja kur të këndojë tekbiere teshrikut duhet të këndojë me zë të ulët.

### HYTBEJA E BAJRAMEVE

Të mbajturit e hytbesë është sunet. Hytbeja e bajramit përbëhet prej dy hytbeve, sikurse hytbeja e xhumasë. Hatibi, hytben e bajramit e fillon me tekbiere.

Disa rregulla të përgjithshme që kanë të bëjnë me ditën e Bajramit:

Preferohet pastrimi i dhëmbëve, trupi, parfumoja dhe veshja e rrobave më të mira për ditën e Bajramit. Larja e trupit rekomandohet të bëhet para faljes së namazit të bajramit, por lejohet të pastrohemi edhe para se të falemi namazin e sabahut dhe pastaj të shkohet në xhami i pastruar.

Rekomandohet që të këndojmë tekbiere pa zë gjatë rrugës për në xhami.

Rekomandohet që të ndërrohet rruga kur të kthehemi për në shtëpi pas faljes së namazit të bajramit.

Rekomandohet që në perëndimin e diellit të natës së bajramit e deri sa të falet namazi i Fitër Bajramit të këndohen tekbiere.

Femra nuk e fal namazin e bajramit vetmas në shtëpi, ngase ajo nuk e ka obligim.

Kur ndodh që të jetë dita e Bajramit në ditën e xhuma, namazi i xhumasë duhet falur edhe pse bajrami është falur më herët. Arsyetimi pse duhet falur namazi i xhumasë është ky: se namazi i xhumasë është farz, e farzi nuk lihet për shkak se është kryer një vaxhib (e që në këtë rast namazi i bajramit është vaxhib).

Gjatë leximit të tekbiereve nuk rekomandohet të bëhet asnjë lloj dhikri apo lutje.

Namazi i bajrameve nëse i kalon dikujt pa e falur nuk duhet të bëhet kaza.

Rekomandohet që të hahet diçka para se të dilet për të shkuar në xhami për ta falur Fitër Bajramin, ndërsa në Kurban Bajram, rekomandohet të mos hahet asgjë derisa të falet namazi i bajramit.<sup>5</sup>

Rekomandohet që në xhami të shkohet në këmbë, kuptohet nëse nuk është distancë e madhe dhe kushtet klimatike janë të përshtatshme për të ecur.

Rekomandohet që namazi i bajramit të falet në vende të hapura kur janë mundësitë dhe rrethanat.

Agjërimi në ditët e Bajramit konsiderohet mekruh i rendë.<sup>6</sup>

Rekomandohen urimet dhe vizitat gjatë ditëve të bajrameve.<sup>7</sup>

Rekomandohet që në perëndimin e diellit të natës së bajramit e deri sa të falet namazi i Fitër Bajramit të këndohen tekbiere.

Nuk është e mirë që të bëhen shpenzime të panevojshme dhe harxhime të tepërta, por sa ma shumë me u treguar solidarë ndaj atyre që janë të nevojshëm.

1 El Buhariu, nr. 1432 dhe Muslimi, nr. 892.

2 Muhamed Maxhid Iter, *El Mufessal Fil Fikhil Hanefiji* (el-Ibadat), boton Mektebul Mustakbel, Halep, pa vit botimi, fq. 215.

3 Po aty.

4 Ibn Ebi Shejbete, *El Musannefu*, boton: Err Rrushd, pa vend dhe vit botimi, vol. II, fq. 268.

5 Është transmetuar nga Ibën Buraide e ky nga babai i tij se: “ I Dërguari i Allahut a.s. nuk dilte në ditën e Fitër Bajramit derisa të hante dhe nuk hante në ditën e Kurban Bajramit derisa të kthehej”. Ibën Maxhe, hadithi nr. 1756.

6 Të agjëruarit në ditët e Bajramit konsiderohet mekruh i rendë dhe se ai që agjëron agjërimi i tij është i vlefshëm, por veprimi i tillë nuk është i lejuar d.t.th. ka agjëruar kur është i ndaluar agjërimi. Ky është mendimi i hanefive.

7 Transmetohet nga Selamn el Farisiju r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Vërtet myslimani kur e takon vëllain e tij mysliman dhe e kap përdore, gjynahet atyre dyve u fshihen ashtu sikurse bien gjethet e thara prej lisit kur ka erë të fortë (furtunë) dhe se mëkatet e tyre u falen edhe nëse janë sa shkuma e detit.” (Et Taberaniju, *El Muxhemul Kebir*, vol 6. fq. 256).

# Virtytet e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të

Fitim Flugaj

Një pjesë e mëshirës së tij, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ndaj njerëzve ishte dëshira e tij e madhe për t'i udhëzuar ata në rrugën e Zotit të Madhëruar. Prandaj Pejgamberi a.s. u pikëllua jashtëzakonisht shumë nga ata që refuzuan të hyjnë në Islam, e pikërisht për këtë Zoti i Madhëruar iu drejtua Pejgamberit a.s. dhe i tha: “A thua ti do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kuranit)?”

(El Kehf, 6).

## PRIRJA E PEJGAMBERIT A.S. PËR T'I UDHËZUAR NJERËZIT NË BESIMIN E DREJTË

**I**Dërguari ynë, Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, nuk ishte thjesht Pejgamber dhe i Dërguar për një grup njerëzish, por përkundrazi ishte i Dërguar për të gjithë njerëzit, për të gjithë kohërat dhe të gjitha vendet. Zoti i Madhëruar tha: *“Dhe ne nuk të dërguam ty veçse për gjithë njerëzimin si përgëzues dhe paralajmërues.”* (Sebe, 28). Ibën Kethiri ka thënë: “Kjo do të thotë për të gjithë krijesat, që kanë vetëdije dhe përgjegjësi (mukelifin).” Pejgamberi, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë për veten e tij: “O ju njerëz, unë jam vetëm mëshirë e

udhëzuar (udhëzuese).” Gjithashtu në një hadith tjetër, ku Pejgamberi a.s. flet për përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm që të udhëzohen njerëzit në besimin e drejtë, thotë: “Gjendja ime dhe e juaja i ngjan atij i cili mundohet t'i largojë nga zjarri insektet dhe fluturat që vërsulen drejt zjarrit. Unë ju tërheq juve për brezi që t'ju shpëtoj nga zjarri, ndërsa ju përpiqeni të më ikni dhe të futeni në zjarr!”<sup>1</sup>

Një pjesë e mëshirës së tij, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ndaj njerëzve ishte dëshira e tij e madhe për t'i udhëzuar ata në rrugën e Zotit të Madhëruar. Prandaj Pejgamberi a.s. u pikëllua jashtëzakonisht shumë nga ata që refuzuan të hyjnë në Islam, e pikërisht për këtë Zoti i Madhëruar iu





drejtua Pejgamberit a.s. dhe i tha: “A thua ti do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kuranit)?” (El Kehf, 6).

El Saadi, në tefsirin e tij, thotë: “E gjithë kjo ishte sepse Profeti a.s., ishte i prirë për t’i udhëzuar njerëzit, duke kërkuar përpjekjen më të madhe në atë që ai u gëzua, ishte i kënaqur me udhëzimin e të udhëzuarve, dhe nga dhembshuria për ta e nga mëshira ndaj tyre, ishte i trishtuar për gënjeshtarët e devijuar. Zoti e udhëzoi që të mos shqetësohej për keqardhjen për ata që nuk besojnë në këtë Kuran, siç tha në ajetin tjetër: “A mos do ta mbysësh ti veten (Muhamed) pse ata nuk bëhen besimtarë?!” (Esh Shuara, 3), dhe tha: “Në të vërtetë, Allahu e largon nga e vërteta atë që do dhe Ai e udhëzoi atë që do, andaj ti (Muhamed) mos shkatërro veten me dëshpërim për ta, Allahu e di shumë mirë atë që bëjnë ata.” (Fatir, 8). Abdullah bin Abasi r.a., ka thënë: “I Dërguari i Zotit, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ishte i prirë që të gjithë njerëzit të besonin dhe ta ndiqnin udhëzimin e tij.”

Prandaj e gjejmë të Dërguarin e Allahut a.s. të kujdeset që thirrjen – davetin, t’ua bënte shokëve dhe njerëzve në përgjithësi kur ata ishin të gatshëm për ta dëgjuar. Për këtë sjellje ose metodë që përdorte Pejgamberi a.s., na

Biografia e Pejgamberit është plot me shembuj që tregojnë shkallën e mprehtësisë së Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, për t’i udhëzuar të gjithë njerëzit në rrugën e drejtë dhe për t’ua përcjellë atyre thirrjen dhe mesazhin e Zotit të tij të Plotfuqishëm, duke përfshirë:

tregon Abdullah bin Mesudi r.a., i cili u mbante ligjërata njerëzve çdo të enjte, dhe kur kërkuar që ta shpeshkonte dhe t’u mbante për çdo natë, ai u tha se unë po veproj siç ka vepruar Pejgamberi, sepse ai ka pasur kujdes që mos të bëhej i mërzitshëm dhe gjithmonë ka shikuar rastin kur njerëzit janë të predispozuar për të dëgjuar këshillat e të Dërguarit të Allahut.

Biografia e Pejgamberit është plot me shembuj që tregojnë shkallën e mprehtësisë së Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, për t’i udhëzuar të gjithë njerëzit në rrugën e drejtë dhe për t’ua përcjellë atyre thirrjen dhe mesazhin e Zotit të tij të Plotfuqishëm, duke përfshirë:

### **THIRRJEN E PEJGAMBERIT A.S. DREJTUAR POPULLIT DHE FISIT TË TIJ**

Pejgamberi a.s. u ngjit në malin Safa për të thirrur popullin në besim të Zotit të Madhëruar. Nga transmetimet e Abdullah bin Abasit, Allahu qoftë i kënaqur me të, thuhet: “Kur zbriti ajeti “Dhe tërhiq vërejtjen fafesisit tënd më të afërt,” (Esh Shuara, 214), Pejgamberi a.s., u ngjit në kodrën Safa dhe filloi të thërrasë: “O Beni Fëhr, o Benu Adij, të fisit Kurejsh!”, dhe vazhdoi në thirrje derisa u mblodhën së bashku. Disa që nuk mund të

dilnin, dërgonin një të dërguar nga familja apo fisi për të parë se çfarë po ndodhte. Aty erdhi edhe Ebu Lehebi dhe kurejshët. Ai, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, tha: “Po sikur t’ju them se në luginë është një tufë me kuaj, duke dashur t’ju sulmojnë, a do të më besoni?” Ata thanë: “Po, ne vetëm të vërtetën e kemi provuar prej teje.” Ai tha: “Unë jam paralajmëruar për ju para një dënimi të rëndë.” Ebu Lehebi tha: “Qofsh i mallkuar gjatë gjithë ditës! A për këtë na solle këtu?!” Pastaj u shpall: “Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi!” (Mesed, 1-2).

### THIRRJA E FISEVE

Pejgamberi a.s., nuk linte asnjë mundësi apo fushë mundësie pa e shfrytëzuar atë për të përcjellë thirrjen e tij te fiset. Ai u paraqitej fiseve gjatë sezonit të tregtisë dhe haxhit, duke sqaruar Islamit para tyre, dhe duke kërkuar prej tyre strehim dhe mbështetje. Ai nuk u ndalë asnjëherë derisa arriti ta publikojë fjalën e Zotit të Madhëruar. Transmetohet nga Xhabir bin Abdullahut r.a., i cili ka thënë: “I Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, qëndroi në Mekë dhjetë vjet, duke ndjekur njerëzit në shtëpitë e tyre në Ukadh dhe Mexhne, dhe në kohën e haxhit në Mina, duke thënë: “Kush do të më strehojë? Kush do të më mbështesë derisa të përcjell mesazhin e Zotit tim, për të është Xheneti?” Transmeton Ahmedi nga Rabia bin Abad ed Dilij, të ketë thënë: “E pashë të Dërguarin e Zotit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, duke u sjellë vërdallë te banorët e Minës nëpër shtëpitë e tyre, para se të shpërngulej në Medine, duke thënë: “O ju njerëz, Zoti i Madhëruar ju urdhëron që ta adhuronin vetëm Atë dhe të mos i bëni shok Atij.” Vazhdon Rebia bin Abad ed Dilij duke thënë: “Dhe pas kësaj, një njeri tha: “Ky njeri ju urdhëron që ta braktisni fenë e baballarëve tuaj.” Prandaj unë pyeta se kush ishte ky njeri? Më thanë: “Ky është Ebu Lehebi.””

Ibën Hishami në biografinë e Pejgamberit a.s. ka thënë: “Dhe kur Zoti i Madhëruar deshë të tregojë fenë e Tij dhe ta nderojë të Dërguarin e Tij a.s., i Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, doli dhe

Ai i thirri njerëzit e tij dhe fiset e tjera, mbretër e princa, dhe në fakt i thirri të gjithë njerëzit në Islam. Ai thërriste për udhëzim në xhami dhe në rrugë, në tregjet arabe dhe në kohën e haxhit, në zonat urbane dhe në udhëtime, në shëndet dhe sëmundje, dhe kur e vizitonte ose e vizitonin, ua drejtonte thirrjen udhëzuese atyre që e donin dhe e përkrahnin, të cilët e çmonin dhe ishin besnikë ndaj tij.

u paraqit para fiseve sipas zakonit të tij, takoi një grup njerëzish nga Hazrexhi, për të cilët Zoti dëshiroi të mirën e tyre. Pejgamberi a.s. u tha atyre: “Kush jeni ju?” Ata thanë jemi një grup nga Hazrexhi. “A jeni nga aleatët e çifutëve?” Ata thanë: “Po.” Ai tha: “A nuk do të uleni pak e të flas me ju?” Ata thanë: “Po.” Kështu ata u ulën me të, e Pejgamberi i thirri ata në besim të Zotit të Madhëruar (që ta besojnë Zotin e Vetëm) dhe ua ofroi (ua sqaroi) Islamit. Disa prej tyre i thanë njërit-tjetrit: “O populli im, ju e dini, pasha Zotin, e dini fare mirë se vërtet ai është Pejgamberi me të cilin ju kërcënuan çifutët, prandaj le të mos ju paraprijnë tek ai.” Ata iu përgjigjën asaj që ai (Pejgamberi) i thirri, duke e besuar atë dhe duke pranuar prej tij atë që ai u ofroi atyre nga Islami.”

### FTESA DREJTUAR MBRETËRVE DHE PRINCAVE

Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, u dërgoi një sërë letrash mbretërve dhe princave të botës bashkëkohës me të, jashtë Gadishullit Arabik, duke i ftuar ata në Islam. Disa prej tyre ishin injorantë ndaj Islamit dhe refuzuan në mënyrë kategorike, siç ishte mbreti i Persisë, Kisrau. Përderisa disa të tjerë e pranuan dhe e pritën letrën e Pejgamberit a.s., siç ishte Cezari, perandori i romakëve. Pejgamberi gjithashtu i dërgoi një letër El Mukaukisit, mbretit të Egjiptit. Pastaj i dërgoi El Mundhir ibën Savit, mbretit të Bahreinit si dhe Xhaferit dhe Abdus, bijtë e El Xhulundejit, zotëruesit e Omanit. Këto letra përcillnin dhe demonstionin shkallën e mprehtësisë së Profetit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, për t’i orientuar dhe udhëzuar këta mbretër dhe princa në Islam.

Transmetohet nga Enesi r.a., se i Dërguari i Zotit a.s., i shkroi Kisras, Cezarit, Nexhashiut, por që nuk iu lut atyre, por secili e thirri në besim në Zotin e Madhëruar.<sup>3</sup>

Prirjet e Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, që jobesimtarët dhe fëmijët e tyre të udhëzoheshin në rrugën e drejtë

Transmetohet nga Enesi r.a., i cili thotë: “Një djalë çifut që i shërbente Pejgamberit a.s., u sëmur. Pejgamberi a.s. shkoi për ta vizituar



dhe hyri në shtëpinë e tij, qëndroi ulur afër kokës së tij e i tha: “Bëhu mysliman!” Ai e shikoi babanë e tij derisa ishte me të dhe tha: “Bindu Ebu el Kasimit (Pejgamberit)!”, kështu që ai u kthye në Islam (u bë mysliman). Pastaj Pejgamberi a.s. doli jashtë dhe tha: “Falënderimi i takon Zotit që e shpëtoi nga zjarri i Xhehenemit.”<sup>4</sup>

Transmetohet nga Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i kishte thënë Pejgamberit a.s.: “O i Dërguari i Zotit, a të ka ardhur ndonjëherë një ditë më e rëndë se dita e Uhudit?” Pejgamberi a.s. tha: “Kam hasur nga populli yt atë që kam hasur dhe më e keqja nga ajo që kam hasur prej tyre ishte dita e Akabesë, kur iu paraqita dhe e përballa vetveten me të birin e Abd Jalil bin Abd Kulal, e ai nuk mu përgjigj ashtu siç desha. Kështu që u largova nga aty me një shqetësim të thellë në fytyrë dhe nuk jam kthjelluar derisa arrita në Karn el Thalaab (mikati i banorëve të Nexhdit). Kështu ngrita kokën dhe pashë një re që më kishte mbuluar me hije, shikova dhe në të ishte Xhibrili, i cili më thirri e më tha: “Zoti e ka dëgjuar atë që të thotë populli yt dhe nuk të janë përgjigjur. Zoti yt të

dërgoi engjëllin e maleve që ti ta urdhërosh të bëjë çfarë të duash.” Pastaj engjëlli që i mbikëqyr dhe i sundon malet më thirri dhe më përshëndeti, e pastaj më tha: “O Muhamed, Zoti e dëgjo atë që të thotë populli yt, dhe unë jam engjëlli - mbikëqyrësi i maleve, Zoti yt më ka dërguar te ti që të më urdhërosh me urdhër çfarë dëshiron ti. Nëse dëshironi unë mund t’i përplasi dy malet mbi ta.” Me këtë rast i Dërguari i Zotit a.s., tha: “Përkundrazi, shpresoj që Zoti do t’i nxjerrë nga lajthitja e tyre dhe t’i udhëzojë ata që ta adhurojnë Zotin e vetëm, duke mos i bërë shok Atij (duke mos i përshkrua rival Atij).”<sup>5</sup>

Sipas këtij qëndrimi profetik, ai është mëshirë për atë që thirret në fe. Është dhembshuri për të, edhe nëse ai është jobesimtar apo mëkatar. Është kujdestar për udhëzimin e tij dhe udhëzimin e pasardhësve të tij.

Ky kuptim u tregua qartë kur El Tufejli r.a. i tha Pejgamberit a.s.: “O i Dërguari i Zotit, me të vërtetë Deusët (fisi i Tufejlit) kanë mëkatuar dhe janë mohues, prandaj lutju Zotit për ta (që t’i udhëzojë Zoti ata).” Pejgamberi, paqja e Allahut qofshin mbi të, u lut për udhëzim dhe tha: “O Zot, udhëzoj Deusët se Ti ke fuqinë mbi ta.”<sup>6</sup>

El Kirmani ka thënë: “I Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, është lutur për udhëzim përballë mosbindjes e arrogancës së tyre, është lutur për t’i sjell ata deri te pohimi përballë mohimit (për bindje në Islam). Kjo është pjesë e mëshirës së tij, përsosmërisë së karakterit të tij madhështor dhe dëshirës së tij për udhëzim në rrugën e drejtë të të gjithë njerëzimit.”

Pejgamberi a.s. dha një shembull të lartë dhe një model të veçantë me vullnetin e tij të jashtëzakonshëm për t’i udhëzuar të gjithë njerëzit. Ai i thirri njerëzit e tij dhe fiset e tjera, mbretër e princa, dhe në fakt i thirri të gjithë njerëzit në Islam. Ai thërriste për udhëzim në xhami dhe në rrugë, në tregjet arabe dhe në kohën e haxhit, në zonat urbane dhe në udhëtime, në shëndet dhe sëmundje, dhe kur e vizitonte ose e vizitonin, ua drejtonte thirrjen udhëzuese atyre që e donin dhe e përkrahnin, të cilët e çmonin dhe ishin besnikë ndaj tij.

Ai u bënte thirrje për udhëzim edhe atyre që e urrenin dhe ishin armiqësor ndaj tij. E gjithë kjo ishte dhe buronte nga kujdesi dhe interesimi i jashtëzakonshëm i tij, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, për t’i orientuar drejt njerëzit dhe për t’i udhëzuar ata te Zoti, dhe pikërisht për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar, për të dhe për mesazhin dhe misionin e tij ka thënë: “E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (El Enbija, 107).

1 Transmeton Imam Muslimi.

2 Transmeton Imam Ahmedi.

3 Transmeton Imam Muslimi.

4 Transmeton Imam Buhariu.

5 Transmeton Imam Buhariu.

6 Transmeton Imam Muslimi.



# Vëllazëria islame në periudhën medinase dhe mësimet për kohën tonë

Suhejb Hashani

“Dhe mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, e në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.”

Islami ka zbritur nga Allahu xh.sh. fe e cila e ka rregulluar sistemin e jetës së njeriut. Allahu xh.sh. i ka krijuar njerëzit që të jetojnë në shoqëri, në fise dhe popuj të ndryshëm, ashtu që ata të njihen mes vete dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre, siç ka thënë në Kuran: “O ju njerëz ne ju kemi krijuar juve nga një mashkull dhe femër, dhe ju kemi bërë popuj e fise, ashtu që të njiheni mes vete, e nuk ka dyshim se më i miri nga ju është ai që është më i devotshëm nga ju.” (El Huxurat, 13).

Për këtë arsye, njeriu është krijuar i shoqëruar për nga natyra e tij, dhe është bërë për nga natyrshmëria që të jetojë në shoqëri, dhe ai nuk ka mundësi që të jetojë vetëm.<sup>1</sup> Në një ajet tjetër, Allahu xh.sh. thotë: “O ju njerëz keni frikë Zotin tuaj, i Cili ju krijoi prej një

njeriu të vetëm, e nga ai krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej atyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.” (En Nisa, 1). Allahu u bënë me dije se të gjithë ata janë pasardhës të një mashkulli dhe një femre dhe të gjithë janë nga njëri-tjetri, dhe se dhënia e së drejtës për njeri-tjetrin është obligim, sikurse që është obligim për vëllain dhënia e së drejtës ndaj vëllait të tij.<sup>2</sup>

Nga myslimani kërkohet që të jetë sa më i vëmendshëm drejt obligimeve që i ka kundrejt besimtarëve myslimanë. Allahu xh.sh. na urdhëron dhe thotë: “Dhe mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, e në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.” (Ali



Imran, 103). Vëllazërimi ndërmjet besimtarëve është njëra nga çështjet më të rëndësishme që e karakterizon fenë islame, e nuk ka mundësi të jetë ndryshe, sepse feja islame është ngritur mbi këtë program. Bazat e këtij programi janë ndërtoar mbi angazhimin individual, por edhe lidhje të forta siç është vëllazërimi ndërmjet myslimanëve. Vëllazërimi është lidhje shariatike hyjnore, gjithnjë e fortë, e cila e bashkon çdo mysliman me të gjithë myslimanët në çdo anë, dhe në çdo pjesë të botës.<sup>3</sup>

Allahu e ka sqaruar në Kuranin famëlartë se lidhja e vetme e cila nuk mund të shkëputet asnjëherë është vëllazërimi ndërmjet myslimanëve, e cila është e ndërtoar mbi lidhjen e besimtarit me Zotin: “Në të vërtetë besimtarët janë vëllezër.” (El Huxhurat, 10). Ata janë vëllezër nga një origjinë e vetme, e ajo është besimi, i cili është shkak për jetën e përvetshme (Xhenetin).<sup>4</sup> Të gjitha lidhjet mund të shkëputen, por se lidhja vëllazërore në islam nuk mund të shkëputet asnjëherë, sepse besimi në Allahun xh.sh. është ajo që e mban atë.

I Dërguari a.s. pasi që u shpërngulur në Medinë, ndërtoi një shoqëri, e cila la gjurmë të pashlyera në historinë botërore. Civilizimi dhe kultura e saj përfshiu botën në një kohë shumë të shkurtër. I Dërguari a.s. me t'u shpërngulur në Medinë, i unifikoi besimtarët myslimanë nga muhaxhirët dhe ensarët, i bëri ata një popull pa dallime ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, dhe këtë e bëri ligjërisht të obligueshme në Kushtetutën e Medinës, ku sa për ilustrim po përmendim njëri nga nenet e saj në lidhje me këtë çështje: “Kjo është shkresë e Muhamedit a.s., të Dërguarit të Zotit, mes besimtarëve dhe pasueseve të Islamit, midis kurejshëve dhe popullit të Medinës, dhe kush i pason ata dhe hyn nën ta, lufton me ta, ata janë një popull i bashkuar, i ndarë nga të gjithë popujt tjerë.”<sup>5</sup> Jehudët ishin më të dobët se fiset Evs dhe Hazrexh në Medinë, për atë, ata edhe përdorën një metodë, futjen e përcarjes mes tyre, në këtë plan edhe ia arritën qëllimit.

Armiqësia e tyre u trashëguua brez pas brezi derisa u ndal definitivisht me ardhjen e Pejgamberit a.s.<sup>6</sup> I Dërguari a.s. përveç kësaj, muhaxhirët edhe i vëllazëroi me ensarët në mënyrë që ata të gjenin mbështetje shpirtërore dhe financiare te ta. E bëri Xhafer ibën ebi Talibin dhe Muadh ibën Xhebelin vëllezër, e bëri Hamza ibën Abdulmuttalibin dhe Zejd ibën

I Dërguari a.s. ka thënë:  
“Myslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bënë atij padrejtësi, dhe nuk e dorëzon atë, kush i del ndihmë vëllait të tij, Allahu do ta ndihmojë atë, kush ia largon një shqetësim, Allahu do t'ia largojë atij një shqetësim prej shqetësimeve të Kiametit, dhe kush ia mbulon një të metë vëllait të tij, Allahu do t'ia mbulojë një të metë në Ditën e Gjykimit.”

Harithen vëllezër, po ashtu Ebu Bekër Sidikun dhe Harixhe ibën Zuhejrin vëllezër, dhe kështu me radhë.<sup>7</sup>

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. të ketë thënë: “Ensarët i thanë të Dërguarit a.s.: Ndaji në mes nesh dhe vëllezërve tanë (muhaxhirëve) hurmat, mirëpo ai a.s. tha: jo, kështu ata thanë: na mjafton furnizimi i tyre, e ne i ndajmë frytet me ta, e ata (muhaxhirët) thanë: Dëgjuam dhe pasuam.”<sup>8</sup> Më pastaj, i Dërguari a.s. i urdhëroi të ndërtojnë Xhaminë e Medinës, e cila do t'u shërbente atyre për adhurimet, arsimimin e tyre, marrjen e vendimeve shtetërore, kuvendet e ndryshme politike, apo siç njihet si “Shura” etj.. Veç kësaj, mesxhidi ishte strehë e të varfërve dhe muhaxhirëve refugjatë, të cilët nuk kishin shtëpi të veta, as pasuri, as të afërm, e as fëmijë.<sup>9</sup>

Muhaxhirët kishin nevojë për këtë mbështetje pasi ata lanë gjithçka në Mekë vetëm për t'u shpërngulur në Medinë, në mënyrë që të gjenin një jetë të re larg persekutimeve, dhunës dhe vrasjeve që ua bënë mushrikët e Mekës, dhe gjithashtu që të ngrinin një shtet të tyre ku ata do t'i kishin të drejtat e tyre të siguruara. Për këtë, ensarët iu dolën atyre krahe në çdo gjë që ata kishin nevojë. Allahu i lavdëron muhaxhirët në Kuran, që edhe pse nuk kishin asgjë pas hixhretit për në Medinë, ata ishin të zellshëm, punonin dhe turpëroheshin të kërkonin lëmshën edhe pse kishin nevojë për të: “(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzisnin njerëzit duke lypur...” (El Bekare, 273).

Gjithashtu Allahu xh.sh. i lavdëron edhe ensarët, të cilët i ndihmonin muhaxhirët më shumë sesa veten e tyre: “Por duan t'u bëjnë më mirë muhaxhirëve sesa vetes edhe pse ata vetë janë nevojtarë.” I Dërguari a.s. ka thënë: “Myslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bënë atij padrejtësi, dhe nuk e dorëzon atë, kush i del ndihmë vëllait të tij, Allahu do ta ndihmojë atë, kush ia largon një shqetësim, Allahu do t'ia largojë atij një shqetësim prej shqetësimeve të Kiametit, dhe kush ia mbulon një të metë vëllait të tij, Allahu do t'ia mbulojë një të metë në Ditën e Gjykimit.”<sup>10</sup>

Vëllazërimi i myslimanëve bëri që ajo shoqëri të jetë unifikuese dhe si një trup i vetëm, të pa përcarë. Në të vërtetë





nuk mundet asnjë shtet që të përparojë dhe të ngritët përpos se në unifikimin e ymetit dhe mbështetjes së saj, dhe nuk mundet që unifikimi as mbështetja të realizohen përpos se me faktorin e vëllazërisë dhe dashurisë së ndërsjellë.<sup>11</sup> Përveç këtyre bazave të ndërtimit të shtetit në Medinë, ne kemi edhe përgatitjen ushtarake. Rrethanat e reja detyruan që myslimanët të përgatiten për këtë çështje.<sup>12</sup> Ata në krye me të Dërguarin a.s. arritën që të forcojnë shtetin e tyre në mesin e fuqive botërore në atë kohë, ku më parë arabët as nuk njiheshin se kishin pasur ndonjëherë shtet me plot kuptimin e fjalës. Ata u detyruan ta mbronin pasurinë e tyre e cila u merrej dhe shitej nga kurejshët në tregjet e Shamit. Allahu xh.sh. ua lejoi luftën atyre: “Atyre që janë sulmuar, u lejohej (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi...” (El Haxh, 39). Kjo sepse kurejshët duhet ta dinin se muhaxhirët, të cilët ishin shpërngulur nga persekutimi i tyre në Mekë nuk ishin më të dobët e as të poshtëruar.<sup>13</sup>

Ky unifikim i muhaxhirëve dhe ensarëve dhe përparimi i tyre në ndërtimin e shtetit në Medinë pasi që ata ishin të dobët në Mekë, është shembull se si sot ne duhet t’i eliminojmë pengesat ndërmjet nesh, të ndërtojmë shoqërinë në bazat e pasimit të Kuranit dhe Syneutit, unitetit dhe dashurisë së ndërsjellë. Ne nuk kemi mundësi të pajtohemi për çdo gjë, për shkak të natyrës sonë logjike dhe për shkak të llojllojshmërisë së sfondit tonë kulturor.<sup>14</sup> Mirëpo ne duhet ta dimë se mospajtimet janë vetëm në çështjet dytësore fikhore dhe se ato dalin në pah në suaza të ymetit në përgjithësi, e jo që të ndodhin brenda një populli të caktuar. Unifikimi duhet të jetë qëllimi ynë kryesor.

Kur Imam Shafiu r.a. shkoi në Kufe, ai e la kunutin në namazin e sabahut, ashtu siç është synet në fikhun shafi, vetëm për shkak se dëshiroi ta respektojë Ebu Hanifen, që ishte i varrosur në Kufe dhe popullin në atë vend që ishin në medhhenin e tij, të cilët nuk mendonin se është synet një gjë e tillë.<sup>15</sup>

Sahabët e të Dërguarit a.s. patën mendime të ndryshme për faljen e drekës te Benu Kurejdhe, pas luftës së Hendekut. Në hadithin: “Mos ta falë askush nga ju drekën përveç se te Benu Kurejdhe.”<sup>16</sup> Sipas disa sahabëve, qëllimi ishte që të falet namazi para mbërritjes, mirëpo duke e shpejtuar shkuarjen, ndërsa disa e kuptuan se duhej të falej ashtu siç kishte thënë i Dërguari a.s., mirëpo ata nuk e bënë njëri-tjetrit gabimtarë, askush nuk ishte i dhunshëm ndaj tjetrit, e as nuk e qortoi, sepse të dy palët e kuptuan hadithin sipas pikëpamjes së tyre.<sup>17</sup>

Ymeti ynë më shumë se asnjëherë më parë ka nevojë që t’u kthehet këtyre mësimëve të të parëve tanë. E kjo arrihet nëse ka mirëkuptim njerëzor, nxitje për ndër vëllazërim, me ndjenjën se myslimanët janë një trup i vetëm, duke bashkëpunuar në pengimin e dëmit, në sjelljen e mirësisë, dhe bashkëpunimi në fitim të mirë.<sup>18</sup>

- 1 Dr. Muhamed Emin el Misrij, *El Muxhtemeu el Islamij*, Kuvajt City, Dar el Erkam, 1980, fq. 8.
- 2 Muhamed ibën Xherir et Taberij, *Xhamiu el Bejan An Te’vil Aji el Kur’an*, Giza, Dar Hexhr, 2001, fq. 339.
- 3 Ismail Ali Muhamed, *El Uhuvetu el Islmaijeh, Feridatun Sherijeh ve Daruratun Asrijeh*, Kajro, Dar el Kelimeh, 2012, fq.10.
- 4 Abdullah ibën Umer el Bejdawi, *Enwar et Tenzil ve Esrar et Tevil*, Damask, Dar Er Reshid, 2000, V. 3, fq. 307.
- 5 Ismail ibën Umer ibën Kethir, *El Bidejetu ve en Nihejetu*, Bejrut, Mekteb el Mearif, 1991, V.3, fq. 224.
- 6 Bashkim Aliu, *Muhamedi a.s., pishtari ndriçues*, Shkup, Furkan ISM, 2012, fq. 229.
- 7 Abdul Melik Ibën Hisham, *Es Siretu en Nebevijetu*, Bejrut, Dar et Turath el Arabij, 1990, V.2, fq. 146.
- 8 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, Damask, Dar Ibën Kethir, 2002, hadithi 2719, fq. 666.
- 9 Safijurrahman el Mubarekfuri, *Nektari i Vulosur i Xhenetit*, përktheu: Muhamed Iljaz Dolaku, Prishtinë, Interpress R.Company, 2004, fq. 216.
- 10 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, Damask, Dar Ibën Kethir, 2002, hadithi 2442, fq. 591.
- 11 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Fikhu es Sireti en Nebeviye Mea Muxhiz Li Tarih el Hilafeti er Rashideh*, Damask, Dar el Fikr, 1996, fq. 162.
- 12 <https://ar.islamway.net/article/48253/> كيف-بنى-النبي-محمد-صلی-الله-عليه-وسلم-الدولة-الإسلامية (Parë për herë të fundit: 24.02.2024).
- 13 Munir Muhamed el Gadban, *El Menhexh el Harekij Li es Sireti en Nebeviye*, Zerka’, Mekteb el Menar, 1990, fq. 232.
- 14 Abdulkerim Bekkar, *Menaxhimi i diversitetit*, përktheu: mr. Vedat Shabani, Prishtinë, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, 2021, fq. 32.
- 15 <https://www.elbalad.news/4963147/>, (Për herë të fundit: 24.02.2024).
- 16 Muslim ibën el Haxhah ibën Muslim, *Sahih Muslim*, Rijad, Dar Tajibe, 2005, hadithi: 1770, V. 2, fq. 848.
- 17 <https://www.google.com/amp/s/www.islamweb.net/amp/article/222127/> لا يُصَلِّيْنَ أَحَدُ الْعَصْرِ - الْأَخِي-بني-فَرِيظَةَ (Parë për herë të fundit: 24.04.2024).
- 18 Muhamed Ebu Zehre, *El Vahde el Islamiye*, Bejrut, Dar er Ra’id el Arabij, nd, fq. 235.



# Etika dhe tregu

Dr. Zenel Hajdini

Nuk ka dyshim se tregtia është prej punëve më të mira të kësaj bote me të cilën njeriu arrin ta furnizojë e mirëmbajë veten dhe familjen e tij, dhe përmes së cilës përmbushen edhe kërkesat shoqërore. Allahu legjitimoi tregtinë që njeriu ta shtojë pasurinë e tij, por krahas kësaj e ndaloi kamatën. Kështu në Kuran tha: “...Allahu e ka lejuar tregtinë, kurse kamatën e ka ndaluar...” (El Bekare, 275). Ndërsa në një rast kur Pejgamberi a.s., është pyetur se cili fitim është më i miri? Ai ka thënë: “Puna që bënë njeriu me dorën e tij, dhe çdo tregti është e vlefshme (e bereqetshme).”<sup>1</sup>

Mirëpo, ajo që e dallon një tregtar besimtar nga tregtarët e tjerë është se ai është i lidhur me parimet fetare, respektivisht me Zotin e tij.

Andaj, fillimisht, ai duhet kuptuar se tregtia nuk guxon ta largojë nga kryerja e obligimeve që ka ndaj Krijuesit të tij. Kështu Allahu i përmend ata në Kuran: “Burra, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun, për të falur namazin dhe për të dhënë zekatin. Ata kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.” (En Nur, 37).

Pra, një tregtar besimtar është ai i cili i jep përparësi urdhrit të Allahut ndaj tregtisë dhe përfitimit të saj, ashtu siç ka urdhëruar Allahu në Kuran: “O besimtarë, kur të thirrreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe ndaloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!” (El Xhumua, 9).

Pas kryerjes së obligimeve në raport me Krijuesin, ai që të jetë një tregtar i denjë e me ndërgjegje, duhet t'i ketë parasysh edhe disa

Nuk ka dyshim se tregtia është prej punëve më të mira të kësaj bote me të cilën njeriu arrin ta furnizojë e mirëmbajë veten dhe familjen e tij, dhe përmes së cilës përmbushen edhe kërkesat shoqërore.

gjëra etike me të cilat mund të ballafaqohet gjatë tregtisë, pasi që, jo çdo tregti është e bereqetshme dhe hyn në lutjet e Pejgamberit a.s.. Disa nga ato janë:

Sinqeriteti – Besimtari përveç sinqeritetit të zemrës, ai duhet të ketë sinqeritet edhe në vepra, në këtë rast të jetë i sinqertë në tregtinë e tij. Sinqeriteti i tij në tregti vërehet gjatë premtimeve që ai jep, vërehet në fjalët e tij gjatë përshkrimit të cilësive të produktit që ai shet, vërehet gjatë ndarjes së përfitimit, nëse ai është ortak me dikë.

Një shembull të tillë, besimtari, e ka në të Dërguarin e tij, Muhamedin a.s.. Në librat që tregohet historia e tij, gjejmë Pejgamberin a.s., para se të dërgohej pejgamber, si një tregtar të sinqertë, të drejtë dhe që ka kryer premtimet. Këto cilësi e bënë që ai, alejhi selami, të ketë sukses në tregti dhe të bëhet i njohur në shoqërinë e tij për virtyte të larta njerëzore e shoqërore.





Për këtë tregtar të sinqertë, Pejgamberi a.s., premtoi se do të ketë gradën më të lartë. Ai tha se do të jetë me pejgamberët e dëshmorët në Ditën e Gjykimit. “Tregtari i sinqertë dhe i besueshëm, do të jetë me pejgamberët, të sinqertët dhe dëshmorët.”<sup>2</sup>

Ndërsa ata të cilët nuk janë të sinqertë gjatë tregtisë së tyre, do të ringjallen në Ditën e Gjykimit si të mbrapsht e të turpshëm. Pejgamberi a.s. një ditë prej ditëve kur doli nga xhamia dhe pa njerëzit duke tregtuar në mes vete, ua tërhoqi vërejtjen me këto fjalë: “O turma e tregtarëve!”, të gjithë ngritën kokën dhe shikimin nga Pejgamberi a.s. Pastaj tha: “Tregtarët do të ringjallen në Ditën e Kiametit të turpshëm përveç atyre që iu frikësuan Allahut, ishin të mirësjellshëm dhe ishin të sinqertë.”<sup>3</sup>

Një shembull aktual që mund ta përmendim është shitja e veturave. Sot është bërë e zakonshme që para se ta blejmë veturën, kushtëzohet që t’i bëhet kontrolli me sistemin adekuat që është caktuar. Por, ndodh që ky sistem disa probleme nuk i lajmëron fare, ndërsa pronari i veturës e di sigurt se vetura e ka një problem të caktuar, i cili ndikon në vlerën e saj. Në këtë rast, nëse pronari e mban të fshehur dhe nuk e tregon atë me arsyetimin se është sistemi ai që duhet bazuar, atëherë ai llogaritet mëkatar, dhe duhet të ketë frikë nga kjo që ka porositur Pejgamberi a.s..

Një shembull i ngjashëm ndodhi edhe në kohën e Pejgamberit a.s.. Një ditë prej ditëve,

Besimtari e ka për obligim që kur të bëj tregti, t’i tregojë të gjitha të mirat dhe të metat e produktit apo sendit që ai ka për ta shitur, veçanërisht nëse këto ndikojnë në zbritjen e çmimit, pastaj blerësi mbetet i lirë që ta marrë apo ta lë.

përderisa Pejgamberi a.s. ishte në treg, kaloi pranë një njeriu që shiste produkte ushqimore, e futi dorën në mesin e tyre, por hetoi që kishte lagështi në fund. Atëherë Pejgamberi a.s., pyeti: “Çfarë është kjo, o pronar i këtyre produkteve?” Ai iu përgjigj: “I ka lagur shiu, o i Dërguar i Allahut!” Pejgamberi a.s., i tha: “Përse nuk i ke vendosur sipër që njerëzit t’i shohin? Kush na mashtron neve, nuk është prej neve.”<sup>4</sup>

Besimtari e ka për obligim që kur të bëj tregti, t’i tregojë të gjitha të mirat dhe të metat e produktit apo sendit që ai ka për ta shitur, veçanërisht nëse këto ndikojnë në zbritjen e çmimit, pastaj blerësi mbetet i lirë që ta marrë apo ta lë. Këtë e vërteton edhe ajo që transmetohet nga sahabiu i nderuar Xherir bin Abdullahu se ka thënë: “Ja kemi dhënë besën Pejgamberit a.s. se do të këshillojmë të gjithë myslimanët dhe se do të flasim vetëm të vërtetën.” Dhe ky ishte Xheriri, që sa herë dëshironte të shiste diçka, i tregonte të gjitha të mirat ose të metat që kishte produkti.<sup>5</sup>

Këtë e kuptojnë më së miri vetëm ata tregtarë, të cilët veprojnë e punojnë sipas porosisë së Pejgamberit a.s.: “Nuk do të jetë besimtar (siç kërkohet) askush nga ju përderisa nuk ia dëshiron vëllait të tij atë që ia dëshiron vetvetes.”<sup>6</sup>

Betimi i rrejshëm – Tregtari betohet në Allahun duke gënjyer, për ta kënaqur blerësin për çmimin e produktit (mallit), apo cilësitë e tij, apo duke fshehur të metat e tij. Një veprim



të tillë, Allahu na ka ndaluar me fjalën e Tij ku na thotë: “Por ti mos iu bind çdo betuesi të përçmuar.” (El Kalem, 10).

Betimi gjatë tregtisë është i urryer edhe nëse është betim i vërtetë. Për këtë transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Betimi shter mallin dhe asgjëson (çrrënjos) fitimin.” (Buhariu, 7802).<sup>7</sup>

Ndërsa ajo që i pret në Ditën e Gjykimit ata që çdo shitblerje e përcjellin me betim, e tregon Allahu në Librin e Tij: “Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj Allahut me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. Allahu nuk do t’u flasë atyre, as nuk do t’i shikojë në Ditën e Gjykimit dhe as nuk do t’i pastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm.” (Ali Imran, 77).

Pra, betimi qoftë ai i rrejshëm apo jo, nuk sjellë dobi asgjë gjatë tregtisë. Për këtë, më e mirë për tregtarët është që ta largojnë nga gjuhët e tyre betimin, e cila është bërë shprehi e tyre, sepse ajo edhe humb fitimin, por edhe meriton dënim tek Allahu.

Lehtësimi, jo vështirësimi – Parimet islame nxisin që besimtarët t’ia lehtësojnë njëri-tjetrit çështjet e kësaj bote. Për këtë edhe Allahu na porositi në Kuranin famëlartë: “...Ai dëshiron për juve lehtësi dhe jo vështirësi...” (El Bekare, 185). Ndërsa Pejgamberi a.s., thotë: “Lehtësoni e mos vështirësoni...”<sup>8</sup>

Kjo, në aspektin e përgjithshëm, ndërsa në aspektin e veçantë për tregtarët, duhet ditur se ai i cili lehtëson e nuk vështirëson, edhe Allahu ia lehtëson atij si në këtë botë me fitime të shumta, por edhe në botën tjetër me shpërblime. Pejgamberi a.s., është lutur që ta kaplojë mëshira e Allahut atë i cili ia lehtëson të tjerëve. Në një hadith ka thënë: “Allahu e mëshiroftë atë njeri që fal (lehtëson) kur blenë, kur shet, ose kur i gjen borxh dikujt.”<sup>9</sup>

Një praktikë që përdorin tregtarët çdoherë është edhe monopolizimi i produkteve, si dhe bllokimi i mallit për një afat të caktuar me qëllim ngritjen e çmimit. Ky bllokim i mallit bëhet shkak që shoqëria të kalojë një jetë me vështirësi, e sidomos nëse bëhet në produktet elementare të jetës. Për këtë Pejgamberi a.s. ua tërhoqi vërejtjen tregtarëve për këtë veprim duke thënë se një veprim i tillë është mëkat, “Kush monopolizon, ai është mëkatar.”<sup>10</sup>

Andaj, para se ta marrësh rrugën e tregtisë, ti si besimtar duhet t’i kesh parasysh këto gjëra etike që kanë të bëjnë me karakterin e një besimtari të denjë! Edhe nëse i gjithë tregu nuk vepron mbi këto parime islame, ti si besimtar duhet të dallosh nga të tjerët!

- 1 Ahmed bin Hanbel esh Shejbanij, “*Musned Imam Ahmed*”, (Mueseseh er Risaleh, Liban, 2001), v. 28, fq. 502. Duhet ditur se dijetarët kur e kanë komentuar pjesën e fundit të këtij hadithi “... çdo tregti është e bereqetshme”, kanë thënë: Nëse në atë tregti nuk ka mashtrim, gënjeshtëri...
- 2 Muhamed bin Isa et Termidhij, “*Sunen Et Termidhij*”, (Mektebeh Mustafa el Babij el Halebij, Egjipt, 1975), v. 3, fq. 507. Hadithi është në shkallën hasen.
- 3 Muhamed bin Isa et Termidhij, “*Sunen Et Termidhij*”, (Mektebeh Mustafa el Babij el Halebij, Egjipt, 1975), v. 3, fq. 507. Hadithi është në shkallën hasen sahih.
- 4 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “*Sahihu Muslim*”, (Bejrut, Liban), v. 1, fq. 99.
- 5 Muhamed bin Ismail el Buharij, “*Sahihul Buharij*”, (Dar Es Selam, Riad, 2000), v. 1, fq. 21. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “*Sahihu Muslim*”, (Bejrut, Liban), v. 1, fq. 99.
- 6 Muhamed bin Ismail el Buharij, “*Sahihul Buharij*”, (Dar Es Selam, Riad, 2000), v. 1, fq. 21. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “*Sahihu Muslim*”, (Bejrut, Liban), v. 1, fq. 99.
- 7 Muhamed bin Ismail el Buharij, “*Sahihul Buharij*”, (Dar Es Selam, Riad, 2000), v. 3, fq. 57.
- 8 Muhamed bin Ismail el Buharij, “*Sahihul Buharij*”, (Dar Es Selam, Riad, 2000), v. 1, fq. 25. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “*Sahihu Muslim*”, (Bejrut, Liban), v. 1, fq. 1359.
- 9 Muhamed bin Ismail el Buharij, “*Sahihul Buharij*”, (Dar Es Selam, Riad, 2000), v. 3, fq. 57.
- 10 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “*Sahihu Muslim*”, (Bejrut, Liban), v. 1, fq. 1227.

# Doracakët më të njohur të Fikhut Hanefi (5)

## MUHTESARI I KUDURIUT

Hazir D. Selmani

Muhtesari i Kuduriut ose “Përmbledhja Me Kuduriut” është ai doracaku i hershëm i fikhut hanefi, i cili i la nën hijen e tij shumicën e veprave të hershme dhe të vonshme të këtij medhhebi.

### KUSH ËSHTË KUDURIU?

Kuduriu nuk është edhe aq i panjohur në mesin e studiuesve tanë shqiptarë. Për jetën e tij nuk ka shumë të dhëna. Ai është Ebu'l Husejn Ahmed, i biri i Ebu Bekër Muhamed b. Ahmed b. Xhafer Kuduriut. Lindi në vitin 362 h.. Për llagapin e tij "Kuduri" ka mjaftë mospajtime, thuhet se rrjedh nga lagjja-fshati Kudurah në periferi të Bagdadit ose nga profesioni i prodhimit a shitjes se vorbave (ar. kidër-kudur).<sup>1</sup> Kuduriu jetoi dhe veproi në Bagdad, ku vdiq në vitin 428 h., në moshën 66 vjeçare. Varri i tij përfundimisht u vendos pranë Ebu Bekër Havarizmit (vd. 403 h.), nxënësit të madh të Xhesasit.<sup>2</sup> Ai rridhte nga një familje intelektuale. Babai i tij, Ebu Bekër Kuduriu duket se ishte prej figurave hanefite. Kuduriu pati edhe një djalë me emrin Muhamed Ebu Bekër, i njohur si Ibnu'l-Kuduri dhe për të e pati shkruar këtë muhtesar-in e tij fikhor. Biri i tij vdiq në moshë të re në vitin 440 h.<sup>3</sup>

### MËSUESIT E KUDURIUT, SHKOLLIMI DHE POZITA E TIJ MEDHHEBORE

Në disa burime të vonshme, figuron se Kuduriu filloi të merrej me dije në moshë të mëvonshme, mu sikurse Kafali i shafive.<sup>4</sup> Mirëpo me këtë, sigurisht synohet periudha e studimeve të thella fikhore, ngase vdekjet e

Hatibi, nxënësi shafi i Kuduriut, e përshkruan kështu atë: “Nuk pati transmetuar vetëm se pak dhe është prej atyre që shkrova (transmetime) prej tij.

Transmetues shumë i sinqertë si dhe shumë bujar në fikh, shkak i mençurisë së tij. Ishte prijësi i ndjekëseve të Ebu Hanifes në Irak, bile te këta kishte pozitë shumë të lartë dhe reputacion të madh. Ishte shumë fjalëmbël e gojëmprehtë. Gjithnjë lexonte Kuran...”

mësuesve të tij dëshmojnë të kundërtën, e që do të shihet në vijim. Fikhun hanefi e përvetësoi në duart e Ebu Abdilal Xhurxhanit (vd. 398 h.), nxënësit të Ebu Bekër Razi Xhesasit.<sup>5</sup> Në vdekjen e mentorit të tij të fikhut, Kuduriu ishte 36 vjeçar. Njashtu është shumë e mundur që Kuduriu si fëmijë të ketë marrë pjesë edhe në ndonjë mexhllis të Razi Xhesasit (vd. 370 h.), ngase në veprën e tij El Texhrid, disa herë citon Xhesasin me fjalët “hoxha ynë”.<sup>6</sup> Kuduriu në vdekjen e Xhesasit ishte rreth 8 vjeç. Mësues tjerë të tij të hadithit theksohen: Haushebiu (vd. 375 h.) dhe Muedibi (vd. 381 h.).<sup>7</sup> Prej këtij të fundit ka dhjetëra hadithe në libërthnin e botuar me titull “Xhuz'u'l-Kuduri”. Kuduriu në vdekjen e Haushebiut ishte rreth 13 vjeç dhe në vdekjen e Muedibit ishte rreth 19 vjeç. Pra, del se ai krahas fikhut ishte edhe një muhadith i shquar edhe pse në mexhlliset hadithore të asaj kohe pati transmetuar shumë pak, ngase fusha e veprimtarisë së tij ishte fikhu, ndërsa zanati i tij hadithor vërehet qartazi në veprën e tij me titull “El Texhrid”. Hatibi, nxënësi shafi i Kuduriut, e përshkruan kështu atë: “Nuk pati transmetuar vetëm se pak dhe është prej atyre që shkrova (transmetime) prej tij. Transmetues shumë i sinqertë si dhe shumë bujar në fikh, shkak i mençurisë së tij. Ishte prijësi i ndjekëseve të Ebu Hanifes në Irak, bile te këta kishte pozitë shumë të lartë dhe reputacion të madh. Ishte shumë fjalëmbël e gojëmprehtë. Gjithnjë lexonte Kuran...”<sup>8</sup> Ibën Tegriberdi, historiani i famshëm hanefi për këtë vlerësim të Hatibit shton dhe thotë: “Vlerë është ajo për të cilën dëshmojnë edhe kundërshtarët. E nëse çështja e këtij burri



(Kuduriu) mos t'i kishte kapërcyer kufijtë (e zakonshëm) të dijës dhe asketizmit, ai nuk do të kishte mundur t'i shpëtonte gojës së Hatibit, i cili me gjithë fanatizmin e tij kundër zotërinjve hanefi dhe tjerëve, ai përsëri e lëvdoi këtë (Kuduriun)...”<sup>9</sup> Nga shumë historianë, Kuduriu, vlerësohet me titujt: imam, dijetar i jashtëzakonshëm, debatues i fuqishëm, fakihu i Bagdadit, raisi i hanefive në Irak, shejhu i hanefive në Irak, autori i Muhtesarit të bekuar, lexues i pandashëm i Kuranit, etj.<sup>10</sup> Dihet edhe ajo se Kuduriu pati disa debate me kokat kryesore të medhhebit shafi, si Ebu Hamid Isferajinin dhe kadi Ebu Tajib Taberiu.<sup>11</sup> Kuduriu në medhhebin hanefi gëzon një pozitë shumë të madhe dhe veprat e tij janë burimi e brumi kryesor për shumë diskutime fukahashë, sidomos veprat El Muhtesar, El Texhrid dhe Sherhu Muhtesar El Kerhi. Nuk është e tepërt po të thuhet se është gati e pamundur që pas Kuduriut të gjendet ndonjë libër i llojit sherh dhe fetava, e që ai mos të përmendet aty. Ibën Kemal Pasha dhe shumë fukaha të tjerë pas tij, atë e rendisin së bashku me Merginanin në shkallën e 5-të të fukahave hanefi, e ndërsa në shkallën e 3-të janë renditur Shemsu'l-eimeh Halvani, Serahsiu, Kadihani, etj.<sup>12</sup> Merxhani dhe Keutheriu e vlerësojnë ndryshe dhe e kritikojnë këtë mënyrë të shpërndarjes së fukahave nëpër këto shkallë. Ata thonë se Kuduriu është më i hershëm se Shemsu'l-eimeh, si dhe më i aftë dhe më i fuqishëm se ai, e lëre më se Kadihani.<sup>13</sup> Pra, sipas kësaj i bie që Kuduriu të renditet diku në shkallën e tretë edhe atë më lartë se Shemsu'l-eimeh dhe Kadihani.

**Kuduriu shkroi të paktën 7 vepra voluminoze. 5 prej këtyre janë të botuara, 1 është akoma dorëshkrim dhe 1 tjetër llogaritet e humbur.**

### GJURMËT E KUDURIUT<sup>14</sup>

Dihet se Kuduriu shkroi të paktën 7 vepra voluminoze. 5 prej këtyre janë të botuara, 1 është akoma dorëshkrim dhe 1 tjetër llogaritet e humbur. Librat e tij janë: 1. El Texhrid fi mesaili'l-hilaf bejne'l-hanefijeti ve'sh-shafijeh (shq: Qërimi i meseleve mospërputhëse mes hanefive dhe shafive), i botuar në 12 vëllime me rreth 1600 mesele nga gati se tërë kapitujt e fikhut dhe me mbi 32 mijë replikime intermedhhebove hanefi-shafi. Këtu më së miri vërehet thellësia e fikhut dhe usulit të Kuduriut, si dhe mjeshtëria e tij kulmore në hadith. 2. Sherhu Muhtesari'l Kerhi (shq. Komenti i përmbledhjes së Kerhit) i botuar në 9 vëllime, e që për këtë vepër u diskutua në numrin e dhjetorit të “Diturisë Islame”. 3. El Tekribu fi mesaili'l-hilaf bejne'l-imam Ebi Hanifeh ve es'habihi mea'l-edileh (shq. Përafrimi mes meseleve mospërputhëse mes imam Ebu Hanifes dhe nxënësve të tij me argumente), i botuar në 2 vëllime dhe llogaritet kryevepër në fushën e diskutimeve intramedhhebove hanefite. 4. El Tekribu fi mesaili'l-hilaf bejne'l-imam Ebi Hanifeh ve es'habihi, dorëshkrim 1 vëllimesh, e që për nga titulli duket i ngjashëm me librin paraprak, porse vetëm pa argumentime. 5. Xhuz'u'l-Kuduri fi'l-hadith (shq.: Libërthi hadithor i Kuduriut) i botuar si libërth. 6. El Muhtesar (shq. Përmbledhja) i botuar në 1 vëllim dhe është kryevepra e tij fikhere dhe njëri ndër manualët më të famshëm të fikhut hanefi në tërë historinë e tij shumë shekullore. 7. Edebu'l Kadi (shq. Etika e kadiut), llogaritet libër i humbur.

## MUHTESARI I KUDURIUT

Sipas Bekdashit, Kuduriu këtë vepër duhet ta këtë shkruar rreth vitit 420 h.. Diku figuron se këtë muhtesar e pati shkruar për djalin e tij Muhamedin, e ndërsa në disa burime të tjera figuron se atë shkroi pas kërkesës së kalifit abasit Kadirubilah (vd. 422 h.).<sup>15</sup> Si përfundim mund të thuhet se, atë e pati shkruar për të birin dhe më pastaj ia pati ofruar edhe vetë kalifit. Muhtesar-i i Kuduriut nuk ka hyrje e as titull. Prandaj shpeshherë njihet me emrin El Kitab (shq.: Libri). Ai ka 63 kapituj dhe rreth 12 mijë mesele<sup>16</sup> me një gjuhë të lehtë dhe si zakonisht pa argumente. Ky është një doracak i plotë që është komentuar me të madhe dhe më vonë u bë objekt i shumë studimeve të tjera dhe u kthye në brumë kryesor për shumë libra të mëvonshëm të fikhut hanefi si: Bidajetu'l-mubtedij, El Hidajeh, Tuhfetu'l-fukaha, El Vikajeh, El Nukajeh, El Vafi, Multeka'l-Ebhur, Mexhmeu'l-Bahrajn, El Minhaxh, etj. Ky doracak që para disa shekujsh është përkthyer në persisht dhe osmanlisht. Pastaj në urdu, turqisht, anglisht dhe pjesërisht edhe në boshnjakisht. Në shqip akoma nuk ka ndonjë përkthim të botuar të kësaj vepre. Mirëpo, kjo nuk d.m.th. se hoxhallarët shqiptarë nuk e kanë njohur këtë vepër, ngase sipas disa studimeve të ca ixhazetnameve, del se ky libër ka qenë tekst mësimor bazë i disa medreseve të vjetra të trojeve tona.<sup>17</sup> Prej tij ka disa kopje dorëshkrimore edhe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës.<sup>18</sup> Gjithashtu në disa biblioteka private të hoxhallarëve shqiptarë gjenden kopje të kësaj vepre qoftë vetëm si doracak ose bashkërisht me ndonjë koment. Nga ana tjetër, ky libër vijon akoma të jetë lëndë kryesore në shumicën e medreseve klasike të nënkontinentit Indian dhe disa shteteve tjera aziatike si dhe degëve të këtyre medreseve në Britani dhe Amerikë. Në Turqi vijon të mësohet akoma në zinxhirin e medreseve të Ismailagës në Stamboll dhe disa medrese të tjera.

### KOMENTET (EL-SHURUH) TË MUHTESARIT TË KUDURIUT<sup>19</sup>

Said Bekdashi numëron 122 punime mbi Muhtesarin e Kuduriut, ku shumica janë komente. Selma, bija e myfti Muxhiburrahmanit, shënon se numri i komenteve të Kuduriut shkon mbi 100.<sup>20</sup> E që del se ky doracak është njëri ndër librat më të studiuar të medhhebit hanefi. Tërë këto në gjuhën arabe. E ndërsa në gjuhën urdu, komentet e tij në shekujt e fundit kanë një bum të madh. Në vijim do të përmenden disa nga komentet më të njohur të Muhtesarit të Kuduriut:

1. Komenti i Ebu Nasër Akta' (vd. 474 h.). Nxënësi i Kuduriut i njohur si Akta' (shq. dorëçupi) e që sipas një transmetimi dorën e tij e kishte të prerë nga një betejë luftarake. Ky është komenti i parë i Kuduriut dhe njëherësh edhe më i vjetri ekzistues. Aktau shkroi dy komente për

Kuduriun: një të shkurtër dhe të dytin më të zgjeruar. I pari ekziston si dorëshkrim, ndërsa i dyti është botuar në 7 vëllime.

2. Komenti i Ispixhabit (vd. 591 h.). Ebu'l-Meali Behaudin Muhamed b. Ahmed Ispixhabi. Ky koment është botuar në 3 vëllime dhe mban titullin Zadu'l-Fukaha (Furnizimi i fukahave).

3. Komenti i Husamudin Raziut (vd. 598 h.) Kjo vepër e botuar në 4 vëllime mban titullin Hulasatu'd-Delail ve tenkihu'l-mesail fi sherhi'l-Kuduri (Ajka e provave dhe ujdisha e meseleve në komentin e Kuduriut). Një kopje dorëshkrimi e këtij komenti ndodhet edhe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës.<sup>21</sup>

4. Komenti i Ramadan Rumit (vd. pas 616 h.) që mban titullin El Jenab ië fi mearifeti'l-usuli ve't-tefarië (shq.: Krojet për njohjen e rrënjëve dhe degëve të fikhut). Është botuar në dy vëllime të mëdha me afër 1 mijë faqe.

5. Komenti i Zahidiut (vd. 658 h.) me titull El Muxhtebe (shq.: Komenti i përzgjedhur) Autori i tij është Nexhmudin Zahidiu, raisi i hanefive të Irakut në vaktin e tij. Së fundmi është botuar në 5 vëllime. Libër i bukur me mesele mjaft tërheqëse dhe llogaritë si njëri prej komenteve më të mëdhenj të Kuduriut. Megjithëqë autori në fjalë është kritikuar për jo precizitet në paraqitje të medhhebit në disa libra të tjerë të tij si El Kunjeh dhe El Munjeh. Ibën Abidini këtë vepër e citon qindra herë në Hashijen e tij.

6. Komenti i Hadadit (vd. 800 h.). Autori i tij është Ebu Bekër Hadadi Zebidi i Jemenit. Ai fillimisht shkroi një koment shumë të madh të Kuduriut, mirëpo nga dijetarët u kritikua për shumë çështje të ofruara aty. Atëherë autori e rishkroi edhe një herë në një version më të shkurtër dhe shumë të bukur dhe e titulloi El Xheheratu'n-Nejirah (shq.: Xhevahiri i ndritur). Në botimin e Bekdashit ka 7 vëllime. Meseletë e librit kanë një gjuhë shumë të lehtë dhe shumë tërheqëse.

7. Komenti i Kaadurit (v. 832 h.). Kaaduri ndryshe njihet si Sheh Omer Nebirah dhe komenti i tij i botuar në 5 vëllime me gjithsej 3600 faqe mban titullin Xhamiu'l-Mudmerat ve'l-Mushkilat fi sherhi Muhtesari'l-Kuduri (shq.: Koleksioni i të pazbuluarave dhe paqartësive në komentin e Muhtesarit të Kuduriut). Ibën Abidini në Hashijen e tij të famshme e citon rreth njëqind herë. Një kopje dorëshkrimore e këtij komenti ndodhet në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës.<sup>22</sup>

8. Komenti i Mejdanit (vd. 1298 h.). Mejdani është nxënësi i Ibën Abidinit. Komenti i tij i famshëm i Kuduriut mban titullin El Lubab fi sherhi'l-Kitab (shq. Zemra-Ajka e komentit të Librit). Ky është komenti më i famshëm i Kuduriut dhe është botuar dhjetëra herë. Në botimin e Bekdashit zë 4 vëllime. Pjesa e parë, pra kapitujt e ibadeteve janë përkthyer edhe në shqip, porse akoma nuk e kanë parë dritën e botimit.

9. Punimi i Ashikilah Bernit ose Beranit (vd. 1422 h.). Kjo vepër realisht është një rishkrim i Kuduriut në formën pyetje-përgjigje dhe në original mban titullin El Tes'hilu'd-Daruri

E që tani për tani, duke u mbështetur në të dhënat që jep profesor Arnauti, del se kjo kopje e ndodhur në Kosovë mund të jetë ndoshta nga më të rrallat, në mos edhe e vetmja e saj. Kjo gjë kërkon studime dhe verifikime të mëtejme më të thella.

li mesaili'l-Kuduri (shq.: Lehtësimi i domosdoshëm i meseleve të Kuduriut). Libri është përkthyer edhe në gjuhën shqipe me titull “Çështje të Fikhut sipas Kuduriut”, mirëpo emri i autorit në botimin shqip është lexuar si “Bureni”, e që më afër do të ishte po të lexohej si “Berni” ose “Berani” për shkak se rrjedh nga qyteti Bulandshehër i Indisë, qytet që më herët është njohur me emrin Beran. Po në formën “Berni” është drejtlexuar edhe në botimet turke dhe angleze të librit në fjalë.

10. Komenti i Ibën Bukajrah Kudusiu. Ky nuk është ndonjë koment i njohur dhe as edhe i botuar. Mirëpo duket se do të dalë si tepër i veçantë. Një kopje gati-gati e plotë e tij ndodhet në Kosovë. Në katalogun e dorëshkrimeve arabe në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës, profesor Mahmud Arnautit,

jep këto të dhëna të lexuara nga kjo kopje: Dorëshkrimi ka 273 faqe dhe shkrimi i tij ka përfunduar në vitin 800 h. në Kajro, gjatë mandatit të sulltan Dahir Berkukut. Për autor figuron se ka Hasen b. Ebi Bekër b. Ahmed el Kudusin, i lindur në Kudus Sherif dhe i shpërngulur më vonë në Kajro.<sup>23</sup> Tani, ky personalitet me këta të dhëna figuron edhe në burime të tjera historike, si p.sh. ai sipas Sehaviut, historianit të madh, ishte një dijetar hanefi që lindi në vitin 768 h. në Kudus. Ai ishte shumë i dalluar në gjuhën arabe. Jetoj dhe veptoi në Kajro, ku edhe vdiq si 70 vjeçar në vitin 836 h.<sup>24</sup> Mirëpo, për çudi, edhe pas shumë hulumtimeve e gjurmimeve askund nuk përmendet se ai pati shkruar ndonjë koment mbi Kuduriun. E që tani për tani, duke u mbështetur në të dhënat që jep profesor Arnauti, del se kjo kopje e ndodhur në Kosovë mund të jetë ndoshta nga më të rrallat, në mos edhe e vetmja e saj. Kjo gjë kërkon studime dhe verifikime të mëtejme më të thella.

Autori në fjalë ka edhe një libër tjetër të botuar të akides me titullin Gajetu'l-meram fi sherhi Bahri'l-Kelam, që është koment i librit të akides maturidije me titull Bahru'l-Kelam (shq. Deti i Kelamit).

(Vijon)

- 1 Abdulhaj Leknevi, *El Fevaidu'l-Behijeh fi teraxhimi'l-hanefijeh*. (Kajro: daru'l-kitabi'l-islamij, 1924), fq. 30.
- 2 Po aty, fq. 30.
- 3 Për babanë dhe të birin e Kuduriut shiko: Abdulkadër Kurashi, *El Xhevahiru'l-Mudijeh fi tabekati'l-hanefijeh*. (Hajderabad: mexhlisu dairati'l-meaarif, 1914), vëll. 2, fq. 10-11, bio. nr. 27; vëll. II, fq. 23, bio. nr. 66; vëll. 2, fq. 406, shën. nr. 1147.
- 4 Shemsudin Sehavi, *El Mekasidu'l-Haseneh*. (Bejrut: dki, 2006), fq. 334; Ismailhaki Bursevi, *Ruhu'l-Bejan fi tefsiri'l-Kuran*. (Bejrut: dki, 2018, bot. IV), vëll. 4, fq. 502.
- 5 *El Fevaidu'l-Behijeh fi teraxhimi'l-hanefijeh*, fq. 30
- 6 Shiko p.sh.: Kuduri, *El Texhrid*. (Kajro: daru's-selam, 2004), vëll. 5, fq. 2287, shën. nr. 10890; vëll. IX, fq. 4276, shën. nr. 20723; vëll. 9, fq. 4472, shën. nr. 21774, etj.
- 7 *El Xhevahiru'l-mudijeh*, vëll. 1, fq. 93, bio. nr. 180.
- 8 Hatib Bagdadi, *Tarihu Bagdad*. (Bejrut: daru'l-garbi'l-islamij), vëll. 6, fq. 31, bio. nr. 2517.
- 9 Ibën Tegriberdi, *El Nuxhumu'z-Zahirah*. (Kajro: Ministria e kulturës), vëll. 5, fq. 24.
- 10 Shiko: Dhehebi, *Tarihu'l-islam*. (Bejrut: daru'l-garbi'l-islamij, 2003), vëll. 9, fq. 434, bio. nr. 256; Dhehebi, *Sijeru ealamni'n-Nubela*. (Bejrut: muesesetu'r-risaleh, 1985, bot. III), vëll. 17, fq. 576, bio. nr. 380; Ibën Imad Hanbeli, *Shedheratu'dh-Dheheb*. (Damask: daru ibën Kethir, 1986), vëll. 5, fq. 131; *El Xhevahiru'l-Mudijeh*, vëll. 1, fq. 93, bio. nr. 180, etj.
- 11 Katip Çelebi, *Sulemu'l-Vusul ila Tabekati'l-Fuhul*. (Stamboll: el-mu'temeru'l-islamij), vëll. 1, fq. 200, bio. nr. 540.
- 12 Ibën Kemal Pasha, *Tabekatu'l-fukah*. (Botuar në revistën shkencore Islam Hukuku Arastirmaları Dergisi, 2009), nr. 14, fq. 365 dhe fq. 366.
- 13 Shihabudin Merxhani, *Nadhuratu'l-Hak*. (Aman: daru'l-fet'h, 2012), fq. 210; Zahid Keutheri, *Husnu't-Tekadi*. (Kajro: el-mektebetu'l-ez'herijeh, 2002), fq. 92.
- 14 Për veprat e Kuduriut shiko: Mulla Ali Lexuesi, *El Ethmaru'l-xhenijeh*. (Bagdad: Divan vakfi sunni, 2009), vëll. 1, fq. 331; *Sulemu'l-Vusul ila Tabekati'l-Fuhul*, vëll. 1, fq. 200.
- 15 Shiko: *El Xhevahiru'l-Mudijeh*, vëll. 1, fq. 93; Safedi, *El Vafi bi'l-vefejat*. (Bejrut: daru ihjai't-turath, 2000), vëll. 21, fq. 298; Hyrja studimore e veprës *El Lubab*, vëll. 1, fq. 333.
- 16 Shiko: Ibën Melek, *Sherhu Mexhmei'l-Behrajn*. (Eskishehir: Universiteti Osman Gazi, 2019, tezë doktorate e pabotuar nga Iljas Kaplani), vëll. 1, fq. 10.
- 17 <https://www.zaninalte.al/2022/05/medresete-ne-kosove-gjate-periudhes-osmane> (parë për herë të fundit më 6/12/2023); *Dituria Islame*, nr. 366, fq. 47 dhe *Dituria Islame* nr. 367, fq. 52
- 18 Për më shumë shiko: *Katalogu i dorëshkrimeve arabe në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës*, vëll. 1, fq. 485, vëll. 2, fq. 783.
- 19 Për detaje tjera rreth këtyre komenteve, si dhe për komente të tjera shiko: *Mesadiru'd-Dirasati'l-islamijeh*, vëll. 1, fq. 168-172.
- 20 Hyrja studimore e veprës *El Lubab*, vëll. 1, fq. 363; Selma bint Muxhiburrahman, *El Hadi ila rijadi'l-fikhi ve'l-fukah*. (Timergara: Mektebetu'l-imam Muhamed bin Hasen Shejbani), fq. 150.
- 21 *Katalogu i dorëshkrimeve arabe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës*, vëll. 1, fq. 409.
- 22 *Katalogu i dorëshkrimeve arabe në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës*, vëll. 2, fq. 789. Prof. Arnauti nuk ka pasur qasje në emrin e autorit dhe e ka lënë zbratur, edhe pse në historinë islame nuk ka libër tjetër që mban këtë titull dhe që është koment i Kuduriut jashtë veprës së Kaadurit.
- 23 *Katalogu i dorëshkrimeve arabe në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës*, vëll. 2, fq. 717.
- 24 Për biografinë e tij me ca mospërputhje në disa emra shiko në: Ibën Haxher, *Inbau'l-Gumër*. (Kajro: el-mexhlisu'l-eala, 1969), vëll. 3, fq. 505; Shemsudin Sehavi, *El Dau'l-Lamië*. (Bejrut: mektebetu'l-hajat, pa vit botimi), vëll. 3, fq. 96; Tekijudin Temimi, *El Tabekatu's-Senijeh*. (Rijad: daru'r-rifajj, 1986), vëll. 3, fq. 49; *Shedheratu'dh-Dheheb*, vëll. 9, fq. 315.



# Efektet shëndetësore pas agjërimit të Ramazanit

## (RAMAZANI TE DIABETIKËT)

Dr. Edita Blaka


Agjërimi në fenë islame nënkupton privimin nga konsumi i ushqimit, lëngjeve ose marrjes së medikamenteve nga koha e agimit e deri pas perëndimit të diellit. Agjërimi nuk është i menduar që ta rrezikojë jetën e njeriut.

Agjërimi me sëmundje të sheqerit ose diabet është një sfidë e veçantë, megjithatë shumë besimtarë me diabet këmbëngulin në mbajtjen e agjërimit, prandaj është e rëndësishme që profesionistët shëndetësorë të kenë njohuri lidhur me këshillimin e pacientëve për menaxhimin e diabetit gjatë muajit Ramazan.

### DIETA DIABETIKE

Për të filluar, ju duhet një pjatë që nuk është shumë e madhe (rreth 22 cm.). Tani që keni pjatën e duhur, është koha ta mbushni.

Imagjinoni dy vija të vizatuara në pjatën tuaj duke e ndarë atë në tri pjesë:



Mbushni gjysmën e pjatës suaj me perime pa niseshte. Perimet pa niseshte janë më të ulëta në karbohidrate, kështu që ato nuk e rrisin shumë sheqerin në gjak. Ato janë gjithashtu të larta në vitamina, minerale dhe fibra. Kjo i bënë ato një pjesë të rëndësishme të një diete të shëndetshme.

Shembuj të perimeve pa niseshte janë: specat, domatet, lakra (jeshile, e kuqe), karotat, trangujt, patëllxhani, bizelet, brokoli ose lulëlakra, kërpudhat, zarzavatet për sallatë si, spinaq, rukola, kunguj, selino, asparagusi etj..

Mbushni një të katërtën e pjatës suaj me ushqime me proteina pa yndyrë. Ushqimet me proteina (veçanërisht ato nga burimet shtazore) duhet të merren me masë, sepse zakonisht përmbajnë yndyra të ngopura, të cilat mund të rrisin rrezikun e sëmundjeve të zemrës.

Mbani në mend se disa ushqime proteinike me bazë bimore (si fasulet dhe bishtajore) janë gjithashtu të larta në karbohidrate.

Shembuj të ushqimeve proteinike me më pak yndyrë janë: pulë (të largohet lëkura), peshq si salmoni, merluci, toni ose peshku shpatë, prerje viçi pa dhjam, mish pa dhjam, djathë dhe gjizë, vezë.

Burimet e proteinave me bazë bimore janë: fasule, thjerrëza, humus, arra, tofu.

Mbushni një të katërtën e pjatës suaj me ushqime me karbohidrate. Këto ushqime kanë efektin më të madh në sheqerin në gjak. Kufizimi i pjesës suaj të ushqimeve me karbohidrate në një të katërtën e pjatës suaj, mund të ndihmojë që sheqeri në gjak të mos rritet shumë pas ngrënies.

Shembuj të ushqimeve me karbohidrate janë: drithërat integrale si, orizi kaf, bullgur, tërshërë/bollgur, kokoshka, quinoa dhe produkte me drithëra të plota (bukë, makarona,

tortilla), perime me niseshte si kungulli, bizelet e gjelbra, majdanozët, patatet, kungulli dhe patatja e ëmbël, fasule dhe bishtajore si fasulet e zeza, frutat dhe frutat e thata, qumështi dhe produktet e qumështit.

Pini ujë ose një pije me pak kalori. Uji është zgjedhja më e mirë, sepse nuk përmban kalori apo karbohidrate dhe nuk ka efekt në sheqerin në gjak. Opsione të tjera pijesh me zero ose me kalori të ulët përfshijnë: çaj pa sheqer (i nxehtë ose i ftohtë), kafe pa sheqer, ujë i gazuar.

### NË SYFYR:

Është e rëndësishme të mos anashkaloni vaktin e syfyrit, i cili duhet të hahet sa më vonë që të jetë e mundur, para fillimit të agjërimit ditor.

Ushqimet me niseshte të pasura me fibra si drithërat ose tërshëra, gruri bulgur ose orizi kafe ose i egër.

Thjerrëzat, qiçrat dhe fasulet janë burime të mira të proteinave dhe janë gjithashtu të larta në fibra.

Bashkujini ato me fruta dhe perime, pasi kjo mund të ndihmojë në parandalimin e kapsllëkut dhe për ta mbajtur zemrën tuaj të shëndetshme.

Para se të filloni agjërimitin e ditës, duhet të pini mjaft lëngje pa sheqer dhe pa kafeinë për të shmangur dehidrimin gjatë ditës.

### NË VAKTIN E IFTARIT:

Tradicionalisht agjërimiti mund të priset me hurma, ato janë të pasura me fibra, por janë edhe burim i pasur me karbohidrate. Dy hurma të mëdha mund të japin rreth 20 g karbohidrate, që është pothuajse e njëjtë me një fetë buke mesatare. Mundohuni të kufizoni numrin e hurmave në një, për të hapur agjërimitin ose hapni agjërimitin me një gotë ujë.

Praktika e zakonshme e gëlltitjes së sasive të mëdha të ushqimeve të pasura me karbohidrate dhe yndyra, veçanërisht në vaktin e perëndimit të diellit, duhet të shmanget.

Përpikuni të rehidrohni me lëngje pa sheqer – uji është alternativa më e mirë. Shmangni pijet e gazuara me sheqer ose lëngjet e frutave, pasi këto do të rrisin sheqerin në gjak dhe mund t'ju bëjnë të ndiheni më të etur.

Reziqet kryesore që lidhen me agjërimitin në pacientët me diabet:

Hipoglicemia (sheqeri i ulët në gjak);

Hiperqlicemia (sheqeri i lartë në gjak);

Ketoacidoza diabetike;

Dehidrimi (humbja e lëngjeve);

Tromboza (trashja e gjakut).

### UDHËZIME TË RËNDËSISHME:

Mbani gjatë agjërimit karbohidrate me veprim të shpejtë gjithmonë me vete;

Mbani gjatë agjërimit kartelën e diabetit me vete;

Testoni më shpesh se zakonisht vlerën e sheqerit në gjak çdo 2-4 orë dhe sa herë që nuk ndiheni mirë, se kjo nuk e ndërpret agjërimitin.

Nuk duhet të agjërohet në asnjë rast:

Në diabetin Tip 1 të pastabilizuar;

Në diabetin e kontrolluar keq;

Në diabetin me komplikime;

Në ketoacidozë;

Dhe gratë shtatzëna me diabet.

Përfundojeni menjëherë agjërimitin nëse:

Vlera juaj e sheqerit në gjak është nën 3,3 mmol/l, merrni karbohidrate me veprim të shpejtë;

Nëse vlera juaj e sheqerit në gjak është mbi 16 mmol/l, merrni ilaçet tuaja për uljen e sheqerit në gjak;

Nëse vëreni gjatë agjërimit shenja dehidrimi (shterjeje, humbje e lëngjeve), pini ujë;

Nëse gjatë agjërimit nuk ndiheni mirë dhe të dezorientuar.

Agjërimit të lehtë dhe të pranuar!

#### Referencat:

What is the diabetes plate method? [Internet]. Diabetes Food Hub. The American Diabetes Association; 2020 [cited 2023Mar7]. Available from: [https://www.diabetesfoodhub.org/articles/what-is-the-diabetes-plate-method.html?fbclid=IwAR3PhxdPWN0X3GX0EGRa-9Fwf0L3B\\_vab5O5xA7MQgKYx\\_egysNDBHAOPQ-8#:~:text=The%20Diabetes%20Plate%20Method%20is,you%20need%20is%20a%20plate](https://www.diabetesfoodhub.org/articles/what-is-the-diabetes-plate-method.html?fbclid=IwAR3PhxdPWN0X3GX0EGRa-9Fwf0L3B_vab5O5xA7MQgKYx_egysNDBHAOPQ-8#:~:text=The%20Diabetes%20Plate%20Method%20is,you%20need%20is%20a%20plate)

Jaleel MA, Raza SA, Fathima FN, Jaleel BNF. Ramadan and diabetes: As-saum (the fasting). Indian Journal of Endocrinology and Metabolism. 2011;15(4):268.

Al-Arouj M, Assaad-Khalil S, Buse J, Fahdil I, Fahmy M, Hafez S, et al. Recommendations for management of diabetes during Ramadan. Diabetes Care. 2010;33(8):1895–902.

Diabeti dhe Ramazani [Internet]. Schweizerische Diabetes-Gesellschaft; [cited 2023Mar7]. Available from: [https://assets.ctfassets.net/fclxf7o732gj/489BxDJT28IEiqsgWEwc4o/4aa256979533f6a142dd1de9d29d10c0/Diabetes\\_und\\_Ramadan\\_albanis](https://assets.ctfassets.net/fclxf7o732gj/489BxDJT28IEiqsgWEwc4o/4aa256979533f6a142dd1de9d29d10c0/Diabetes_und_Ramadan_albanis)

Tradicionalisht agjërimiti mund të priset me hurma, ato janë të pasura me fibra, por janë edhe burim i pasur me karbohidrate.

# Materiet ushqyese

Dr. Agron M. Rexhepi

Të ushqyerit e shëndetshëm nënkupton marrjen e grupeve të llojllojshme të ushqimeve me përbërës të llojllojshëm kimikë, të domosdoshëm për rritjen dhe zhvillimin normal të organizmit, sigurimin e energjisë së nevojshme për zhvillimin e proceseve metabolike...

Të ushqyerit e shëndetshëm nënkupton marrjen e grupeve të llojllojshme të ushqimeve me përbërës të llojllojshëm kimikë, të domosdoshëm për rritjen dhe zhvillimin normal të organizmit, sigurimin e energjisë së nevojshme për zhvillimin e proceseve metabolike, kryerjen e aktiviteteve të përditshme psiko-fizike, si dhe rikuperimin-shërimin optimal të lëndimeve të organizmit dhe mbajtjen e imunitetit në nivel të optimal. Llojllojshmëria e ushqimeve që i konsumojmë na siguron marrjen e elementeve të nevojshme ushqimore për rrjedhën normale të proceseve metabolike dhe të funksioneve fiziologjike të organizmit të njeriut. Njohja për elementet që i përmbajnë gjërat ushqimore dhe ndikimi i tyre na inkurajon në zgjedhjen e ushqimeve më kualitative për shëndetin e organizmit. Afërsisht janë 40 substanca të domosdoshme për mbarëvajtjen e proceseve biokimike dhe fiziologjike të organizmit, të përmbledhura në dy grupe të mëdha të materieve ushqyese:

**makronutrientët** (uji, karbohidratet, proteinat dhe yndyrat) dhe **mikronutrientët** (mineralet dhe vitaminat).

## MAKRONUTRIENTËT

Uji është i domosdoshëm për funksionimin normal të organizmit. Afro 60% e trupit të njeriut përbëhet nga uji. Të gjitha reaksionet e rëndësishme kimike ndodhin në prezencë të ujit. Uji mirëmban dhe rregullon temperaturën e trupit, transporton materiet ushqyese dhe oksigjenin, i largon produktet e fundit të metabolizmit apo të proceseve të tjera që ndodhin në organizëm, si dhe i mban të njoma gojën, sytë, hundën, flokët, lëkurën, traktin tretës dhe artikulacionet.

Karbohidratet janë grupi më i madh dhe kryesor i burimeve të energjisë në organizmin e njeriut. Përbëhen kryesisht nga tri elemente: karboni (C), hidrogjeni (H) dhe oksigjeni (O). Përmes lidhjes së këtyre elementeve, karbohidratet sigurojnë energjinë e nevojshme



për organizmin e njeriut, edhe atë në sasi, përafërsisht, 4 kilokalori për një gram të karbohidrateve (kcal/gr). Edhe pse karbohidratet nuk konsiderohen si materie esenciale, për organizmin kanë rëndësi të madhe si burime primare energjetike. Karbohidratet mund të jenë të thjeshta dhe komplekse. Glukoza (dekstroza) është karbohidrat i thjeshtë, i njohur edhe me emrin si sheqer i gjakut. Është karbohidrati më i rëndësishëm që, brenda qelizave të organizmit të njeriut, shërben si molekulë funksionale energjetike (bën gjenerimin e molekulave të larta energjetike adenoizintrefosfatit – ATP). Pas absorbimit në zorrët e holla, glukoza mund të përdoret drejtpërdrejt nga qelizat për fitimin e energjisë (proceset aerobe dhe anaerobe), mund të deponohet në formë të glikogjenit në muskuj dhe në mëlçi apo të konvertohet në lipide.

Proteinat përbëhen nga katër elemente: karboni (C), oksigjeni (O), hidrogjeni (H) dhe azoti (N). Në organizmin e njeriut kanë disa funksione: janë materie ushqyese ndërtuese, të domosdoshme për rritjen dhe riparimin e muskujve dhe të indeve të tjera të organizmit, marrin pjesë në funksionet biologjike, si formimi i proteinave strukturale, enzimave dhe hormoneve, si dhe, në kushte të posaçme të organizmit (kur rezervat e karbohidrateve janë shumë të vogla), mund të katabolizohen dhe të shërbejnë si burime energjetike. Njësi themelore e proteinave janë aminoacidet, të cilat janë 20. Prej tyre 8 janë esenciale për organizmin e rritur të njeriut (Valina, Leucina, Isoleucina, Lizina, Triptofani, Treonina, Metionina, Fenilalanina), ndërkaq dy aminoacide tjera (Histidina, dhe Arginina) janë esenciale vetëm për fëmijët (gjatë periudhës së rritjes). Djegia e një grami proteinash liron një sasi të energjisë, përafërsisht 4 kcal/gr.

Yndyrat janë burime të pasura të energjisë, medium i rëndësishëm për tretjen, absorbimin dhe shfrytëzimin e vitaminave liposolubile në organizëm (A, D, E, dhe K), mbajnë lëkurën të shëndoshë, mund të jenë antioksidantë, ndikojnë në metabolizëm, mund të kenë veprim në sistemin kardiovaskular dhe në imunitet (acidi linolenik), etj. Yndyrat mund të jenë në formë të dhjamërave dhe vajrave.

Yndyrat mund të jenë në formë të dhjamërave dhe vajrave. Përbëhen, kryesisht, nga tri elemente: karboni (C), hidrogjeni (H) dhe oksigjeni (O) (për dallim nga karbohidratet, yndyrnat kanë numër më të vogël të molekulave të oksigjenit, kjo veti edhe i bën të patretshme në ujë – insolubile).

Përbëhen, kryesisht, nga tri elemente: karboni (C), hidrogjeni (H) dhe oksigjeni (O) (për dallim nga karbohidratet, yndyrnat kanë numër më të vogël të molekulave të oksigjenit, kjo veti edhe i bën të jenë të patretshme në ujë – insolubile). Njësi themelore e yndyrave është molekula e glicerolit, që përbëhet nga tri atome të karbonit, secili i lidhur në zinxhirin e acideve yndyrore. Kjo strukturë është e njohur si trigliceride dhe paraqet një formë tjetër të depove energjetike. Sasia e energjisë që lirohet nga djegia e 1 gr. lipide është afërsisht 9 kcal/gr. Pjesa e tepërt e yndyrave deponohet në indet dhjamore.

### MIKRONUTRIENTËT

Mineralet janë bashkëdyzime inorganike, pasi që organizmi ynë nuk mund t'i sintetizojë, prandaj, për këtë shkak, është e domosdoshme të merren përmes ushqimit. Rreth 1% e ushqimit, që ne e konsumojmë, përmban minerale. Për shkak të strukturës së thjeshtë që kanë, mineralet janë të rezistueshme në temperatura të zierjes së ushqimit, pra nuk mund të shkatërrohen, por ka mundësi të largohen me ujin që zihet ushqimi. Mineralet kanë rëndësi të madhe strukturale dhe rregulluese. Disa minerale (kalciumi, fosfori) marrin pjesë në strukturën e eshtrave dhe të dhëmbëve, përderisa mineralet e tjera marrin pjesë në ruajtjen e ekuilibrit të lëngjeve në inde, në proceset kontraktuese të muskujve, funksionin e nervave, formimin e eritrociteve, si dhe në sekretimin e enzimave. Në bazë të sasisë me të cilën marrin pjesë në trupin e njeriut, mineralet ndahen në dy grupe:

Makromineralet – mineralet që marrin pjesë në organizëm në sasi prej miligramëve deri në gram (minerale të tilla janë kalciumi, fosfori dhe magnezi);

Mikromineralet – mineralet që marrin pjesë në organizëm në sasi shumë të vogël mikrogram – miligram (bakri, kromi dhe seleni).

Prej shumë mineraleve të gjetura në organizmin e njeriut, mendohet se 16 prej tyre janë esenciale.

Kalciumi është mineral esencial për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e eshtrave dhe të dhëmbëve, si dhe ka rëndësi të madhe në rritjen e muskujve, kontrahimin e muskujve



dhe përcjelljen e impulsit nervor (nerve transmission). Është me rëndësi që, nëse bëhen aktivitete fizike, të sforcuara, të merret sasi e madhe e kalciumit (p.sh. vrapimi, stërvitjet me pesha), pasi që, gjatë këtyre aktiviteteve, organizmi i njeriut mund të rrisë apo të zbrisë forcën absorbuese të kalciumit në eshtra – varësisht nga nevoja e organizmit. Hipokalcemia mund të shkaktojë mpirje të gojës, ngërqe të muskujve dhe simptome të tjera, ndërsa hiperkalcemia mund të shkaktojë gurët në veshka, çrregullime të ritmit të zemrës, shkurtimin e S-T segmentit në EKG, dhembjen e eshtrave, etj.. Burimet e kalciumit mund të jenë: qumështi dhe produktet e tij, sardina, perimet me ngjyrë të gjelbër të mbyllët, arrat, perimet bishtajore, etj.

Hekuri është jashtëzakonisht i rëndësishëm për sportistët. Funkzioni kryesor i hekurit është i lidhur me ndërtimin e hemoglobinës, e cila transporton oksigjenin në gjak, dhe me ndërtimin e mioglobinës, e cila transporton oksigjenin brenda qelizës muskulore. Shumë enzime muskulore, që kanë të bëjnë me proceset energjetike, kanë nevojë për hekur. Sportistët kanë nevojë më të mëdha për hekur, krahasuar me jospportistët. Burimet e mira të hekurit janë gjetur në mish, mëlçi, veshka, mish pile, drithëra, perime-gjethë me ngjyrë të gjelbër, etj.. Nga nutrientët e përmendur më lartë, hekuri i marrë nga ushqimet me origjinë shtazore absorbohet më së miri. Ky është shkaku se pse

**Vitaminat janë bashkëdyzime kimike, të cilat bëjnë pjesë në sasi të vogla në ushqimin që ne konsumojmë, si dhe janë të domosdoshme të jenë pjesë e dietës sonë. Vitaminat kanë funksione të ndryshme biokimike, si hormone, antioksidantë, mediatorë të qelizave dhe rregullatorë të rritjes dhe diferencimit qelizor dhe indor.**

vegjetarianët, për t'iu shmangur anemisë, duhet gjithsesi të marrin sasi shtesë të hekurit. Anemia, si pasojë e mungesës së hekurit, është dukuri e shpeshtë që paraqitet te femrat sportiste.

Zinku është mineral përbërës i shumë enzimave, disa prej të cilave kanë rëndësi në ndërtimin e proteinave që janë të rëndësishme për procesin e rritjes së indeve. Po ashtu, zinku ka rëndësi në ndërtimin e sistemit imunitar, ndërsa mund të gjendet në mish, të verdhët e vezës, produktet e qumështit, perimet bishtajore dhe në drithëra.

Magnezi është mineral i deponuar në tërë indet e organizmit. Është i nevojshëm për formimin e enzimave, të cilat lirojnë energji nga materiet ushqyese – pra është mineral shumë i rëndësishëm për sportistët. Po ashtu, ky mineral është i rëndësishëm për funksionimin normal të sistemit nervor, ekzekutimin e lëvizjeve muskulore, si dhe për mirëmbajtjen e eshtrave dhe të dhëmbëve. Burime të mira të magneziumit janë të gjitha pemët dhe perimet e gjelbra, drithërat e parafinuara, kikirikat, buka nga mielli i pasitur.

Fosfori. Rëndësia e fosforit është e lidhur me prezencën e kalciumit. Prezenca e fosforit e stabilizon kalciumin dhe në formën e kalcium-fosfatit rrit forcën e eshtrave dhe të dhëmbëve. Gati se të gjitha llojet e ushqimit, e sidomos ushqimi i pasur me proteina, e furnizojnë organizmin me fosfor.

Kaliumi është mineral jashtëzakonisht i rëndësishëm për mirëmbajtjen e ekuilibrit të lëngjeve në inde, për funksionimin normal të muskujve dhe të nervave. Ky mineral mund të gjendet në të gjitha frutat-pemët, perimet dhe drithërat.

Sulfuri, po ashtu, është mineral i rëndësishëm, i cili është pjesë përbërëse e shumë proteinave. Andaj, ushqimi i pasur me proteina i siguron organizmit, në sasi të mjaftueshme, këtë mineral.

Jodi është element esencial që në organizëm ndodhet në gjurmë. Ky element është përbërës i hormonit tiroksinë, i koncentruar në gjëndrën e tiroidesë. Përmes këtij hormoni, ky element bënë rritjen e metabolizmit, djegien e yndyrave, pengon akumulimin e kolesterolit, si dhe ndihmon në mbajtjen e peshës trupore në kufij të normales. Ky element, po ashtu, rregullon shfrytëzimin e oksigjenit nga qelizat e organizmit, prodhimin e energjisë, përmirëson funksionin mental, si dhe rritë kualitetin e

flokëve, thonjve, lëkurës dhe dhëmbëve. Jodi, në sasi të mjaftueshme për mbarëvajtjen e proceseve të organizmit, mund të sigurohet nga kripa e jodizuar dhe ushqimet nga deti (oqeanet).

Vitaminat janë bashkëdyzime kimike, të cilat bëjnë pjesë në sasi të vogla në ushqimin që ne e konsumojmë, si dhe janë të domosdoshme të jenë pjesë e dietës sonë. Vitaminat kanë funksione të ndryshme biokimike, si hormone, antioksidantë, mediatorë të qelizave dhe rregullatorë të rritjes dhe diferencimit qelizor dhe indor. Këto komponime kimike janë të domosdoshme për zhvillimin normal të proceseve metabolike dhe të funksioneve të ndryshme fiziologjike në organizëm. Meqenëse organizmi ka nevoja të vogla kuantitative për vitamina, këto komponime janë radhitur në grupin e mikronutrientëve që organizmi i njeriut nuk mund t'i sintetizojë. Gjithsej janë 13 lloje të vitaminave, klasifikimi i të cilave është bërë në bazë të vetisë së tyre tretëse në ujë - hidrosolubile (B kompleks dhe C), respektivisht në yndyrna - liposolubile (A, D, E dhe K).

Përderisa teprica e vitaminave të tretshme në ujë eliminohet nga organizmi, teprica e vitaminave të tretshme në yndyrna mund të grumbullohet dhe të bëhet toksike për organizmin. Vitaminat e tretshme në ujë, gjatë zierjes së ushqimit, shkatërrohen, kështu që nëse nuk bëhet me kohë rivendosja e këtyre vitaminave në mënyra të tjera, shumë shpejt mund të shkaktohet mungesa e tyre.

Mungesa e cilësdo prej këtyre 13 vitaminave bën që organizmi të mos funksionojë në mënyrë optimale.

### VITAMINAT E TRETSHME NË UJË (HIDROSOLUBILE)

Vitamina B<sub>1</sub> (Thiamina) ndihmon në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sistemit nervor dhe digjestiv, si dhe ndikon në lirimimin e energjisë nga karbohidratet. Nëse gjatë dietave të ndryshme mungon kjo vitaminë në gjërat ushqimore, atëherë

sigurisht se do të ketë nevojë për marrjen shtesë të kësaj vitamine. Në formë natyrale, kjo vitaminë gjendet në bukën nga mielli i pasitur, në drithëra, orizin me ngjyrë të kaftë, në perime bishtajore, mëlçi, etj..

Vitamina B<sub>2</sub> (Riboflavina) në mënyrë efikase vepron së bashku me hekurin, vitaminën B<sub>6</sub> dhe acidin folik, ndërsa merr pjesë në mirëmbajtjen e lëkurës, syve, nervave, si dhe ndikon në lirimimin e energjisë nga karbohidratet. Burimet natyrale të kësaj vitamine janë qumështi dhe produktet e tij, mishi dhe vezët.

Vitamina B<sub>3</sub> (Niacina) është esenciale për rritje normale dhe për lëkurë të shëndoshë. Ndihmon në mirëmbajtjen e sistemit nervor dhe digjestiv, si dhe në lirimimin e energjisë nga karbohidratet. Në formë natyrale gjendet në mish të kafshëve, mish të shpezëve, qumësht dhe produktet e tij, ve, arra dhe në drithëra. Meqenëse të gjitha këto vitamina kanë ndikim në lirimimin e energjisë nga karbohidratet, nevoja e sportistëve për këto vitamina është më e madhe se sa e jospportistëve.

Vitamina B<sub>5</sub> (Acidi Panthotenic) nevojitet për sintetizimin e glikozës dhe të acideve yndyrore nga përbërësit e tjerë ushqimorë. Merr pjesë në mirëmbajtjen e lëkurës, flokëve dhe të sistemit imunitar. Mungesa e kësaj vitamine do të ketë ndikim negativ në shëndetin e përgjithshëm, si dhe në performancat e sportistit. Burimet natyrore të kësaj vitamine janë: drithërat, perimet bishtajore, perimet, vezët, arrat dhe produktet e qumështit.

Vitamina B<sub>6</sub> (Pyridoksina) merr pjesë në metabolizmin e proteinave dhe të aminoacideve. Nevojitet për formimin e eritrociteve të reja dhe merr pjesë në ndërtimin e sistemit imunitar. Kjo vitaminë mund të gjendet në bukën nga mielli i pasitur, drithëra, peshq, banane, mish, mëlçi, etj.. Femrat që përdorin mjete kontraceptive kanë nevojë për sasi shtesë të vitaminës B<sub>6</sub>.



Vitamina B<sub>7</sub> (Biotina) nganjëherë referohet si vitaminë H, merr pjesë në metabolizmin e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrave, mirëmban lëkurën, thonjtë, është i domosdoshëm për rritjen e qelizave.

Vitamina B<sub>9</sub> (Acidi Folik) është esenciale për mbarëvajtjen e disa funksioneve të organizmit të njeriut: sinteza dhe riparimi i ADN-it, si dhe veprimi si kofaktor në reaksionet biologjike. Vitamina B<sub>9</sub>, posaçërisht, është e rëndësishme gjatë periudhës së ndarjes (mitoza) dhe rritjes së qelizave, si dhe në prodhimin e eritrociteve të reja në palcën e eshtrave (qelizat e kuqe të gjakut). Meqenëse te sportistët këto procese janë më të intensifikuara, edhe nevoja e tyre për këtë vitaminë është më e madhe. Burimet kryesore të Acidit Folik janë perimet-gjethë, drithërat dhe buka.

Vitamina B<sub>12</sub> (Cobalamina) ka rëndësi të madhe në funksionimin normal të trurit, të sistemit nervor, në formimin e eritrociteve, si dhe në metabolizmin e çdo qelize të trupit (sinteza e ADN-së, e acideve yndyrore, si dhe prodhimi i energjisë). Në formë natyrore, vitamina B<sub>12</sub> mund të gjendet në perimet-gjethë, perimet bishtajore, tharmë, mish, peshq, drithëra, qumësht dhe në produktet e tij. Vegjetarianët, për të kompensuar mungesën e vitaminës B<sub>12</sub>, duhet të konsumojnë më tepër drithëra dhe ushqime të fermentuara. Për të qenë më të sigurt vegjetarianët se në dietën e tyre nuk do të ketë mungesë të vitaminës B<sub>12</sub>, ata duhet të marrin sasi shtesë të multi-vitaminave.

Vitamina C (L-acidi askorbik) është nutrient esencial për njeriun, ndërkaq, së bashku me vitaminën E, është anti-oksidenti më i fuqishëm që mund të mbrojë kundër qelizave dëmtuese që lirohen gjatë aktiviteteve fizike. Vitamina C ndihmon në formimin e eritrociteve dhe në absorbimin e hekurit, ngrit imunitetin e organizmit duke e mbrojtur nga sulmet virale gjatë stërvitjeve të gjata dhe të intensitetit të lartë. Mungesa në organizëm e vitaminës C mund të shkaktojë gjakderdhje nga të gjitha membranat e mukozave, mbyllje të vonshme të plagëve të hapura, gjendje depresive, humbje të dhëmbëve. Vitamina C mund të gjendet në pemët e freskëta, lëngjet e pemëve, si dhe në perime (sidomos me

Disa materie ushqyese për njeriun janë esenciale për jetë. Që një materie ushqyese të jetë esenciale për njeriun duhet plotësuar dy kushte. Kushti i parë, nëse ajo materie ushqyese mungon në ushqim për një kohë, duhet të shkaktojë rënie (dobësim) të shëndetit, dhe kushti i dytë, pas kthimit materies së njëjtë në ushqimin e përditshëm, shëndeti duhet të përmirësohet (shenjat e paraqitura në mungesë të materies ushqyese zhduken).

ngjyrë të gjelbër). Sasia më e madhe e vitaminës C akumulohet në frutat e pjekura, sa më gjatë që rri fruti pas pjekjes së tij, aq më shumë humb sasia e kësaj vitamine. Duhaxhinjtë dhe sportistët kanë nevojë për sasi shtesë të kësaj vitamine. Në bazë të hulumtimeve të deritanishme, është vërtetuar se toksiciteti i vitaminës C është shumë i ulët. Dozë vdekjeprurëse e kësaj vitamine do të ishte nëse merren, përnjëherë, oralisht 11.9 gramë për kg peshë trupore. Ndërkaq, me dozat normale të vitaminës C, që përmes ushqimit merren brenda ditës, nuk mund të shkaktohet hipervitainoza. Më parë, është menduar se dozat e mëdha të Vitaminës C mund të formojnë gurët në veshka, por kjo nuk është vërtetuar me hulumtime shkencore.

## VITAMINAT E TRETSHME NË YNDYRA (LIPOSOLUBILE)

Vitamina A është kryesisht e deponuar në mëlçi (hepar), dhe është esenciale për funksionimin normal të retinës dhe adaptimin vizual (pamor) në errësirë. Po ashtu, kjo vitaminë është shumë e rëndësishme për shëndetin e lëkurës, traktin digjestiv, hundën, fytin, rritjen e fëmijëve, si dhe mbarëvajtjen e shtatzënësisë. Meqenëse vitamina A është e tretshme në yndyrë, mungesa e kësaj vitamine mund të shkaktohet në rastet e malabsorbimit të yndyrave, ndërkaq, burimet natyrore janë: yndyrat e mëlçisë së peshkut, mëlçia e kafshëve, qumështi me yndyrë të plotë, të verdhët e vesë, gjalpi, etj..

Vitamina D ndihmon organizmin tonë që të absorbojë dhe të shfrytëzojë kalciumin dhe fosforin (këto minerale janë vitale për ndërtimin e eshtrave të fortë dhe të shëndoshë). Çdo njeri që nuk i ekspozohet diellit, apo kanoset nga osteoporoza, ka nevojë për sasi shtesë të vitaminës D. Kjo vitaminë ndodhet në të gjitha produktet e qumështit, në vajin e peshkut, vezë, margarinë dhe në ushqimet e drithërave. Dozat e mëdha të vitaminës D mund të shkaktojnë plogështi të përgjithshme, etje, hiperdiurezë, rritje të shtypjes së gjakut dhe formim të gurëve në veshka.

Vitamina E është një antioksidant i fuqishëm, i cili parandalon oksidimin e acideve yndyrore në membranën qelizore, si

dhe i mbron qelizat nga dëmtimi i tyre. Vitamina E, po ashtu, merr pjesë në mbrojtjen e lëkurës, mirëmbajtjen e qarkullimit të gjakut, nervave, muskujve dhe eritrociteve. Vitamina E mund të gjendet në vajin e perimeve dhe të farave, vaj ulliri, vaj peshku, arra, fara, drithëra, në perimet e gjelbra, në bukën nga mielli i pasitur dhe në të verdhët e vezës.

Vitamina K ka rëndësi për formimin e disa proteinave që shërbejnë për koagulimin e gjakut. Mu për këtë, një person që merr antikoagulant nuk duhet të marrë shtesë vitaminë K. Po ashtu, kjo vitaminë merr pjesë në formimin e disa proteinave që ndikojnë në vitalitetin e eshtrave dhe të dhëmbëve. Vitamina K mund të gjendet në perimet e gjelbra, në patate, mëlçi, etj..

Disa materie ushqyese për njeriun janë esenciale për jetë. Që një materie ushqyese të jetë esenciale për njeriun duhet plotësuar dy kushte. Kushti i parë, nëse ajo materie ushqyese mungon në ushqim për një kohë, duhet të shkaktojë rënie (dobësim) të shëndetit, dhe kushti i dytë, pas kthimit materies së njëjtë në ushqimin e përditshëm, shëndeti duhet të përmirësohet (shenjat e paraqitura në mungesë të materies ushqyese zhduken).

Materiet ushqyese kanë funksione të shumëfishta, e disa edhe vitale për organizmin e njeriut. Materiet ushqyese japin energji, ndërtojnë organizmin, mbrojnë organizmin dhe marrin pjesë në proceset metabolike. Në bazë të funksioneve që kanë, materiet ushqyese mund të ndahen në tri grupe:

### **SIGURIMI I ENERGJISË:**

Karbohidratet;

Proteinat;

Yndyrat (dhjami dhe vajrat).

Rritja dhe zhvillimi:

Proteinat;

Lipidet;

Vitaminat;

Mineralet;

Uji.

Rregullimi i funksioneve të trupit:

Proteinat;

Lipidet;

Vitaminat;

Mineralet;


Uji.

Referenca:

Rexhepi, A. Nutricioni dhe sportistët, Prishtinë, 2010.  
Rexhepi, A. Nutrition, Health and Sport, Cambridge Scholars Publishing. 2022. Lady Stephenson Library, Newcastle upon Tyne, NE6 2PA, UK.







# Sami Frashëri, një erudit dhe enciklopedist i përmasave botërore

(ME RASTIN E 120-VJETORIT TË VDEKJES)


Mimoza Sinani

Nga imamët e fshatit Samiu mësoi shkrim-leximin e Kuranit, bazat e akaidit (apologjetikën, dogmatikën), fikhun (dispozitat), ahlakun (moralin), historinë islame, disiplinat letrare orientale etj.. Mësoi edhe bazat e gjuhës turke, arabe dhe persishte, të cilat më pas do t'i përdorte në punën e tij vëllimore shkencore.

## NJË VËSHTRIM ANALITIK I JETËS SË SAMIUT

Sami Frashëri lindi më 1850 në Frashër të Përmetit dhe vdiq më 1904 në Stamboll. Nëse i hidhet një vështrim tërësor e analitik jetës së Samiut, dallohet se tri vendbanimet e tij koincidojnë me tri etapat e formimit dhe të zhvillimit intelektual të tij:

1. Frashëri, ku kaloi fëmijërinë e tij;
2. Janina - qendër vilajeti, ku kaloi rininë; dhe
3. Stambolli - kryeqendra e osmanlinjve, ku ai arriti pjekurinë dhe afirmimin e plotë të tij.



Frashëri paraqet etapën e parë të jetës së Samiut. Këtu Samiu e thithi nektarin e parë të diturisë, të dashurisë së familjes, të popullit dhe të atdheut dhe, mbi të gjitha, të fesë së tij të lartë islame, në shenjë të së cilës do të luftojë gjatë gjithë jetës së tij.

Nga imamët e fshatit Samiu mësoi shkrim-leximin e Kuranit, bazat e akaidit (apologjetikën, dogmatikën), fikhun (dispozitat), ahlakun (moralin), historinë islame, disiplinat letrare orientale etj.. Mësoi edhe bazat e gjuhës turke, arabe dhe persishte, të cilat më pas do t'i përdorte në punën e tij vëllimore shkencore.

Në vitin 1865, Sami Frashëri u zhvendos në Janinë. Aty kreu shkollën e mesme greke "Zosimea", ku përveç kulturës së përgjithshme, përvetësoi greqishten e re dhe atë të vjetër, gjuhën latine, gjuhën frënge dhe atë italiane. Ndonëse zgjaste tetë vjet, Samiu këtë shkollë e kreu për shtatë vjet. Këtu ai mori një kulturë të gjerë klasike dhe fliste me admirim për metodat dhe lëndët që mësoheshin: historinë, gjeografinë, matematikën, astronominë, fizikën, kiminë, anatominë etj.. Nga mësuesit e medreseve të Janinës mësoi arabisht dhe persisht. Samiu e përshkruan Zosimean si shkollë të mesme perfekte, ku ai u pajis me një arsim relativisht të gjerë, në një ambient divers nga pikëpamja religjioze, etnike dhe kulturore. Përveç kësaj, ai siguroi mjete linguistike që e lejuan atë të lëvizë intelektualisht dhe



Ai ishte vlerësues dhe përkrahës i diversitetit etnik dhe gjuhësor të perandorisë, por ishte edhe përkrahës i shqiptarizmit.

linguist, islamolog, historian, politikolog, patriot, revolucionar, edukator, letrar, dhe shumë të tjera, janë të pakontestueshme dhe imponohen nga vetë vepra e shkruar dhe aktiviteti shkencor, intelektual dhe politik i Sami Frashërit. Samiu brenda një kohe relativisht të shkurtër botoi mbi 60 vepra të zhanreve të ndryshme, në shumë fusha (gazetari, publicistikë, gjuhë, leksikografi, shkencë, letërsi, islamologji, histori, kulturë, dramë etj.), dhe në shumë gjuhë (shqip, turqisht, arabisht, persisht, greqisht, frëngjisht etj.), gjë që dëshmon për përmasat e personalitetit poliedrik dhe enciklopedik të tij, duke u radhitur me të drejtë në shkallën e shkencëtarëve dhe të eruditëve më të mëdhenj botërorë.

Me një edukim solid, të kombinuar me një intelekt të mprehtë dhe kureshtar, Shemsedin Samiu, u shndërrua në një intelektual shqiptaro-otoman i dorës së parë. Ai ishte një person unik dhe i rrallë dhe si një intelektual, ai lëvizi me lehtësi midis dy botëve, otomane dhe asaj shqiptare.

emocionalisht nëpër kultura të ndryshme. Janina paraqet rininë e Samiut dhe themelet e formimit të tij intelektual dhe politik.

Në vitin 1872, Sami Frashëri, ose siç njihet në librat e tij Shemsedin Sami, u vendos në Stamboll, ku zhvilloi veprimtari të gjerë intelektuale dhe patriotike. Në Stamboll, jeta e përditshme e Shemsedin Samiut zhvillohej në një mjedis shumë-gjuhësh, shumë-etnik, dhe shumë-religjioz. Ai ishte vlerësues dhe përkrahës i diversitetit etnik dhe gjuhësor të perandorisë, por ishte edhe përkrahës i shqiptarizmit. Që nga viti 1872 e deri në vdekje, më 1904, Samiu ka qenë mjaft aktiv në shumë pikëpamje. Së pari filloi të preokupohet me gazetari dhe zuri vend të dalluar në gazetarinë dhe publicistikën turke. Ai ishte gazetar i talentuar dhe ka qenë redaktor në tetë gazeta e revista, si gazeta “Sabah” (“Mëngjesi”), ku për një kohë ishte kryeredaktor, “Hafta” (“Java”), Tarabulus, Terxhuman Shark, Aile, Siraxh, Hadika dhe Muharrir. Po ashtu, ai bashkëpunoi edhe me gazeta dhe revista të tjera të Stambollit.

### PERSONALITETI POLIEDRIK I SAMI FRASHËRIT

Samii Frashëri ka trajtuar tema kulturore-shkencore të ndryshme me një thellësi, largpamësi dhe mbështetje shkencore të rrallë për kohën e tij, në tërë multidimensionalitetin dhe kompleksivitetin e vet. Cilësimet si: shkencëtar, mendimtar, filolog, leksikograf, publicist,

Shemsedin Samiu ishte autor i një numri romanësh dhe dramash, dhe publikoi disa libra, të tillë si: “Gratë” (Kadinlar), “Qytetërimi Islamik” (Medenijet-i Islamiye) dhe “Njeriu” (Insan).

Përveç të tjerash, Samiu bëri përkthimin dhe shpjegimin e “Vjershave të Ali ibën Ebi Talibit” në turqisht, më 1900. Ai përktheu edhe “El Mual-laka’us-seb’a” (Shtatë poezitë e varura) paraislame, të pabotuara, në vitin 1902, në formë shënimesh.

Samiu njihet edhe si autori i romanit të parë të turqishtes moderne “Dashuria e Talatit me Fitnetin” dhe si hedhësi i themeleve për alfabetin e gjuhës turke. Ai shkroi edhe një varg gramatikash për gjuhët orientale. Ai përpiloi një gramatikë dhe hartoi alfabetin e Stambollit që u njoh me emrin e tij.

Ai gjithashtu kompiloi një fjalor frëngjisht-turqisht (Kamus-i fransevi, 1882) dhe një fjalor turqisht-frëngjisht (Kamus-i fransevi, 1884), një fjalor arabisht (Kamus-i arabi, 1898), një enciklopedi me gjashtë vëllime Kamus el-A’lam (1889-1899) dhe një fjalor turqisht me dy vëllime (1898-1901). Fjalori normativ i gjuhës turke “Kamus-i türki”, i cili ruan vlerën e vet të madhe edhe në ditët e sotme, përmban mbi 40 mijë fjalë e shprehje gjuhësore dhe është pajisur me një parathënie të gjatë të shkruar nga vetë autori. Jo më kot, Samiun e kanë quajtur ‘enciklopedi lëvizësë’. Biblioteka personale e Sami Frashërit kishte 20.000 vëllime.



Gjatë gjithë jetës së tij, ai u ndie i afërt me letërsinë dhe kulturën frënge dhe përktheu një numër librash nga frëngjishtja në gjuhën otomane, duke përfshirë edhe *Les Miserables*. Ai hartoi tekste të ndryshme, botoi antologji me pjesë të zgjedhura nga letërsia botërore dhe kryesisht orientale. La në dorëshkrim 11 vepra kryesisht nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë.

Një numër dorëshkrimesh të pabotuara që merren me studime të turqishtes mbijetuan pas vdekjes së tij në vitin 1904, në moshën pesëdhjetë e katër vjeçare. Për të gjithë këtë aktivitet, Shemsedin Samiu fitoi një vend të shquar në historinë intelektuale otomane.

### SHËRBIMI PËR POPULLARIZIMIN E ÇËSHTJES SHQIPTARE

Samiu ishte një nga nismëtarët kryesor të veprimtarisë kulturore të kolonive të shqiptarëve në Stamboll. Ai ishte një ndër organizatorët kryesor të “Komitetit Qendror për

mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare”. Samiu ishte edhe këshilltari kryesor politik i të vëllait, Abdylit, në Lidhjen e Prizrenit më 1878. Në vitin 1879, ai ishte ndër themeluesit kryesorë të “Shoqërisë së të shtypurit shkronjat shqip” dhe u zgjodh edhe kryetar i saj.

Ai drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe si “Drita” dhe më pas “Dituria” në Stamboll në vitet 1885-1884, në të cilat shkroi një varg artikujsh. Për të ndihmuar disa prej nevojave të shkollës shqipe hartoi librat “Abetare e gjuhës shqipe” (në vitin 1886), “Shkronjtore e gjuhës shqipe” (në vitin 1886) dhe “Shkronjë” (në vitin 1888).

Në vitin 1886, kur të gjitha shenjat dëftenin një shtypje të plotë të aktivitetit shqiptar kulturor dhe arsimor, Shemsedin Samiu, i patrembur nga pengesat, luajti një rol të rëndësishëm në sigurimin e lejes së sultanit për hapjen e një shkolle fillore private shqiptare për djem në Korçë, e cila u hap në 7 mars të vitit 1887. Për shkak të mungesës fillestare të materialeve në gjuhën e tyre amtare, Shemsedin Samiu, vëllai i tij Naimi, dhe disa shqiptarë të tjerë shkruan tekstet mësimore për shkollën.

Përveç veprave të lartpërmendura dhe botimeve të tjera në gjuhën otomane, Shemsedin Samiu ishte gjithashtu autor i disa veprave në gjuhën shqipe, që përfshinin një pamflet mbi alfabetin, një libër gramatike, një antologji dhe një traktat politik.

Në një artikull, ai pohonte se shqiptarët dëshironin të ishin të aftë që të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën e vet atyre, gjë që do t’u shërbente si një mbrojtje efektive kundër forcës cenuese të sllavizmit dhe helenizmit. Shemsedin Samiu i paralajmëroi të gjithë bashkatdhetarët shqiptarë nëpërmjet artikujve të gazetave rreth qëllimeve greke për t’u zgjeruar në dem të shqiptarëve.

Për kontributet e tij në zhvillimin e letërsisë kombëtare në gjuhën e tij amtare, historianët shqiptarë me të drejtë e kanë vlerësuar Shemsedin Samiun si një nacionalist shqiptar.

### ELEMENTI ISLAM NË VEPRAT E SAMIUT

Disa studiues shqiptarë, për shkak të subjektivitetit të theksuar dhe ngjyrimin ideologjik, e kanë cilësuar me pa të drejtë Samiun si filozof me prirje epikurjane, si idealist, racionalist, iluminist që godiste fort misticizmin dhe obskurantizmin oriental, dhe si një njeri kundër besimit të Zotit dhe të feja.

Angazhimi i Samiut për pavarësinë e tokave shqiptare nuk ishte luftë kundër fesë islame, por luftë kundër një sistemi të caktuar politik turk të shekullit XIX. Sa i përket fesë islame, Samiu, në veprën e tij “Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit”, deklaroi qartë: “Falënderimi i qoftë Zotit që ka thënë: “Te Zoti fe e vërtetë dhe e pranuar është vetëm Islami”.

Elementi islam dhe fryma islame është e pranishme thajse në çdo shkrim të Samiut, si në veprat tërësore, që janë në

gjuhën shqipe, ashtu edhe nëpër artikuj gazetash e revistash, të cilat janë analizuar apo janë cituar nëpër shkrime të ndryshme.

Elementi islam është i pranishëm në veprat “Qytetërimi Islam”, “Përpykja e heronjve në përhapjen e Islamit”, “Qielli”, “Njeriu”, “Përsëri njeriu”, “Toka”, “Gratë”<sup>1</sup> e të tjera, pastaj në Fjalorët e Samiut, me rastin e shpjegimeve të fjalëve apo nocioneve të ndryshme.

Samiu në disa raste pohon se Islami është besim dhe veprim, mendim dhe veprim, trup dhe shpirt, rrugë e jetës në këtë botë dhe në botën tjetër, Islami është përpykje për rregullimin e botës me ndihmën e edukimit dhe të ligjit, të dorëzimit në rrjedhat e ligjësive të Krijuesit. Sami Frashëri është simbol i një simbioze kulturore turko-shqiptare, të bazuar në shtratin e qytetërimit islam. Ai është një fenomen i shkëlqyer i kulturës shqiptare myslimane dhe i kulturës në përgjithësi. Është vështirë që në një shkrim të këtij lloji të theksohet e tërë vepra e Samiut, prandaj në vazhdim do të theksojmë shkurtimisht vetëm disa nga veprat e Samiut.

### “BESA JAHUD AHDE VEFA” (BESA OSE MBAJTJA E PREMTIMIT)

Ka kaluar një hark kohor prej njëqind e pesëdhjetë vjetësh që kur drama “Besa jahud Ahde Vefa” u vu në skenë në teatrin perandorak në Stamboll më 1874. Kjo dramë e ka marrë subjektin nga jeta shqiptare dhe u botua më 1875.

### “SHQIPËRIA ÇKA QENË, ÇËSHTË DHE Ç’DO TË BËHET?”

Kjo vepër, e cila shtjellon idetë mbi çështjen kombëtare, u botua në Bukuresht, në vitin 1899, pa emrin e tij. Me këtë vepër Samiu, siç është pranuar nga të gjithë, u bë ideologu më i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke përfaqësuar një nga majat kulmore të mendimit politik shqiptar të Rilindjes. Kjo vepër u bë manifesti politik i Lëvizjes Kombëtare dhe mbeti dokumenti kryesor programatik i saj deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

### “QYTETËRIMI ISLAM” (MEDENIYETI ISLAMIYE)

Në vitin 1879, Samiu botoi veprën e të tij të rëndësishme me titull “Qytetërimi islam”, me

Samiu në disa raste pohon se Islami është besim dhe veprim, mendim dhe veprim, trup dhe shpirt, rrugë e jetës në këtë botë dhe në botën tjetër, Islami është përpykje për rregullimin e botës me ndihmën e edukimit dhe të ligjit, të dorëzimit në rrjedhat e ligjësive të Krijuesit.

123 faqe, format xhepi. Qytetërimi islam, sipas Samiut, ka dhënë kontributin e vet në krijimin e qytetërimit evropian, duke shënuar një shkallë më të lartë se qytetërimi grek. Dijet e ruajtura nga shkolla e Aleksandrisë u morën dhe u çuan më tej nga qytetërimi islam për t’ia transmetuar qytetërimit të sotëm evropian.

### “KAMUS EL-A’LAM” (FJALORI I EMRAVE TË PËRVEÇËM)

“Kamus’ul a’lami” ka gjashtë vëllime me 4.830 faqe dhe është enciklopedi historiko-geografike, përkatësisht një leksikon i personaliteteve të shquara botërore në fushën e të letërsisë, të shkencës, të politikës, të drejtësisë, të fesë në tërësi, që nga kohët më të vjetra e deri në kohën kur është shkruar.

<sup>1</sup> Për një shqyrtim më të hollësishëm të librit “Gratë” të Sami Frashërit shih: Mimoza Sinani, “Gratë”, Edukata Islame, nr. 76, Prishtinë, 2005.

#### Literatura

- Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, (Shkup: Logos-A, 2013)
- Hasan Kaleshi, *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*, (Shkup: Logos-A, 2010)
- Hasan Kaleshi, *Vepra – I*, (Shkup: Logos-A, 1996)
- Sami Frashëri, *Vepra 8*, (Prishtinë: Rilindja, 1984)
- Sami Frashëri, *Gjuha*, (Shkup: Logos-A, 2002)
- Sami Frashëri, *Vepra 5. Shkronjëtoje e gjuhës shqipe*, (Prishtinë: Rilindja, 1979)
- Sami Frashëri, *Përpykja e heronjve në përhapjen e e Islamit*, (Shkup: Logos-A, 2003)
- Sami Frashëri, “*Shqipëria çka qenë, çështë dhe ç’do të bëhet?*”, (Prishtinë: Rilindja, 1999)
- Sami Frashëri, *Vepra 10*, (Prishtinë: Rilindja, 1999)
- George Gawrych, *The Crescent and the Eagle: Ottoman rule, Islam and the Albanians, 1874–1913*, (London: IB Tauris, 2006).
- Nexhat Ibrahim, *Tema dhe personalitete shqiptare, Vepra 8*, (Shkup: Logos-A, 2009)
- Mehdi Polisi, *Sami Frashëri në fushën e islamistikës*, në: Sami Frashëri, *Vepra 10*, (Prishtinë: Rilindja, 1999)
- Feti Mehdiu, *Kamus’ul-a’lami i Sami Frashërit*, parathënie në: Sami Frashëri, *Vepra 7*, (Prishtinë: Rilindja, 1984)
- Rexhep Qosja, *Prej tipologjisë deri në periodizim*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1979)
- Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi*, III, (Prishtinë: Rilindja, 1986)
- Mahmud Hysa, *Alamida shqiptare I*, (Shkup: Logos-A, 2000)
- Milazim Krasniqi, *Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar*, (Prishtinë: Zëri Ynë, 2003)
- Dhimitër Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*, botimi VI, (Prishtinë: 1979)
- Zija Xholi, *Sami Frashëri – Monografi, Vepra IV*, (Prishtinë: Rilindja, 1978)
- Gazmend Shpuza, (“*Shqipëria çka qenë, çështë dhe ç’do të bëhet?*”), Revista Perla, nr. 31, Tiranë, 2003.



# Kontributi i librit “Siasset Nameh” në fushën e administrimit

Klodiana Xhaferraj


Autori i librit, nëpërmjet eksperiencës dhe aftësisë së tij, sqaron metodat e suksesshme të çështjeve të cilat ndërlihen me udhëheqjen shteteve dhe qeverisjen e tyre.

Libri zë një vend prestigjioz mes gjithë librave, të cilat trajtojnë sistemet qeverisëse të vendeve islame. I gjithë libri është ndërtuar mbi ngjarje reale të mbretërve dhe sunduesve të kohës së autorit, apo edhe më herët. Autori i librit, nëpërmjet eksperiencës dhe aftësisë së tij, sqaron metodat e suksesshme të çështjeve të cilat ndërlihen me udhëheqjen shteteve dhe qeverisjen e tyre. Është dokumenti më i mirë, i cili hedh dritë mbi epokën në të cilën jetoi autori i librit, Nizam el Mulk. Ky libër përfaqëson një eksperiencë personale të autorit. Askush para tij nuk ka shkruar një vepër të tillë, të mbushur me këshilla për mbretërit. Madje, as libri “*El Ahkam es Sultaniye*”, i kryegjykatësit të Bagdadit, El Maverdi, i cili ka vdekur në vitin 450 hixhri, por që në të, nuk ka përfshirë eksperiencën e tij. Autori ka mbajtur distancë mes eksperiencës jetësore dhe asaj çfarë ka sjellë në libër. Përveç fushës së politikës, arrin të kuptosh edhe gjendjen fetare, ideologjike, administrative, historike, sociale dhe qytetërimin e asaj kohe. Në libër, autori trajton gjithashtu rrymat dhe sektet e devijuara të kohës së tij, siç ishte lëvizja Ismailie batinije. Libri është tejet konciz dhe i qartë në të shprehur, i zhveshur prej fjalëve të tepërta apo zgjatimeve të panevojshme. Është përkthyer në disa gjuhë të huaja, në gjuhën franceze, u përkthye në vitin 1891, në gjuhën ruse, në vitin 1849, në gjuhën turke, në vitin 1954, në gjuhën gjermane, në vitin 1960, në gjuhën angleze, në vitin 1961.

Në libër do të gjejmë këshilla sesi duhet të jetë një gjykatë: “Duhet të njihet gjendja e gjykatësve të shtetit një më një. Ata duhet të jenë dijetarë, zahid dhe besnikë. Kush nuk i ka këto cilësi, duhet të pezullohet, duhet të emërohen të tjerë që janë të pajisur me këto cilësi. Gjykatësi duhet të ketë rrogë të mirë, e cila duhet t’i mjaftojë të plotësojë kërkesat e tij, në mënyrë që të mos rrëshqasë në tradhti. Kjo është një detyrë e rëndësishme dhe e përpiktë, sepse gjaku i myslimanëve dhe pasuria e tyre janë në dorë të gjykatësve. Dhe në rast se ndonjë gjykatës jep ndonjë vendim prej paditurisë, egos apo me qëllim, duhet gjykatësit e tjerë të mos e zbatojnë atë vendim, të njoftohet udhëheqësi për këtë gjykatës, të pezullohet dhe të ndëshkohet.”

Për vezirët do shkruante: “Nëpunësit dhe detyrat e tyre janë të varura prej vezirit. Nëse veziri është i drejtë, e bën reputacionin e mbretit-udhëheqësit si dhe jetëshkrimin e tij të mirë. Prandaj atyre mbretërve të mëdhenj ku bota u është në borxh si dhe atyre të cilëve do t’u mbeten emrat të lidhur me përkujtimin e veprave të mira deri në Ditën e Kiametit, ata, pikërisht ata kishin vezirët e zgjedhur.

Kemi shembujt nga historia e profetëve, siç ishte Musai a.s., i cili kishte vëllain e tij Harunin si ndihmës, pastaj Isain a.s., i cili kishte Simonin si ndihmës, pastaj Muhamed Mustafaja a.s., i cili kishte Ebu Bekrin r.a., etj., shembuj nga historia islame dhe e njerëzimit.



Veziri duhet të ketë fe të pastër, besim të drejtë, i medhhebit përkatës, efikas, i aftë për të administruar dhe i komunikueshëm, dhe më e mira, të rrjedhë prej një familje me traditë në këtë fushë.”

Për hatibët, ligjëruesit në ditën e xhuma, do të këshillonte duke thënë: “Hatibët të cilët falen me njerëzit në xhamitë qendrore, duhet të zgjidhen të devotshëm dhe të jenë hafëzë të Kuranit. Namazi hyn në atë kategorinë e çështjeve të përcaktuara qartë: namazi i xhematit është i varur prej imamit; e në rast se prishet namazi i tij, prishet edhe namazi i xhematit.”

### **KUSH ËSHTË AUTORI I KËTIJ LIBRI TË RRALLË PËR KOHËN E TIJ?**

Veziri reformator, shehidi Ebu Ali el Hassan ibën Ali ibën Is`hak el Tusi, i njohur ndryshe në historinë islame si: Veziri i Madh, Kavam el Din, ndërsa kalifi abasit e quante “Razi emir el muminin”, i cili ishte një titull që nuk iu dha askujt as para tij dhe as pas tij, për aftësitë që kishte për të afruar këndvështrimet për çështje të ndryshme ndërmjet abasitëve dhe selçukve. Por ajo që i mbeti si sinonim dhe me të cilën njihet në të gjithë librat e historisë është “Nizam el Mulk”, Allahu e mëshiroftë, një ndër personalitetet më të mëdha të historisë islame, i cili ka pasur një rol të rëndësishëm në shërbimin e sheriatit islam në të gjitha nivelet e saj: qeverisës, administrativ, ndërtues dhe përpilues.


Ka pasur rol kyç, të rëndësishëm në luftën kundër zgjatimeve të shiave batinij. Përdori të gjithë forcën që dispononte për t’u bërë ballë, dhe pikërisht për këtë, vrasja e parë që organizuan batinijët kundër personaliteteve suniteve, ka filluar me Nizam el Mulk dhe vazhdoi me një seri vrasjesh të figurave të rëndësishme të administratës ushtarake dhe qeverisëse selçuke e ejubije.

Ka lindur në vitin 1017 në lindje të Iranit, në fshatin Tus të rajonit Horasan. Ishte i zgjuar, mendjemprehtë, largpamës, administrues i aftë, politikan i aftë, i cili drejtoi politikën udhëheqëse të dy prej figurave të rëndësishme selçuke, Alp Arslanit dhe birit të tij, Malik Shahut, si dhe ka qenë këshilltar politik pranë babait dhe gjyshit të Alp Arslanit. Rreth 40 vjet eksperiencë në administrimin politik të shtetit, të cilat i hodhi në librin e tij “Siasat Nameh”, të cilin e shkroi pasi arriti kulmin e eksperiencës së tij pranë Malik Shahut.

U rrit jetim pa nënë. I ati merrej me tregtinë e Mahmud ibën Subktekin, por dëshira e tij ishte t’i jepte të birit edukatën dhe arsimin më të mirë. U arsimua sipas shkollës juridike shafite. Për këtë, në moshën 10 vjeçare, mësoi leximin e Kuranit, mësoi shkencat e Kuranit, jurisprudencën, gjuhën arabe, gramatikë, dëgjoji hadithe. Punoi që i vogël në kopshte në periferi të Tusit. Por, më vonë transferohet drejt qytetit Gazni (Afganistan) ku punon në divanin e sulltanit.

Mjedisi në të cilin u rrit, megjithëse modest, ndikoi pozitivisht në rritjen dhe edukimin e mirë të tij. Mori edukatë dhe dituri të dobishme. Ndoqi mësimet e fesë prej dijetarëve të njohur të asaj kohe, të cilët ishin të shumtë, si: Koshejri, El Az`hari etj.. Ishte i devotshëm, bamirës dhe siç e përshkruajnë historianët, anonte drejt njerëzve të mirë. Dëgjonte me vëmendje këshillat dhe vërejtjet që i bëheshin, pëlqente njerëzit të cilët ia vinin në dukje të metat dhe qante për to. Në librat e historisë do të gjejmë të shkruar rreth tij: “Ai, Nizam el Mulku, ishte i dhënë pas uljes në kuvendime me dijetarët dhe fukahatë; kalonte goxha kohë pranë tyre. I thanë: Ata po të pengojnë ndaj kryerjes së shumë punëve. Ndërsa ai ua ktheu: Ata janë bukuria e kësaj dynjaje dhe Ahiretit. Ata mi vënë në dukje të metat dhe padrejtësitë, duke bërë që të zbrapsem prej vendimeve të padrejta. Ishte njeri me ambicie të mëdha. Krahas marrjes së diturisë, punonte pranë emirëve. Kjo ndodhi, pati ndikim të fortë tek ai, dhe e mori si një shenjë që t’u shërbente vetëm njerëzve të drejtë. Ishte i ndjeshëm ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, gjë e cila e shtyri drejt zuhdit.

Në të gjitha pozicionet e administratës ku u vendos, i kreu detyrat në formën më të mirë, derisa ftohet të punojë vezir gjatë sundimit të Alp Arslanit, duke qenë numri dy i pushtetit në kohën kur ky sulltan ishte ndër më të fuqishmit e kohës së tij. Më pas i shërbeu djalit të tij, Malik Shahut, ku konturoi gjithë politikën e jashtme dhe të brendshme të shtetit duke përfutur prej njohjes dhe eksperiencës së tij të sistemimit të



administrimit të shtetit në të gjitha nivelet dhe hapësirat e saj. Të gjithë eksperiencën e tij e grumbulloi dhe e hodhi në librin të cilin e shkroi. Që në hyrje të librit jep qëndrimin e tij të prerë kundër ndërhyrjes së miqve, shokëve të afërt të sultanit në punët e shtetit, në mënyrë që të mos trazohej administrimi i shtetit. I gjithë letërkëmbimi i shtetit ishte në dorën e tij. Kishte dërguar në të gjitha skajet e perandorisë informatorët e tij të veshur herë si tregtar, e herë si turist, si dervishë dhe si sufistë, si investitorë etj., të cilët e furnizonin me informacione. Të gjitha këto informacione ia përcillte sultanit një me një, duke mos i fshehur asgjë. Në të gjitha rajonet i ndryshonte valinjët dhe nëpunësit në çdo 2-3 vjet, që të mos kishin mundësi të korruptoheshin. Në çdo rajon caktonte një inspektor të ndershëm, i cili mbikëqyrte valiun, financierin dhe gjykatësin, të cilët i jepnin informacion të detajuar për çfarë ndodhte. Nëpunësit i zgjidhte të ishin të ndershëm dhe të zotëronin dije të gjera.

I kushtoi vëmendje shtëpive të adhurimit, ndërtoi xhami të shumta në të gjithë hapësirën selçuke. U kujdes për arkitekturën e dy haremeve fisnike: Mekës dhe Medinës, ndërtoi maristan në Nisabur (spital); krijoi zavije të shumta në Irak dhe Faris, të cilat mbusheshin prej besimtarëve, asketëve, të varfërve duke u siguruar ushqime dhe mbulesa.

Në kohën e qeverisjes së tij, bota islame njohu lëvizje të cilën nuk e kishte parë deri në atë kohë: ngritjen e diturisë në shërbim të fesë islame e shariatit të tij. I vuri dijetarët në pozitën që u takonte. Ndërtoi shkolla në të gjitha qytetet e rëndësishme, madje thuhet se në Irak ai ndërtoi shkolla për çdo qytet. Rrjeti i shkollave, të cilat njihen me emrin NIZAMIJE, shtriheshin në të gjithë hapësirën ku sundonin selçukët si dhe tokat që ishin nën sundimin abasit. Mori pjesë drejtpërsëdrejti në ndërtimin e shkollës së parë të tij Nizamie

dhe ku si mësues vendosi dijetarin e njohur Ebu Is`hak el Shirazi. Pozitën më të lartë mes njerëzve, dijetarët e kanë pasur vetëm gjatë kohës së qeverisjes së tij. Fëmijët e tij i këshilloi të ecnin hapave të tij në respektin ndaj dijetarëve, imamëve e kujdestarëve të shkollave (medreseve); të kontrollonin gjendjen e tyre si dhe të interesoheshin në rast se mungonin. Po kështu edhe në mesazhin që i dërgoi vezirit të kalifit abasit, Ibën Xhehiri, i sqaron në letër se një ndër shkaqet që e shtyu të ndërtonte këto qendra për dijetarët (medresetë nizamije dhe xhamitë) ishte që t`u jepte një vend të merituar dijetarëve. Nizam El-Mulku nuk ishte fanatik pas një medhhebi të caktuar: t`i jepte përparësi një medhhebi në kurriz të medhhebeve të tjera pavarësisht se ai ishte pasues i medhhebit të Imam Shafiut. Ai në medresetë e tij lejoi edhe medhhebet e tjera sunnite të studioheshin. Madje ndërhynte të shuante ndonjë zënkë që mund të ndodhte mes dialoguesve të medhhebeve të ndryshme, pa mbajtur anën e asnjërës palë. Sipas shënimeve të dijetarit Shirazi, Nizam el Mulku është i pari që reklamoi të gjitha medhhebet e kohës dhe nuk u bë burim fitneje, nuk i ndërtoi nizamijet për të përçarë ymetin. Madje në fund të shënimeve të tij, Shirazi, i drejton një mesazh kërcënues Nizam el Mulkut, se, nëse medresetë në të ardhmen, nuk ecin sipas asaj që janë projektuar, më mirë të mbyllen.

Merrej drejtpërsëdrejti me çështjet e organizimit ushtarak, duke marrë pjesë vetë në luftëra bashkë me fëmijët e tij.

Për diturinë e tij kanë thënë se zotëronte atë dituri të kësaj bote ku asnjë tjetër nuk e kishte arritur. Ishte dijetar fakih, modest, i drejtë, pëlqente njerëzit e dijes dhe i shpërblente. Njerëzit më të dashur dhe të afërt tek ai ishin dijetarët. Sadakatë e tij si dhe vakëfet, nuk kishin kufij. Të gjitha shkollave që ndërtoi, nuk u mungonte asgjë deri edhe në ishullin më të largët në cep të botës islame, në ishullin Ibën Omer, ndërtoi shkollë të madhe ku nuk mungonte asgjë, shkollë e cila njihet sot me emrin Razi el Din. Kalonte pjesën më të madhe të ditës në kuvendet e dijetarëve të çështjeve të kësaj bote apo të Ahiretit.

Përgjatë 30 vjetëve administrim, sistemoi çështjet e shtetit, mbikëqyrte çështjet administrative, financiare dhe politike; inkurajonte prodhuesit dhe tregtarët, rregullonte rrugët, urat, hanet, duke i bërë ato të sigurta për tërë udhëtarët. Ishte mik i artistëve, poetëve dhe dijetarëve. Dora ndihmëse për të varfërit. U vra me 10 ramazan te vitit 485 hixhri.

#### Referencat:

- Ali Muhamed el Sallabi, *Deuletü El'Selaxhaka*, shtëpia botuese Sar El'Marafetu, 2006.  
Nidham el Mulk el Tusi, *Sijeru El'Muluk*, shtëpia botuese Dar El'Menahel, botimi i parë, 2007.

# Medresetë osmane përgjatë historisë

Agon Krasniqi

Medresetë osmane ishin vazhdim i traditës islame ndërshekullore. Modeli i ngritjes së medresesë u mor nga medreseja Nizamiye, medrese e Nizamulmulk, vezir i shtetit të selxhukëve. Medreseja e parë osmane u ngrit nga Sulltan Orhani, në qytetin e Iznikut gjatë vitit 1331.

## HYRJE

Osmanët, shtetin e tyre e konceptuan mbi bazën e parimit islam. Ky parim dallohej në sfera të ndryshme, ndër to edhe në medrese. Ngritja e medreseve osmane ishte një vazhdimësi e tradicionales islame. Kjo tashmë vazhdonte edhe te shteti i ri osman, të cilët ngritën medresenë e parë në periudhën e Sulltan Orhanit, në qytetin e Iznikut rreth vitit 1331.<sup>1</sup> Në medresenë e Iznikut kemi shndërrimin e ndërtesës së kishës së Iznikut në medrese, ku si ligjërues u caktua Dauti nga Kayseri. Kështu parimi i ngritjes së shtetit tek osmanët, ndërli dhej edhe me aspektin e përbashkët kulturor-fetar, ku iu përmbajtën parimit që shtetit i nevojiten medresetë, që në të mblidhen dijetarët dhe krijojnë dijetarë të ardhshëm, që ishte shëmbëlltë e funksionalizimit të shtetit për një periudhë 600 vjeçare. Ngritja e medreseve osmane u shënuar përgjatë historisë shekullore osmane, ku u ngritën medrese në vendet ku sundonte shteti osman, por me një numër të madh në qytetet ku kishte demografi dhe zhvillim më të madh. Katër çështjet kryesore që kanë janë elementi kryesor i uniformitetit kulturor të shtetit osman. Nga këto katër çështje dallojmë: rritje e numrit të medreseve me zgjerimin e territoreve osmane në Anadoll dhe Ballkan, formimi i një tradite osmane në arsim, zhvillimi i jetës sociale dhe intelektuale dhe mekanizmi shtetëror që funksiononte gjithnjë më mirë.<sup>2</sup>

## HISTORIKU I MEDRESEVE OSMANE

Medresetë osmane ishin vazhdim i traditës islame ndërshekullore. Modeli i ngritjes së medresesë u mor nga medreseja Nizamiye, medrese e Nizamulmulk, vezir i shtetit të selxhukëve.<sup>3</sup> Medreseja e parë osmane u ngrit nga Sulltan Orhani, në qytetin e Iznikut gjatë vitit 1331. Sipas rivayeteve<sup>4</sup> osmane, medreseja e ndërtuar nga Orhani në Iznik ishte medreseja e parë osmane. Kjo medrese ishte baza kryesore e ngritjes së shtetit osman në fazën e klasicizmit të hershëm. Pas ngritjes së medresesë së parë, dijetarët e vendeve të ndryshme erdhën në qytetin e Iznikut dhe ligjëruan në medresenë e Iznikut. Shumë prej tyre ishin dijetarë që shërbyen më herët në tokat selxhuke dhe në rajonin e Iranit. Ndër ta dallojmë: Taceddin Kurdin, Alaeddin Evsedin dhe Davud Kajserin.<sup>5</sup> Po ashtu dijetarë të shumtë erdhën nga tokat e Sirisë, Egjiptit, Iranit, etj., si ligjërues në medresenë osmane. Rol të rëndësishëm në themelimin e medresesë së parë osmane kishte edhe vëllai i Orhanit, i quajtur Alaeddin Ali, i cili si veziri i parë i shtetit osman, ndërmori masat e shkollimit, si elementi bazë i formësimit dhe ngritjes së një shteti. Gjatë periudhës së Orhanit u ngritën dhjetë medrese, ndër to edhe në qytetin e Bursës e njohur si medreseja Orhan Gazi. Pas periudhës së Orhanit, edhe sulltanët e tjerë i kushtuan rëndësi të madhe hapjes së medreseve. Gjatë periudhës së vitit 1331-1451, u ndërtuan 84 medrese në shtetin





osman. Nga këto tetëdhjetë e katër medrese, pesëdhjetë e tre ishin në Anadoll, njëzetë e nëntë në Rumeli dhe dy në Jeruzalem.<sup>6</sup>

Sulltanët osman i kushtuan rëndësi të madhe hapjes së medreseve. Kjo dallohet edhe në periudhën e Mehmet Fatihut, i cili pasi filloi rindërtimin e Stambollit, tetë kisha i shndërroi në medrese. Po ashtu përreth xhamisë Fatih ndërtoi tetë medrese rreth saj, që njiheshin si medrese të mëdha dhe tetë medrese të vogla.<sup>7</sup> Kjo medrese përreth xhamisë Fatih, njihet me emrin Sahn-i Seman dhe ishte medreseja më prestigjioze në shtetin osman, gjerë në ndërtimin e kompleksit Sulejmaniye.<sup>8</sup> E njëjta vazhdoi edhe në periudhën e Bajezid Veliut apo Bajezidit të Dytë, i cili ndërtoi tri medrese të mëdha, si në Amasja, Edrene dhe Stamboll. Pas ndërtimit të kompleksit Sulejmaniye, u ndërtuan edhe katër medrese përreth saj: medrese-i evvel, sânî, sâlis dhe râbî. Përreth këtij kompleksi u ndërtua edhe nga një darüşifa<sup>9</sup> dhe dârülhadis<sup>10</sup>, çka shënoi kulminacion në zhvillimin e arsimit të shtetit osman.<sup>11</sup>

Edhe pas periudhës së klasicizmit të hershëm, medresetë kanë luajtur rol të veçantë në arsimim. Kështu osmanët i kushtuan një rëndësi të madhe shkollimit. Në periudhën e vitit 1914, medresetë e Stambollit u bashkuan nën emrin Dârül Hilafeti'l Aliyye Medresesi (Medreseja e

Gjatë periudhës së vitit 1331-1451, u ndërtuan 84 medrese në shtetin osman. Nga këto tetëdhjetë e katër medrese, pesëdhjetë e tre ishin në Anadoll, njëzetë e nëntë në Rumeli dhe dy në Jeruzalem.

tokës së Kalifatit të Madhërishëm). Në vitin 1916, medresetë u riorganizuan dhe u klasifikuan në këtë mënyrë: Hariç, Dâhil, Sahn, Sulejmaniye.<sup>12</sup>

Edhe në Ballkan filloi ndërtimi i medreseve, ku si medreseja e parë llogaritet në periudhën e Bajezid Yildirimit (Rrufesë), në qytetin e Dimetokës. Megjithatë si medrese e hershme osmane në Ballkan, llogaritet edhe ajo e Isa Beut, Medreseja Meddah (themeluar nga Yigit Pasha dhe e emëruar me emrin Meddah, për nder të shehut të tij Medah Babai). Në përgjithësi në territorin e Ballkanit u ndërtuan 575 medrese dhe 1843 mektebe. Prej tyre në Shqipërinë e territorit të sotëm, në kohën e shtetit osman, janë ndërtuar tetë medrese dhe 121 mektebe.<sup>13</sup>

Medresetë do të mbylleshin me ligj nga qeveria e Republikës së Turqisë, nën udhëheqjen e Mustafa Kemal Atatürkut, konkretisht me ligjin Tevhid-i Tedrisat, më 3 mars të vitit 1924. Me ligjin Tevhid-i Tedrisat, filloi edhe lufta ndaj vlerave osmane dhe islame.<sup>14</sup>

## MËSIMI NË MEDRESETË OSMANE

Mësimi në medresetë osmane, ishte vazhdim i klasicës së mëparshme të shteteve islame. Nxënësi i cili shkollohej në medrese, ishte i angazhuar që të mësonte lëndët si: sarf (morfologjia), nahiv (sintaksa), mantik (logjika), tefsir (komentimi i Kuranit), adab-i bahs (elokucion), vaaz (predikim), belegat (retorikë), kelam (teologjia filozofike), hikmet (filozofinë), fikh (jurispudencën islame), feraiz (trashëgiminë fetare), akaid (parimet e besimit), usul-i fikh (metodologjia për studim të jurisprudencës islame).<sup>15</sup> Nga periudha e Mehmet Fatihut, në kuadër të lëndëve përfshihen edhe: matematika, astronomia dhe mjekësia.

Në kuadër të orëve mësimore, mësimi zhvillohej në dy periudha: pas namazit të sabahut dhe pas namazit të ikindisë.<sup>16</sup> Shpenzimet e shkollimit në medrese, qëndrimi dhe ushqimi, si dhe bursat ditore, ishin të mbuluara nga shteti osman.<sup>17</sup> Pushimi ishte dy herë në javë, ditën e martë dhe ditën e premte. Po ashtu gjatë muajit Ramazan, nxënësit e medresesë e kishin pushim dhe ishin të përkushtuar në agjërim. Po ashtu edhe gjatë

festave të Bajramit, nxënësit që mësonin në medresetë osmane, e kishin pushim atë ditë.<sup>18</sup>

Koncepti i ndarjes së mësimin mbi parimin e dijes në medresetë osmane, dallohet me dijetarin Taşköprülûzâde Ahmedit. Sipas tij dhe mësimëve që ai aplikonte në medrese, dija ka katër stadi: shpirtërore, intelektuale, gojore dhe të shkruar. Në përgjithësi shkencat klasifikohen në shtatë kategori: Shkencat kaligrafike (instrumentet e të shkruarit, stilet e të shkruarit), shkencat gojore (gjuha arabe dhe fonetika, leksikografia, gramatika, etimologjia dhe sintaksa, retorika prozodia, poezia, kompozicioni, historia, shkenca të tjera letrare. Shkencat intelektuale (logjika dhe dialektika), shkencat shpirtërore (ndahen në tri kategori - shkencat teorike racionale: teologjia e përgjithshme, matematika, shkencat praktike racionale: etika, shkencat politike dhe shkencat teorike fetare: Kurani dhe Suneti, si dhe shkencat praktike fetare: etika praktike, rregullat e mirësjelljes, ihtisabi, adhurimi.<sup>19</sup>

Koncepti i shkencës në medresetë osmane ndahet në dy grupe: shkenca e mirë dhe shkenca e keqe. Shkenca që i ndihmon fesë, cilësohet si shkencë e mirë, ndërsa shkenca e cila i bën dëm fesë, cilësohet si shkencë e keqe (shembull tek osmanët, astrologjia cilësohet si shkencë e keqe).<sup>20</sup>

Mësuesi në medresetë osmane njihet si myderriz. Nxënësi i cili mëson në medrese i duhet t'i nënshtrohet një studimi të thellë në shkencat fetare. Ai duhet të mësonte gjuhën arabe, që cilësohet si gjuha e shkencës. Çdo medrese osmane kishte nëntëmbëdhjetë dhoma dhe një klasë. Nxënësit e shkëlqyer ndryshe njiheshin si dânişmend (danishmend), që merrnin

**Medresetë osmane ndaheshin në tri kategori: medresetë hariç apo të jashtme, medresetë dâhil apo të brendshme dhe medresetë sahn.**

nga dy akçe në ditë. Ndërsa nxënësit e tjerë ndryshe quheshin edhe si softa.<sup>21</sup> Çdo medrese kishte dy biblioteka; biblioteka e përgjithshme dhe biblioteka e dhuruar si vakëf.

Pagat e mësuesve në medrese klasifikoheshin në bazë të medreseve. Në medresetë Haşîye-i Tecrid, mësuesit merrnin 20-25 akçe në ditë. Në medresetë Miftah, mësuesit merrnin 30 akçe. Në medresetë Telvih, mësuesit merrnin 40 akçe. Në medresetë Hariç, Dahil, Tetimme, Musila-i Sahn (niveli përgatitor për të kaluar në medresetë Sahn), mësuesit merrnin 50 akçe. Kryemësuesit e katër medreseve merrnin 60 akçe ditore, mësuesit e Dârülhadisit merrnin 50 akçe ditore.<sup>22</sup>

### **KATEGORITË E MEDRESEVE OSMANE**

Medresetë osmane ndaheshin në tri kategori: medresetë hariç apo të jashtme, medresetë dâhil apo të brendshme dhe medresetë sahn.<sup>23</sup>

Medresetë Hâriç ndaheshin në tri grupe: medresetë ibtidâ-yi hâriç<sup>24</sup>, medresetë Miftâh, medresetë e dyzetëshes dhe pesëdhjetëshes.

Te grupi i parë i medresesë Hâriç, i njohur si medrese ibtidâ-yi hâriç, apo medresetë e ulëta, ndryshe njihen me emrin medreseja Tajrid apo medrese të njëzetëshes. Këtu merreshin me njohuritë fillestare të gramatikës dhe sintaksës së gjuhës arabe, logjikës, teologjisë skolastike, astronomisë, gjeometrisë dhe retorikës.<sup>25</sup>

Medresetë Miftâh apo medresetë e tridhjetëshes, kemi mësimin për retorikën dhe shkencat letrare.





Medresetë e dyzetëshes dhe pesëdhjetëshes, ishin ngritur kryesisht nga burokracia dhe dinastia osmane në qendër, për dallim që medresetë Tajrid dhe Miftâh ishin të ngritura më shumë në provinca. Kryesisht mësimi mbështetej në teologjinë skolastike si dhe mësimi për medhhebin hanefi, kryesisht i mbështetur në mësimet e Al Marghinanit.<sup>26</sup>

Kategoria e dytë e medresesë osmane përbëhet nga Medresetë Dâhil. Këto ndaheshin në tri grupe: medresetë Ibtidâ-yi dahil, medresetë Tetimme dhe medresetë Semâniye. Në grupin e parë të medreseve Dâhil, kemi medresetë ibtidâ-yi dâhil apo medresetë e pesëdhjetëshes. Këto medrese u themeluan nga dinastia dhe burokracia osmane. Për nivelin fillestar mësohej vepra Hidâya, pastaj jurisprudenca islame përmes veprës Talwih, vepër e Al Taftazanit, si dhe tefsir i Kuranit përmes veprës Kashshâf të El Zamahshariut. Në grupin e dytë bënin pjesë medresetë Tetimme, ose ndryshe mûsile-yi sahn, të themeluara nga Mehmet Fatihu. Niveli më i lartë i medreseve ishte ai i medreseve Semaniye të grupit të tretë të medreseve Dâhil. Mësimi në medresetë Semaniye i përkushtohej tri lëndëve: jurisprudencë islame, teologji skolastike, retorikë.<sup>27</sup>

1 Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike 1300-1600*, (Tiranë: Dituria, 2013), f. 219.

2 Halil Inalxhik dhe Gynsel Renda. *Qytetërimi Osman I*, (Tiranë: Alsar, 2016), f. 352.

3 Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, (Tiranë: Dituria, 2004), f. 608.

4 Rivajetet osmane janë transmetime gojore të ngjarjeve apo ndodhive të ndryshme, të cilat më pas janë shkruar në libra, konkretisht në kronika.

5 Davud Kayseri – ishte mësuesi i parë në medresenë e Sulltan Orhanit, në qytetin e Iznikut. Shih: Abdulhamit Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 28, Ankara: Diyanet Yayain Vakiflari, 2003, f.327.

6 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f.328

7 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f.328

8 Fahri Unan “*Sahn-i Seman*”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 35, Ankara: Diyanet Yayain Vakiflari, 2008, f.532.

9 Darüşifa: Vendi ku mësohet mjekësia.

10 Dârülhadis: Vendi ku mësohet hadithi. Shih: Nebi Bozkurt, “*Dârülhadis*” Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 9, Ankara: Diyanet Yayain Vakiflari, 1993, f.533.

11 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f.328

12 Inalxhik dhe Renda. *Qytetërimi Osman I*, f. 359.

13 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f.328

14 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f. 332.

\* Pas largimit të kalifatit osman, filloi edhe zbatimi i politikës së re në Turqi, nën qeverisjen e Mustafa Kemal Atatürkut, për t’u luftuar vlerat osmane, të cilat ishin kultivuar me shekuj. Ndër to dallojmë largimin e fesit (simbol i kapelës osmane, me ngjyrë të kuqe), ndryshimi i alfabetit, që shkaktoi alfabetizmin në vend, dëbimi i familjes perandorake, shndërrimi në muze i xhamisë Hagia Sophia (Aja Sofia). Në anën tjetër në aspektin fetar: mbyllja e medreseve, arrestimi i hoxhallarëve, ndalimi i ezanit në gjuhën arabe, ndalimi i shamisë.

15 Ekmeleddin Ihsanoglu, *The Madrasas of the Ottoman Empire*, (United Kingdom: Foundation for Science Technology and Civilisation, 2004), f. 2.

16 Birişik “*Medrese Osmanli Donemi*”, f. 331.

17 Hüseyin Demir, “*Osmanlı İlk Dönemi Medreselerinin Kuruluş Süreci ve Arap Dilinin Öğretimi*”, Eğitim Fakültesi Dergisi, Bartın: Bartın Üniversitesi, 2017, f.617.

18 Ekrem Bugra Ekinci, “*Osmanli Medreseleri*” Fikriyat Gazetesi, 2017. <https://www.fikriyat.com/tarih/2017/12/18/osmanli-medreseleri>.

19 Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike*, f. 217-218.

20 Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike*, f. 218.

21 Softa: pasion për dijen. Ishte term i cili i dhurohej nxënësve në medresetë osmane. Si terminologji rrjedh nga persishtja, ku shkruhej si sũhte, por me kalimin e kohës mori trajtën Softa në turqishten e vjetër. Softa është ekuivalente me termin taleb. Shih: Mustafa Alkan “*Softa*”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 37, Ankara: Diyanet Yayain Vakiflari, 2009, f.342.

22 Inalxhik dhe Renda. *Qytetërimi Osman I*, f. 356-357.

23 Inalxhik dhe Renda. *Qytetërimi Osman I*, f. 356.

24 Ibtidâ – fillore. Shkollim fillor i klasifikuar në medresetë osmane. Në konceptin Islam, ibtidâ njihet personi i cili fillon të mësojë shkronjat e Kuranit.

25 Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike*, f. 221.

26 Al-Marghinanit: dijetar islam dhe njohës i ligjit hanefi. Vepra e tij më e njohur e jurisprudencës islame është Al Hidaya.

27 Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike*, f. 222.

# Amalekitët - armiqtë e përjetshëm të izraelitëve<sup>1</sup>

Prof. dr. Nuh Arslantaş

“Mos harro çfarë të bëri amaleku rrugës, kur dole nga Egjipti, si të sulmoi e si u ra atyre që mbetën mbrapa, kur ishe i lodhur e i drobitur. Ai nuk e pati frikë Perëndinë. Prandaj, kur Zoti, Perëndia yt, të të japë prehje nga armiqtë përreth, në tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep për ta zotëruar si trashëgimi, mos harro ta shuash emrin e amalekut nën qiell.” (Ligji i Përtërirë, 25:17-19).<sup>2</sup>

“Tani pra, sulmoje amalekun e shfaros gjithçka që gjendet në të. Mos ki mëshirë! Vriti me burra, gra, fëmijë, foshnja, qe, dhen, deve e gomarë!” (Libri i parë i Samuelit, 15:3).<sup>3</sup>

## AMALEKITËT - FISI ARAB ‘AMĀLĪQ

Izraelitët u ballafaquan për herë të parë me fisin arab të amalekitëve kur kaluan Detin e Kuq gjatë daljes nga Egjipti (Tora, Ligji i Përtërirë 25:17-18). Sipas burimeve arabe paraislame, ky fis shtrihet në një zonë të gjerë

gjeografike nga Jemeni në jug, deri në kufijtë e Sirisë dhe Irakut në veri, dhe nga Gjiri Persik në lindje, deri në Mesdhe në perëndim.

Sipas traditës, amalekitët sulmuan izraelitët më 20 prill 1312 para erës sonë (23 Ijar 2448 sipas kalendarit çifut) derisa këta ishin në Refidim, rreth 32 km në juglindje të qytetit egjiptian të Arishës. Izraelitët i mbijetuan sulmit dhe më vonë i mundën pjesërisht amalekitët me ushtrinë nën komandën e Jozoehut, por nuk arritën t'i eliminonin plotësisht (Dalja 17:8-16).<sup>4</sup>

Edhe pse izraelitët fituan luftën, amalekitët krijuan frikë dhe trauma që nuk u harruan kurrë. Për këtë arsye, Zoti i Izraelit, donte që amalekitët, i vetmi popull midis popujve të tjerë që guxuan të sulmonin izraelitët, të mbaheshin mend gjatë shekujve si “shembull për botën”, dhe për këtë arsye urdhëroi që kjo luftë të regjistrohej (Dalja: 17:14). Fitorja që fitoi Joshua është e shënuar në “Librin e



Sipas Tevratit, amalekitët duhet të eliminohen në rastin e parë për shkak të traumës që u shkaktuan çifutëve: burra dhe gra, fëmijë dhe foshnja në gji, bagëti dhe dele, deve dhe gomarë - gjithçka që ata kanë duhet të shkatërrohet

luftërave të Zotit/Sefer Milhamot ha-Shem” (ka mendime se libri në fjalë është pjesë e Tevratit ose, përndryshe, se ka pjesë të pjesëve të tjera që përmendin këtë ngjarje).

### “MBAJE MEND DHE MOS HARRO KURRË!”

Edhe pse çifutët u dukën të fortë dhe të pathyeshëm gjatë daljes nga Egjipti, amalekitët i sulmuan ata. Sado që ka mbetur e regjistruar se çifutët e fituan këtë luftë, amalekitët e thyen besimin e tyre në fuqinë e tyre.<sup>5</sup>

Sipas Tevratit, amalekitët duhet të eliminohen në rastin e parë për shkak të traumës që u shkaktuan çifutëve: burra dhe gra, fëmijë dhe foshnja në gji, bagëti dhe dele, deve dhe gomarë - gjithçka që ata kanë duhet të shkatërrohet (Dalja 17:14 -16; Libri i Samuelit 15:3).

Në traditën çifute, hakmarrja ndaj amalekitëve konsiderohet si hakmarrje e Zotit, duke adhuruar kështu Zotin. Detyra më e rëndësishme dhe kryesore fetare (mitzvah) që izraelitët duhet të përmbushin si komb kur të hyjnë në Palestinë është “të fshijnë dhe zhdukin plotësisht kujtimin e amalekitëve nën kupolën e qiellit.” As kafshët e tyre nuk do të mbeten të gjallë, që të mos thuhet: “Këto janë kafshët e amalekut.” (Dalja 17:14; Ligji i Përtërirë 25:19).<sup>6</sup>

Eliminimi i amalekitëve konsiderohej një detyrim me prioritet më të lartë se ndërtimi i Tempullit (Talmudi babilonas, Sanhedrin: 20). Dihet në traditë se mbreti i parë çifut, Sauli, mori si plaçkë gjithçka që ishte e dobishme pasi mundi amalekitët. Për shkak të kësaj, humbi mbështetjen i dërguari Samuel dhe si ndëshkim u vra bashkë me djemtë e tij. (Libri i parë i Samuelit, 15:9; 28:19<sup>7</sup>).

Çrrënjosja e plotë e amalekitëve, madje edhe përmendja e tyre, mund të ndodhë vetëm pasi izraelitët të vendosen plotësisht në territorin palestinez. Në traditën çifute, lufta kundër amalekitëve është konsideruar si detyrë fetare për breza të tërë (Dalja 17:16), dhe një nga 10 pikat e rëndësishme (‘eser zehirot) që një çifut duhet të kujtojë dhe përmendë gjithmonë gjatë gjithë jetës së tij, është sulmi i amalekitëve kundër izraelitëve.

Në komentet e Tevratit ka edhe një koment interesant për luftën izraelite kundër amalekitëve si konstante. Në librin e Daljes (17:16), Zoti vendos dorën e tij mbi fron dhe betohet se lufta me amalekitët do të vazhdojë për gjenerata:

Dhe tha: “Meqë u ngritën duart drejt frontit të Zotit, ai do të luftojë kundër amalekut brez pas brezi.” (Dalja; 17:16).

Amalekitët, të njohur në mesin e arabëve si ‘amāliqa, e kanë prejardhjen nga arabët, prejardhja e të cilëve nuk ka mbijetuar deri më sot.

Në hebraisht, fjala “fron” zakonisht shkruhet si “kise” (כִּסֵּי). Megjithatë, siç shihet në pasazh, kjo shprehje erdhi në formën “al kes Yah” (אֶל-כֶּסֶף-יָהוּ) - domethënë, fjalët “fron” dhe “Zot” ishin shkruar me shkronja që mungonin. Në komentet e Tevratit, kjo situatë interpretohet në atë mënyrë që as Zoti dhe as froni i Tij nuk mund të jenë të plotë përderisa ka njerëz të këqij - amalekitët arabë.

Kjo është arsyeja pse, sipas traditës, lufta kundër amalekitëve pranohet si një detyrë që u është ngarkuar hebrenjve për breza të tërë, me qëllim, eliminimin e plotë të këtij populli. Amalik, paraardhësi i fisit arab të amalekitëve, denigrohet plotësisht në tregimet midrashike si armiku i vdekshëm i çifutëve. Sipas tregimit, paraardhësi i Amalekut, Elifazi, kishte një lidhje jashtëmartesore me gruan e Se'irit nga e cila lindi Timna. Edhe më e tmerrshme se kaq - nga marrëdhënia që Elifazi kishte me vajzën e tij, Timna, do të lindë Amaleku.

### ORIGJINA E AMALEKITËVE

Amalekitët, të njohur në mesin e arabëve si ‘amāliqa, e kanë prejardhjen nga arabët, prejardhja e të cilëve nuk ka mbijetuar deri më sot. Në burimet islame, ata e gjurmojnë origjinën e tyre tek një person i quajtur ‘Imlik i biri i Lüzovit (ose Lāvizit), i biri i Iremi, i biri i Samit.

Tevrati nuk e përmend origjinën e Amalekut dhe as që flitet për të në Kuran. Shumica e të dhënave rreth tij vijnë nga pretendimet me origjinë çifute, të cilat në burimet islame quhen israilijate. Burimet islame përmendin djalin e Amalekut të quajtur Xhāsim dhe tetë nipërit e tij. Pasardhësit e tyre ishin fiset Benu Matar dhe Benu Ezrak në Hixhaz, Benu Tigār, Benu Budajl dhe Benu Rāhil në Nexhid, Benu Leffa në Jethrib dhe Benu Erkam në zonën midis Hixhazit dhe Tejmës.

Sipas traditës çifute, atdheu i amalekitëve, kombi më i vjetër në botë, është një tokë e quajtur Edom, e vendosur midis Gjirit të Akabës dhe Detit të Vdekur (Zanafilla 36:16). Libra të tjerë të Dhiatës së Vjetër shënojnë se amalekitët jetuan në të gjithë Arabinë Veriore, duke përfshirë Gadishullin e Sinaut dhe Nexhdi, deri te shkretëtira Nexhef në perëndim të Detit të Vdekur deri në Egjipt.

Në traditën myslimane, hapësira jetësore e amalekitëve është shumë më e madhe. Në shkrimet arabe përmendet se ky popull është populli burimor arab (Arebi ‘Āribe), dhe se ata fillimisht kanë jetuar rreth Babilonisë. Pas shkatërrimit të kullës së Babilonisë, ata shpërngulën në Hixhaz dhe prej andej u zhvendosën në Nexhid, Tejma, Oman, Bahrein,



Mesopotaminë Veriore, Siri, Palestinë, Egjipt dhe Tunizinë e sotme.

Të dhënat e para të së kaluarës amalekite në Tevrat datojnë nga çereku i parë i mijëvjeçarit të dytë para erës sonë. Fillon me periudhën e Ibrahimit a.s., dhe vazhdon gjatë periudhës pas daljes nga skllavëria egjiptiane.

### AMALEKITËT SOT - PALESTINEZËT NË VEÇANTI, ARABËT NË PËRGJITHËSI

Sipas traditës çifute, amalekitët përfaqësojnë formën më të keqe të së keqes. Fati i Amalekut, i pari i popullit, do të jetë shkatërrim i përjetshëm. Lufta midis izraelitëve dhe amalekitëve konsiderohet “një simbol i luftës së pafund midis së mirës dhe së keqes”. Pikërisht kështu e përshkroi Netanjahu konfliktin mes Izraelit dhe Hamasit, duke folur në seancën hapëse të Knesset-it (parlamenti izraelit), më 16 tetor 2023. Ky narrativ bazohet në vetë sfondin historik për të cilin po flasim.<sup>8</sup>

Bazuar në këtë memorie historike, çifutët e ekstremit të djathtë dhe fetarë në Izrael, sot e shohin persekutimin ose eliminimin e arabëve nga Izraeli si një urdhër të Tevratit. Për të, palestinezët, ashtu si amalekitët, janë një popull arab.<sup>9</sup>

Identifikimi i palestinezëve ose arabëve si amalekitë nuk është unik për politikanët siç është Netanjahu. Fitorja në luftën gjashtë ditore në vitin 1967 dhe pushtimi i Jerusalemit dhe luftërat e mëpasshme me arabët u dhanë çifutëve fetarë shpresë të madhe. Netanjahu iu referua edhe këtyre luftërave në konferencën për shtyp (28 tetor 2023). Si rezultat i një lufte pas tjetres kundër arabëve, Izraeli fitoi pjesën më të madhe të tokës së premtuar të përmendur në Tevrat. U bë përparim i shpejtë drejt arritjes së shpëtimit hyjnor dhe krijimit të

Izraelit, shteti fetar i premtuar në Bibël. Megjithatë, pengesa më e madhe për të dominuar gjithë Tokën e premtuar në një proces të tillë ishin arabët palestinezë në Gaza dhe Bregun Perëndimor.

Lëvizjet fundamentaliste çifute si Gush Emunim synojnë gjithashtu amalekun, armikun e përjetshëm të judaizmit, në luftën e tyre. Këto dhe lëvizje të ngjashme fetare besojnë se kushdo që paraqet kërcënim për çifutët, veçanërisht palestinezët, duhet të eliminohet. Udhëheqësit e lëvizjeve të tilla i përshkruajnë arabët dhe palestinezët si amalekitët për të cilët Tevrat ka urdhëruar shkatërrimin dhe ata shpallin një luftë brutale kundër të gjithë arabëve që refuzojnë sundimin çifut.<sup>10</sup>

Ka udhëheqës të tjerë fetarë që besojnë se amalekitët përfaqësojnë një armik të paepur, qëllimi i vetëm i të cilit është shkatërrimi i çifutëve. Prandaj, ata pretendojnë se dhuna preventive kundër armikut është krejtësisht normale dhe e pëlqyeshme. Rabini Israel Hess pohon fare hapur se amalekitët historikë janë në të vërtetë palestinezët e sotëm.

Haim Tsuria, një mbrojtës i vendosur i lëvizjes Gush Emunim, përpiqet të justifikojë dhunën kundër arabëve duke thënë: “Në çdo gjeneratë ka një amalek. Në gjeneratën tonë, amalekët janë arabët që kundërshtojnë rivendosjen e ekzistencës sonë kombëtare në tokat e të parëve tanë”.<sup>11</sup>

Lufta e politikanëve të çmendur izraelitë dhe klerikëve radikalë kundër amalekitëve është e kufizuar vetëm te palestinezët apo vlen për të gjithë arabët në Gadishullin Arabik? Këtë do ta tregojë historia.

*Përktheu nga gjuha boshnjake:*

*Dr. Azmir Jusufi*

- 1 Publikuar më: Independent Türkçe, 29.10.2023. Përktheu nga turqishtja: Emina Çeman-Kiremitci. Publikuar në faqen e internetit: Islam.ba | Amaleçani - vječni neprijatelj Izraela.
- 2 <https://www.bibliatodo.com/sq/bibla/bibla-shqip-se-bashku-2020-me-dk/ligji-i-perterire-25>.
- 3 <https://www.bibliatodo.com/sq/bibla/bibla-shqip-se-bashku-2020-me-dk/1samuelit-15>.
- 4 Shih në: <https://www.bibliatodo.com/sq/bibla/bibla-shqip-se-bashku-2020-me-dk/dalja-17>.
- 5 [https://www.chabad.org/library/article\\_cdo/aid/3942715/jewish/Who-Were-Amalek-and-the-Amalekites.htm#footnoteRef8a3942715](https://www.chabad.org/library/article_cdo/aid/3942715/jewish/Who-Were-Amalek-and-the-Amalekites.htm#footnoteRef8a3942715) [Data e qasjes: 28.10.2023].
- 6 Shih: Tora ve Aftara (Torah dhe Haftara), Vëllimi 2, Gözlem Yayınları, Stamboll 2004, f. 191.
- 7 “Zoti do të dorëzojë edhe Izraelin në duart e filistinëve bashkë me ty. Nesër ti e bijtë tu do të vini këtu ku jam unë, se Zoti do t’ua dorëzojë filistinëve fushimin e Izraelit” (Libri i parë i Samuelit, 28:19).
- 8 <https://www.cumhuriyet.com.tr/dunya/netanyahudan-irana-ve-hizbullah-uyari-bizi-denemeyin-buyuk-zarar-2130846> [Data e qasjes: 28.10.2023].
- 9 Shih: SE Karesh-MM Hurvitz, “Amalek”, *Encyclopedia of Judaism*, ed. J. Gordon Melton, Nju Jork 2006, f. 12.
- 10 Baki Adam: “Yahudilik ve Şiddet”, *İslâmîyât Dergisi*, 1 (2002), f. 32.
- 11 [https://en.wikipedia.org/wiki/Judaism\\_and\\_warfare#cite\\_ref-50](https://en.wikipedia.org/wiki/Judaism_and_warfare#cite_ref-50) [Data e qasjes: 28.10.2023].

# 80 vjet nga vdekja e hafëz Abdullah ef. Telakut (1896-1943)

Faik Miftari

Me rastin e 80-vjetorit të vdekjes së hafëz Abdullah ef. Telakut, vendosa që me këtë shkrim ta përkujtojë këtë personalitet të shquar fetar e kombëtar në kuptimin e plotë të fjalës, të njohur jo vetëm në qytetin e Prizrenit, por edhe gjithandej Kosovës, Bosnjës e Shqipërisë. Ai lindi në Prizren në vitin 1896. Ishte djali i Hëzërit, i biri i Sylejman agë Telakut të shquar, e i cili njihej gjithashtu edhe sipas emrit të babait të tij, hafëz Hëzër Telakut. Pas përfundimit të iptidajes (shkollës fillore) vazhdoi ruzhdijen (gjimnazin), por për fat të keq, nuk arriti ta përfundojë, sepse pas largimit të Perandorisë Osmane në vitin 1912, kjo shkollë që mbyllur nga ana e pushtetit serb sikurse të gjitha shkollat e tjera ekzistuese në Perandorinë Osmane.

Pas disa viteve, u regjistrua në medresenë e Gazi Mehmed Pashës në Prizren, me ç'rast ndoqi mësimet te myderrizët (profesorët) e shquar të kohës, sikurse që ishin hafëz Abdylaziz efendi dhe hafëz Rrystem ef. Shporta. Krahas mësimet në medrese, hafëz Abdullah ef. Telaku ka mësuar edhe Kuranin famëlartë përmendsh, ashtu që mori edhe titullin e nderuar hafëz i Kuranit. Mësimet në medrese i përfundoi në vitin 1928 dhe mori i xhazetnamenë (diplomën) te myderrizi i shquar i kohës së tij, hafëz Nysret ef. Agallari. Përveç gjuhës shqipe, turke, serbe, e njihte edhe gjuhën arabe, si dhe gjuhën frënge. Derisa akoma ishte nxënës në medrese, u emërua imam në vitin 1925 në xhaminë e Arastës (Jakub bej Evrenoszades), detyrë të

Në vitin 1935, pas emërimit në pozitën e myftiut të Prizrenit, të myderrizit të tij, hafëz Nysret ef. Agallarit, hafëz Abdullah ef. Telaku u emërua në pozitën e myderrizit të medresesë së Gazi Mehmed Pashës, të cilën detyrë do të kryente me shumë përkushtim deri në fund të jetës së tij në vitin 1943.



cilin e kreu deri në vitin 1930, kur u emërua ndihmës i myderrizit të tij në medresenë e Gazi Mehmed Pashës në Prizren.

Në vitin 1935, pas emërimit në pozitën e myftiut të Prizrenit, të myderrizit të tij, hafëz Nysret ef. Agallarit, hafëz Abdullah ef. Telaku u emërua në pozitën e myderrizit të medresesë së Gazi Mehmed Pashës, të cilën detyrë do të kryente me shumë përkushtim deri në fund të jetës së tij në vitin 1943.

Në pikëpamje politike, hafëz Abdullah ef. Telaku ka ndjekur vijën politike të Ferhat bej Dragën dhe organizatës së atëhershme politike "Xhemijeti", e cila ishte një organizatë

Në vitin 1935, pas emërimit në pozitën e myftiut të Prizrenit, të myderrizit të tij, hafëz Nysret ef. Agallarit, hafëz Abdullah ef. Telaku u emërua në pozitën e myderrizit të medresesë së Gazi Mehmed Pashës, të cilën detyrë do të kryente me shumë përkushtim deri në fund të jetës së tij në vitin 1943.

politike, si mundësi e vetme të organizimit politik shqiptar legal jashtë partive politike serbe, rreth së cilës ishte tubuar inteligjenca shqiptare myslimane.

Në këtë aspekt, bashkëpunëtori i tij i parë ishte intelektual dhe veprimtari i njohur politik, juristi dhe sekretar i përgjithshëm i Rijasetit të Bashkësisë Islame në Sarajevë në atë kohë, e më vonë edhe anëtar i Organizatës Nacional-Demokratike Shqiptare në Kosovë, Ibrahim ef. Lutfiu.

Hafëz Abdullah ef. Telaku, me rastin e ceremonisë së inaugurimit të Fehim ef. Spahos në pozitën e Reis ul-ulemasë në vitin 1938, ishte caktuar që të lexojë tekstin e “Menshuras” (betimit) në gjuhën arabe, kurse në vitin 1939, derisa ishte i sëmurë reisi i atëhershëm Fehim ef. Spaho, për një kohë të shkurtër e ka zëvendësuar në pozitën e udhëheqësit të besimtarëve mysliman në ish-Jugosllavinë e atëhershme.

Gjatë kohës së Shqipërisë në Kosovë (1941-1944) hafëzi, myderrizi, alimi, atdhetari Abdullah ef. Telaku, në Kongresin Mysliman, të mbajtur në Prizren në nëntor të vitit 1941, ku morën pjesë 51 imamë, kryesoi Kongresin dhe u zgjodh anëtar i Këshillit të Naltë të Sheriatit me qendër në Prizren.

Hafëz Abdullah ef. Telaku ka qenë i martuar me zonjën Radije Ahmeti, me të cilin kishin katër djem e dy vajza, Abdylhadiu, Abdylmexhidi, Muhameti dhe Ahmeti, vajza, Fethija, ishte e martuar me djalin e hafëz Abdylaziz efendisë, Azizin, kurse vajza e dytë ishte Shemsija.

Hafëz Abdullahu kishte një bibliotekë shumë të pasur me libra dhe dorëshkrime të rralla. Pas vdekjes së tij, zonja Radije duke përmbushur amanetin e bashkëshortit të saj, i ka dhuruar të gjitha librat kutubhanes (bibliotekës) së medresesë së Gazi Mehmed Pashës në Prizren. Vlen të theksohet se një pjesë të kësaj biblioteke, fatmirësisht, ruhet edhe sot e kësaj dite në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë. Përveç të tjerash është e njohur se hafëz Abdullah ef. Telaku, me rastin e vdekjes së myderrizit të tij hafëz Rrystem ef. Shporta, e ka shkruar edhe nekrologun për nder të tij.

Hafëz Abdullah ef. Telaku ndërroi jetë pas një sëmundje të shkurtër, prej tuberkulozës, në vitin 1943 në Prizren në moshë mjaft të re, 47 vjeçare dhe është varrosur me nderime të larta fetare e qytetare në varrezat Kuriçeshme të Prizrenit. Miku i tij nga Sarajeva, myderrizi Fejzullah ef. Haxhibajriq, me të cilin mbante korrespondencë të rregullt, me rastin e vdekjes së tij ka shkruar përveç tjerash: “Ka qenë alim me dije të thellë dhe një njeri shumë i devotshëm, e këndonte shumë bukur Kuranin dhe nuk doje gjë tjetër veçse ta dëgjoje hafëz Abdullahun duke lexuar Kuranin. Ka qenë një kaligraf jashtëzakonisht i shkathtë. Ishte jashtëzakonisht xhymert, bujar dhe mikpritës. Ai nuk jetonte nga të tjerët, por jetonte për të tjerët. Si tregtar ishte shumë solidar, sikurse në çdo aspekt tjetër u përmbahej rregullave të Sheriatit edhe në tregti. Kushdo që kishte vizituar Prizrenin, detyrimisht do të kishte qenë mysafir në konakun e tij.”

Lidhur me mikpritjen dhe bujarinë e hafëz Abdullah ef. Telaku nuk mund e të mos e cek edhe këtë ngjarje shumë interesante që ka ndodhur. Me një rast, haxhi Rexhep efendiu, myderrizi me nam i medresesë së Opojës, e që ishte shok dhe mik i ngushtë i hafëz Abdullah ef. Telakut, u nisë me kalin e tij nga Bresana (Brodosana) për të shkuar në një fshat të afërt për të vizituar një mik të tij. Por, rrugës duke ecur, kali i tij e merr udhën teposhtë drejt Prizrenit, dhe haxhi Rexhep efendiu nuk ia prishi drejtimin kalit të tij, i cili nisi të ecën drejt Prizrenit, ndërroi mendjen aty për aty, dhe vendosi të shkoi të vizitojë kolegun dhe mikun e tij të nderuar hafëz Abdullah efendiun në Prizren. Në ndërkohë në Prizren, në ato çaste, hafëz Abdullah efendiu e porositi vëllain e vet Ismailin, të shkojë të blejë mish në mishtore, dhe t’ua jep grave të shtëpisë, të përgatisin sarma për darkë, se do të vijë në konak haxhi Rexhep efendiu nga Opoja. Pas një kohe mbërrini në konak të hafëz Abdullah efendiut, haxhi Rexhep efendiu. Sikurse të ishin marrë vesh me telefon, edhe pse në atë kohë nuk ka pasur telefon, por të dy këta alim, myderrizë, koleg dhe miq të ngushtë, janë kuptuar në distancë, pasi që të dy, me siguri, Allahu alem (Allahu e di!), kanë qenë evlija (të përafërtit) të Zotit.



## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSMINISTRIN E JASHTËM TË TURQISË, Z. YASIN EKREM SERIM



Më 28 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, z. Yasin Ekrem Serim.

Gjatë kësaj vizite në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, zv.ministri nga Turqia, u njoh nga Myftiu Tërnavë për aktivitetet fetare në Kosovë gjatë muajit Ramazan, me punën e Medresesë “Aluaddin”, Fakultetin e Studimeve Islame, Institutet e Hivzit, si dhe me aktivitetet e mësim-besimit.

Gjithashtu, Myftiu Tërnavë e njohu edhe me punimet në ndërtimin e

Xhamisë Qendrore në Prishtinë, si dhe me xhamitë që janë duke u restauruar në bashkëpunim me Dijanetin e Turqisë.

Në veçanti gjatë këtij takimi, të dy palët diskutuan për thellimin e bashkëpunimit dhe fushat në të cilat mund të shtojnë bashkëpunimin.

Myftiu Tërnavë kërkoj nga zv.ministri i Turqisë që të japë maksimumin në mbështetje të Kosovës në të gjitha sferat e jetës dhe në veçanti në ato politike.

Nga ana tjetër, zv.ministri i Jashtëm i Turqisë, Yasin Ekrem Serim, u shpreh i kënaqur që gjendet në Kosovë, ku

shfrytëzoi rastin që t'i uronte Myftiut Tërnavë për mandatin e ri në krye të Bashkësisë Islame.

Ai u shpreh i gatshëm që bashkëpunimin të thellojnë edhe më shumë mes Kosovës dhe Turqisë, teksa veçoi bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e humanizmit, restaurimit të xhamive, si dhe dërgimin e 11 imamëve për muajin Ramazan.

Gjatë qëndrimit të zv.ministrit të Jashtëm të Turqisë në Kosovë, ai vizitoi disa prej xhamive të restauruara rishtazi.

## KRYEMINISTRI KURTI DHE MYFTIU TËRNAVA VIZITUAN XHAMITË “PIRINAZ” DHE “ALAUDIN”



Më 10 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeministri i vendit, z. Albin Kurti dhe ministri i Kulturës, Hajrullah Çeku, vizituan xhaminë “Pirinaz”, e cila ditë më parë u rifunksionalizua për besimtarët e saj pas restaurimit.

Kryeministri Kurti tha se kjo xhami ka vlerë të lartë kulturore e historike dhe është një pikë e rëndësishme turistike.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryeministrin dhe ministrin Çeku për vizitën, si dhe për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në restaurimin e objekteve fetare. Pas xhamisë “Pirinaz”,

ata vizituan edhe xhaminë “Alaudin”, e cila po ashtu iu nënshtrua procesit të restaurimit dhe është në shërbim të besimtarëve.

Me këtë rast kryeministri Kurti uroi të gjithë besimtarët për muajin Ramazan, duke iu dëshiruar agjërime të lehtë.



### MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E OSBE-SË NË KOSOVË, Z. MICHAEL DAVENPORT



Më 12 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin z. Michael Davenport.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që ta njohë ambasadorin me zhvillimin e jetës fetare në vend, si dhe me aktivitetet që zhvillon Kryesia e

Bashkësisë Islame të Kosovës për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Myftiu Tërnavë çmoi dhe vlerësoi lart bashkëpunimin me OSBE-në përgjatë viteve në realizimin e shumë projekteve, e sidomos në fushën e dialogut ndërfetar në Kosovë.

Nga ana e tij, ambasadori Davenport, fillimisht falënderoi Myftiun Tërnavë

për pritjen dhe për kontributin e tij dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës për harmoninë, bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfetare në vend. Ai uroi Myftiun Tërnavë dhe gjithë besimtarët myslimanë për fillimin e muajit Ramazan, duke iu dëshiruar agjërime të lehtë.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E RI TË BRITANISË SË MADHE, Z. JONATHAN HARGREAVES



Më 25 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Jonathan Hargreaves.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e uroi atë për marrjen e detyrës në misionin e ri, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu atë me historikun, punët dhe angazhimet e institucionit të BI-së, duke potencuar

kështu rolin e BIK-ut në proceset e ndryshme që ka kaluar vendi ynë. Myftiu shfrytëzoi rastin që përmes ambasadorit të falënderojë shtetin e Britanisë së Madhe për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për shtetin e Kosovës në të gjitha sferat, qoftë në periudhat e mëhershme, por edhe tani për anëtarësimin në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë.

Nga ana e tij, ambasadori, z. Hargreaves, falënderoi Myftiun për pritjen dhe për angazhimin e tij dhe të insti-

tucionit që ai drejton që në Kosovë të ketë paqe dhe harmoni ndërmjet besimeve të ndryshme. Ai tha se Kosova gëzon vlerat e larta të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare, për të cilat është model për shumë vende të botës. Gjatë këtij takimi ambasadori shfrytëzoi rastin që të uronte Myftiun Tërnavë dhe gjithë besimtarët myslimanë për muajin Ramazan, duke u uruar agjërim të lehtë.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E RI TË SHQIPËRISË, Z. PETRIT MALAJ



Më 6 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kortezie ambasadorin e ri të Republikës së Shqipërisë, z. Petrit Malaj.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai shfrytëzoi rastin që të

uronte ambasadorin për marrjen e detyrës, duke i uruar kështu suksese dhe punë të mbarë. Myftiu më pas e njohu ambasadorin edhe me bashkëpunimin që kanë me bashkësitë fetare simotra, me të cilat tha se kemi

realizuar shumë projektet të përbashkëta me interes për besimtarët tanë.

Nga ana e tij, ambasadori z. Malaj, falënderoi Myftiun për pritjen, duke

thënë se ndihet tejte i gëzuar që sot ndodhet për vizitë në një institucion si Bashkësia Islame e Kosovës, duke çmuar kështu rolin dhe kontributin që kjo Bashkësi ka luajtur për

mbarëvajtjen e jetës fetare në vend, si dhe çmoi lart kontributin e saj për tolerancën dhe bashkëjetesën që mbretëron në Kosovë.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DELEGATIN APOSTOLIK TË SELISË SË SHENJTË PËR KOSOVËN, NUNCIN JEAN MARIE SPEICH



Më 30 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim delegatin Apostolik të Selisë së Shenjtë për Kosovën, nuncin Jean Marie Speich, i cili shoqërohej nga ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje nuncit në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e njohu atë me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë në kultivimin e bashkëjetesës dhe harmonisë

ndërfetare. Ai tha se si bashkësi fetare kemi një bashkëpunim të mirë me Kishën Katolike në Kosovë, dhe se ne jemi të gëzuar që vendi ynë ka një harmoni të tillë fetare, e cila është shembull për gjithë botën. “Ne jemi vëllezër të një kombi, andaj duhet ta ruajmë dhe ta duam njëri-tjetrin, ngase kështu na porosisin mësimet tona fetare islame” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Nga ana e tij, nunci Jean Marie Speich, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij

dhe të institucionit që ai drejton që të ketë bashkëpunim të mirë me të gjitha bashkësitë e tjera fetare në vend. Ai çmoi lart kontributin e Myftiut dhe të BIK-ut për harmoninë dhe bashkëjetesën fetare, e cila është prezente në Kosovë.

Në fund të takimit, të dyja palët bënë thirrje që në botë të pushojnë vatrat e konflikteve e luftërave dhe të mbretërojnë paqja dhe harmonia ndërmjet njerëzve pa dallim feje apo race.

## NË ZHEGËR TË GJILANIT U HAP XHAMIA E RE

Më 3 mars 2024, me këndimin e tekbireve dhe para një numri të madh të besimtarëve, në Zhegër të Gjilanit, u hap xhamia e re. Kjo xhami, me një arkitekturë dhe dizajn të mrekullueshëm, u prit me entuziazëm nga të gjithë banorët. Puna që kishte filluar më 2019, u konkretizua me hapjen e kësaj xhamie. Ceremonia e hapjes filloi me fjalën e Zotit, me leximin e disa ajeteve kuranore nga Xhelal ef. Kaloshi.

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim ef. Aliu, u shpreh i kënaqur me punën që është



bërë në ndërtimin e kësaj xhamie, për çka falënderoi besimtarët që kanë ndihmuar në ndërtimin e saj.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se hapja e kësaj xhamie në prag të muajit të bekuar Ramazan, e bën edhe më të bukur dhe unike. Ai uroi të gjithë banorët e fshatit për këtë xhami,

duke i falënderuar kështu për kontributin e tyre të vazhdueshëm që kanë dhënë për ndërtimin e kësaj xhamie. Ai tha se me hedhjen e gurthemelit të kësaj xhamie, ata që kanë kontribuar për të, kanë hedhur edhe gurthemelin e shtëpive të tyre në Xhenet.

Pjesë e ceremonisë hapëse të kësaj xhamie ishte edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, i cili tha se ndërtimi i kësaj xhamie është shembull tejet i mirë i asaj se çfarë mund të bëhet së bashku si shoqëri.

### MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM REISIN E BASHKËSISË ISLAME TË MALIT TË ZI, RIFAT EF. FEJZIÇ

Më 4 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim reisin e Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejziç, i cili shoqërohej nga zëvendësi i tij, Omer ef. Kajoshaj.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas i njohu ata edhe me aktivitetet dhe sfidat me të cilat përballet ky institucion.

Format dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërinstytucional ishin ndër temat kyçe, të cilat u diskutuan gjatë këtij takimi. Myftiu Tërnavë u shpreh i gatshëm që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani ndërmjet dy institucioneve, të vazhdohet dhe të intensifikohet edhe më tej, duke pasur parasysh se në Mal të Zi, jetojnë edhe një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve, që i përkasin besimit islam.



Nga ana e tij, reisi Fejziç, fillimisht uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit të BIK-ut, duke shprehur kështu konsideratën dhe falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur si institucion me Bashkësinë Islame të Malit të Zi.

Në fund të takimit, të dy myftitë shfrytëzuan rastin që të urojnë njëri-tjetrin për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan, duke lutur Zotin e Madhëruar që të kemi agjërim dhe ibadete të pranuar.

### MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E FONDACIONIT “SHEJH ZAYED”



Më 4 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Fondacionit “Shejh Zayed” të Emirateve të Bashkuara Arabe, në përbërje të z. Maxhid al Mansuri, znj. Aljae al Ubejdli, znj. Shejhata al Bulushi dhe znj. Menaal al Vahbi.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me punët dhe angazhimin e

BIK-ut, sidomos në fushën humanitare, të cilën e përfaqëson Shoqata “Bereqeti”, që vepron në kuadër të Kryesisë së BIK-ut. Ai falënderoi përfaqësuesit e Fondacionit për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që kanë treguar për popullin e Kosovës, e posaçërisht i falënderoi për kontingjentin me rroba që tash së fundmi kanë dërguar në Kosovë, e të cilat do t'i shpërndajë

“Bereqeti”. Ai shprehu gatshmërinë për një bashkëpunim me Fondacionin edhe në fusha të tjera.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Fondacionit, falënderuan Myftiun Tërnavë për pritjen, duke shprehur kështu gatshmërinë e tyre që të jenë gjithnjë prapë popullit të Kosovës, në çfarëdo forme që kërkohet një gjë e tillë.

### MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOORDINATORIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË VAKËFEVE, Z. MUSA ÇELEBIUN

Më 5 mars 2024, Myftiu Tërnavë, ka pritur në takim koordinatorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve pranë Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, z. Musa Çelebiun.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e njohu atë me punët dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai përmes tij falënderoi Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve për restaurimin e disa xhamive anekënd Kosovës. Myftiu po ashtu shprehu falënderimet e tij dhe të Shoqatës “Bereqeti”, e cila funksionon në kuadër të Kryesisë së BIK-ut për ndihmat e vazhdueshme që ka dërguar Drejtoria



e Përgjithshme e Vakëfeve për familjet nevojtare në Kosovë, që nga viti 2014.

Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për mundësinë e intensifikimit edhe më të madh të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe

Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë, në shenjë falënderimi për kontributin e kësaj Drejtorie, ndau për z. Musa Çelebiu një mirënjohje.

### MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DR. HASAN KAMIL YILMAZ

Më 6 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim dekanin e Fakultetit të Studimeve Islame të Universitetit “Sabahattin Zaim” të Stambollit, prof. dr. Hasan Kamil Yilmaz, i cili shoqërohej nga koordinatori i Fondacionit “Hudayi Vakfi”, z. Rafet Bilaq dhe koordinatorin e Shoqatës “Istanbul” në Kosovë, z. Suayip Bashan.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu me angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë me punët dhe aktivitetet e institucioneve fetar-arsimore të Bashkësisë Islame të



Kosovës, Medresesë “Alauddin” dhe Fakultetit të Studimeve Islame. Dekani Yilmaz, falënderoi Myftiun

Tërnavë për pritjen, duke shprehur kështu edhe urimet e tij për mandatin e ri të Myftiut Tërnavë.

## PËR NDER TË MUAJIT RAMAZAN NDRIÇOHET NJË PJESË E PRISHTINËS

Më 10 mars 2024, në prezencë të Myftiut Naim ef. Tërnavë, të kryetarit të Prishtinës, z. Përparim Rama dhe të një numri besimtarësh, janë ndezur dritat duke lajmëruar për fillimin e muajit të begatë Ramazan. Kjo pamje e bukur e qytetit të Prishtinës do të na shoqërojë gjatë gjithë muajit Ramazan.

Ky është viti i dytë që falë bashkëpunimit të Bashkësisë Islame të Kosovës me komunën e Prishtinës dhe donatorë, pjesa e vjetër e Prishtinës po stoliset për nder të muajit të Ramazanit.

Myftiu Tërnavë tha se kjo është një nismë e mirë, e cila do të vazhdojë edhe viteve të ardhshme. Ai falënderoi Komunën e Prishtinës për mbështetjen në realizimin e këtij projekti. Duke parë që numri i vizitorëve nga vende të ndryshme të botës po rritet çdo vit, Myftiu bëri me dije se shumë shpejtë do të angazhohet një ciceron për t'i orientuar ata dhe informuar lidhur me historikun e këtyre xhamive.



Kryetari Rama tha se me ndriçimin e kësaj pjesë të Prishtinës është krijuar një ambient i këndshëm për qytetarë e turistë të ndryshëm. Ai po ashtu foli

për karakteristikat e xhamisë së gurit që e bëjnë të veçantë dhe unike nga xhamitë e tjera në Evropë dhe botë.

## KRYETARI I AAK-SË, Z. RAMUSH HARADINAJ, SHTROI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Më 14 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, mori pjesë në iftarin që shtroi lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Me këtë rast, kryetari Haradinaj, theksoi se si vazhdimësi e pritjeve tradicionale në muajin e shenjtë Ramazan, në selinë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, iftari na bashkoi me Myftiun Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë dhe me partnerët e koalicionit Nisma, Lista Konservatore dhe Forumi E-30.

“Shpreha mirënjohjen për kontributin e çmuar që BIK ka dhënë në të gjitha etapat drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit, kontribut ky që vazhdon ta japë edhe sot. Agjërim të lehtë, begati dhe mirëqenie për çdo familje!” – u shpreh z. Haradinaj.



Myftiu Tërnavë duke falënderuar kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinaj për këtë iftar që tashmë është bërë tradicional, theksoi se BIK-u vazhdimisht punon që në

Kosovë të ketë harmoni e bashkëjetesë dhe respekt të ndërsjellë mes të gjithë njerëzve, pavarësisht dallimeve etnike dhe fetare që mund t'i kemi.

## U INAUGURUA PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E HURMAVE DHE IFTAREVE I ARABISË SAUDITE

Më 15 mars 2024, në ambientet e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, me një atmosferë vëllazërore, u inaugurua programi për shpërndarjen e hurmave dhe të iftareve i Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Në këtë eveniment morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Feisal Hefzi, hoxhallarë dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë, përmendi hadithin e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë se, nuk e ka falënderuar Allahun ai i cili nuk i ka falënderuar njerëzit, andaj, përmes ambasadorit, falënderoj mbretin e Arabisë Saudite dhe princin e kurorës për mbështetjen e vazhdueshme të dhënë për Kosovën në përgjithësi, por edhe për Bashkësinë Islame të Kosovës në veçanti. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur me shtetin



e Arabisë, duke shpresuar kështu që edhe projektet e së ardhmes të implementohen. Në fund të fjalës së tij, ai edhe njëherë shprehu mirënjohjen e thellë të tij dhe të institucionit që ai drejton për përkrahjen e vazhdueshme.

Ndërkaq në fjalën e tij, ambasadori z. Hefzi, tha se ne jemi në një organizim, i cili parasheh që të jemi pranë popujve që ne i kemi miq, andaj

kësaj radhe, ne në Kosovë, jemi me dy programe, atë të shpërndarjes së hurmave dhe të iftareve. Falënderojmë me këtë rast Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për mikpritjen që na e bën çdoherë.

Në fund të kësaj ceremonie, për të pranishmit u shtrua iftari i pari i këtij projekti.

## MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË KONFERENCËN “NDËRTIMI I URAVE NDËRMJET SEKTEVE ISLAME”

Më 18 mars 2024, në Meke të Arabisë Saudite, filloi punimet Konferenca Ndërkombëtare “Ndërtimi i urave ndërmjet sekteve islame”, e cila u organizua nga Liga e Botës Islame RABITA, nën patronatin dhe kujdesin e Kujdestarit të Dy Haremeve, mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud.

Në këtë Konferencë morën pjesë mbi 300 personalitete të larta islame nga e mbarë bota, myftinj dhe dijetarë të lartë, që përfaqësojnë doktrina dhe sekte të ndryshme islame. Kjo Konferencë, përmes takimeve vëllazërore, kishte për qëllim rritjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet sekteve islame, veçanërisht në çështjet që kërkojnë unitet të mendimit legjitim.

Konferenca gjithashtu synoi edhe ballafaqimin me narrativat, fjalimet, parullat dhe praktikatat e ekstremizmit sektar, të cilat nxisin konflikteve.



Përmes “Dokumentit për Ndërtimin e Urave ndërmjet Sekteve Islame”, një grup dijetarësh të lartë të botës islame, folën për një sërë temash shkencore.

Vizioni i kësaj Konference ishte arritja e vëllazërisë islame nën ombrellën e një ymeti, që bashkon

llojllojshmërinë e tij dhe arrin të mira e tij. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në këtë Konferencë, u shoqërua nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.



## MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA EMIRI I KATARIT

Më 18 mars 2024, me ftesë të emirit të Katarit, shejh Temim bin Hamad al Thani, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në iftarin e shtruar nga emiri i Katarit. Ky iftar u shtrua për nder të dijetarëve, gjyqtarëve dhe ylemave nga Katar dhe vende të tjera. Iftari u shtrua në pallatin mbretëror në Doha.

Në këtë iftar, pos kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, mysafirë nderi ishin edhe myftiu i Bosnjës, myftiu i Kroacisë dhe ai i Sllovenisë.



## MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRI PËR VAKËFE DHE ÇËSHITJE FETARE I KATARIT, GANIM BIN SHAHIN AL GANIMI

Më 20 mars 2024, me ftesë të emirit të Katarit, Temim al Thani, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, qëndroi për një vizitë zyrtare në Katar. Gjatë kësaj vizite, ai u prit në takim nga ministri për Vakëfe dhe Çështje Fetare, Ganim bin Shahin al Ganimi.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që edhe njëherë të falënderojë Qeverinë dhe popullin e Katarit për përkrahjen dhe ndihmën e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës dhe popullit të saj gjatë dekadave të fundit. Ai më pas e njohu ministrin me projektet dhe me sfidat që ka institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës. Një falënderim të veçantë, Myftiu Tërnavë e adresoi për ministrin Al Ganimi, për financimin e dy projekteve vakëfnore, atë në Gjilan dhe



në Lipjan. Gjatë këtij takimi, Myftiu paraqiti edhe projekte të reja të Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilat kanë nevojë për përkrahje.

Ministri Al Ganimi, falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për

bashkëpunimin e treguar deri më tani me Ministrinë. Ai premtoi se shumë shpejtë do të jetë për vizitë në Kosovë.

## KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT TË SAJ

Më 23 mars 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, nën kryesimin e kryetarit të saj, Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Në hapje të kësaj mbledhje, Myftiu Tërnavë, falënderoi Zotin për begatitë dhe nimetet që na i ka dhënë, duke lutur Atë për pranim të agjërimit dhe

të ibadeteve që i bëjmë gjatë muajit të bekuar Ramazan.

Kryesia e BI-së në këtë mbledhje shqyrtoi dhe miratoi raportin e Kryesisë për vitin 2023, shqyrtoi dhe miratoi pasqyrën financiare për vitin 2023, si dhe shqyrtoi dhe miratoi llogarinë përfundimtare të këshillave të BI-së për vitin 2023.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutua edhe për përgatitjet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të BI-së së Kosovës, si dhe u shqyrtuan lëndë të ndryshme dhe u morën vendime në bazë të kompetencave të kësaj Kryesie.

## KRYETARI I LDK-SË SHTROI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Më 26 mars 2024, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhiku, së bashku me bashkëpartiakët e tij, ka shtruar iftar për Myftiun Tërnavë dhe për bashkëpunëtorët e tij.

Kryetari Abdixhiku e ka cilësuar muajin Ramazan, si muaj të durimit, mirësisë, mikpritjes e solidaritetit. “Muaji i durimit, mirësisë, mikpritjes e solidaritetit, na mëson disa nga vlerat më të shëndosha shoqërore. Këto vlera duhet t’i ruajmë e kultivojmë me plot përkushtim, si bindje tona shpirtërore, si virtyte tona. Agjëruesve ju uroj praninë të sakrificës e lutjeve nga Zoti. U shkoftë mbarë dhe pjesa e mbetur e



Ramazanit!” – thuhet në postimin e publikuar nga kryetari Abdixhiku.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin Abdixhiku për

shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu se iftaret duhet gjithnjë të na shërbejnë për afim ndërmjet vete.

## MYFTIU I KOSOVËS SHTROI IFTARI PËR NDER TË FITORES SË BEDRIT



Më 27 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë edhe këtë vit ka shtruar iftar për administratën e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ky iftar, tashmë tradicional, shtrohet në çdo muaj Ramazan, në Ditën e Fitores së Bedrit.

Myftiu i Kosovës, falënderoi administratat e këshillave të Bashkësisë Islame, si dhe imamët për punën që po bëjnë, në veçanti në Ramazan.

“Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame, dëshiroj t’ju falënderojë të gjithë juve pa asnjë dallim, për mundin për sakrificën dhe për gatishmërinë për të qenë me xhematin dhe për t’i orientuar në rrugën e drejtë.”

Në çastet e iftarit, Myftiu i Kosovës, bëri dua që në çdo vend të botës të mbretërojë paqja dhe harmonia.

“Në botë kemi 110 konflikte të hapura, gjë që për shoqërinë njerëzore është një alarm se njerëzit duhet të

ulen rreth tryezës që në botë të dominojë paqja, humaniteti dhe të pushojnë të gjitha luftërat. Edhe sonte këtu lutemi për vëllezërit në Gaza që Zoti t’i shpërblejë me të mirat e tij dhe lutjet e tyre të pranohen.”

Po ashtu, nga Myftiu i Kosovës u potencuan me shqetësim rastet e fundit që po ndodhin në Kosovë të vrasjeve dhe vetëvrasjeve.

## KRYETARI I PDK-SË, MEMLI KRASNIQI, SHTROI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Më 29 mars 2024, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqi, shtroi iftar për Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij. Në postimin e kryetarit Krasniqi në Facebook, ai përmendi vlerat që përfaqëson ky muaj, si durimi, solidariteti, respekti dhe uniteti.

“Sonte, kisha kënaqësinë të shtroj iftar për Myftiun Naim Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij nga Bashkësia Islame e Kosovës, në shenjë nderimi dhe respekti për muajin e bekuar të Ramazanit. Vlerat që përfaqëson ky muaj, si durimi, solidariteti, respekti dhe uniteti, janë vlera të cilat duhet t’i çmojmë dhe për të cilat kemi shumë nevojë sot si individë e si shoqëri.”



Ai dha mesazhin për mbështetje të njëri-tjetrit në rrugë e punë të drejta e të frytshme.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin Krasniqi për shtrimin

e këtij iftari, duke shprehur kështu përkushtimin e tij dhe të institucionit që ai drejton për të bashkëpunuar për punë të mira e të mbara.

## KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVË MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 30 mars 2024, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i Kuvendit të BIK-ut, dr. Ajni ef. Sinani. Mbledhja filloi me lexim të Kuranit, e më pas u vazhdua me pikat e rendit të ditës, të cilat pas shqyrtimit, u miratuan të gjitha.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij, foli për gjendjen e përgjithshme të organizimit fetar në Kosovë. Në veçanti foli për përgatitjet për muajin Ramazan dhe festës së Fitër Bajramit.

Gjatë kësaj mbledhje anëtarët e Kuvendit shqyrtuan dhe u miratuan Raporti i Punës së Kryesisë së



Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin 2023, Raportin e Komisionit Financiar si dhe u shqyrtuan dhe miratuan pasqyra e të hyrave dhe të dalave të Kryesisë.

Po ashtu, në këtë mbledhje të Kuvendit u shqyrtuan edhe çështje të tjera, të cilat u ngritën nga anëtarët e Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

## MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN MADHËSHTOR NË DEÇAN

Më 30 mars 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin madhështor, i cili u mbajt në Deçan. Në këtë iftar, përveç qytetarëve të shumë, pjesëmarrës ishte edhe

kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe kryetari i Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë, përmendi vlerat fetare dhe kombëtare që i kemi ne si popull.

Ai tha se përkundër që si popull kemi tri fe e besime të ndryshme, populli ynë asnjëherë nuk ka pasur asnjë konflikt ndërfetar ndërmjet vete. Myftiu Tërnavë shprehu konsideratën e tij të thellë për të gjithë ata që kontribuuan në çfarëdo forme për

çlirimin e vendit. Ai luti Zotin që dëshmorët që dhanë jetën për lirinë e këtij vendi, Zoti t'i shpërblejë me të mirat e Tij në Xhenet, duke përmendur kështu argumentet fetare se ata janë të gjallë, por që në gjallërinë e tyre nuk e kuptojmë. Një falënderim të veçantë Myftiu Tërnavë ua dedikoi të gjitha nënave e motrave tona, të cilat kanë sakrifikuar çdo gjë nga vetja e tyre për lirinë e Kosovës. Ai tha se nëse dikush meriton që t'i ngrihet një lapidar, atëherë ato janë nënat tona, të cilat ai i quajti heroina të gjalla.

Ndërkaq kryetari i Deçanit, z. Bashkim Ramosajt, shprehu mirënjohjen e thellë për Bashkësinë



Islame të Kosovës, për kontributin e drejtë lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë.

### KRYETARI I PD-SË SHTRUI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ

Më 31 mars 2024, kryetari i Partisë së Drejtësisë, dr. Ferid Agani, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka shtruar iftar për Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij.

“Në nderim të kontributit të jashtëzakonshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës në shtetëformimin dhe shtetëndërtimin e vendit dhe në veçanti festimit të devotshmërisë së përbashkët gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit ndaj Zotit të Madhërishëm, shtrova iftar për Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij nga Bashkësia Islame e Kosovës” – thuhet në postimin e Partisë së Drejtësisë.

Ndër të tjera në postimin e tyre, thuhet se muaji Ramazan bashkon shpirtrat, mendjet e zemrat e atyre që vlerat etike dhe morale të familjes i



shohin në themelet e shoqërisë dhe funksionimit të institucioneve shtetërore.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Agani për shtrimin e këtij iftari, duke

thënë se ashtu siç na bashkon sofrë e iftarit ndërmjet vete, ashtu duhet të jemi bashkë gjithnjë, për të mirën e të gjithëve.

### KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KRYEIMAMËT E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 5 mars 2024, në prag të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka mbajtur një takim me kryeimamët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Fillimisht kryeimami Sahiti falënderoi kryeimamët për punën dhe angazhimin e tyre që janë duke e dhënë gjithandëj këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe më

pas shpalosi para tyre platformën e aktiviteteve të Ramazanit, të miratuar më parë, në mbledhjen e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe qarkoren e Ramazanit të Kryesisë drejtuar të gjitha këshillave të BI-së.

Kryeimami Sahiti gjatë takimit kërkoi nga kryeimamët përkushtim edhe më të madh në punë, sidomos gjatë këtij muaji të bekuar, ngase ky është amaneti që e kemi marrë mbi

supet tona, amaneti i kumtimit të drejtë të fjalëve të Zotit dhe mësimëve të Pejgamberit a.s..

Më pas, kryeimami Sahiti, theksoi nevojën e bashkëpunimit të kryeimamëve me imamët dhe xhematët e tyre në terren, për të plotësuar nevojat e besimtarëve. “Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional është çelësi i suksesit”, theksoi mes të tjerash kryeimami Sahiti.



Gjatë takimit u debatuan edhe çështje të tjera me interes, e sidomos në fushën e mësim-besimit, ku muaji Ramazan është një mundësi e artë për të shfrytëzuar për edukimin e brezave të rinj.

Në fund të takimit, kryeimami Sahiti u uroi muajin e bekuar Ramazan të gjithë kryeimamëve, duke u lutur për shëndetin e tyre, të familjeve e të gjithë besimtarëve kudo që janë.

### **PËRFAQËSUESIT E KRYESISË SË BI-SË PËRCOLLËN MESAZHET PËR FILLIMIN E MUAJIT RAMAZAN**

Më 8 mars 2024, në prag të fillimit të muajit Ramazan, përfaqësuesit nga Kryesia e BI-së, Medreseja “Alauddin” dhe Fakulteti i Studimeve Islame, përçuan mesazhet për fillimin e muajit Ramazan në këshillat e BI-së: Prishtinë, Prizren, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Ferizaj dhe Fushë Kosovë.

Ata përcollën urimet dhe përgëzimet e Myftiut Tërnavë për fillimin e muajit Ramazan, duke përcjellë kështu mesazhet për paqe, solidaritet, unitet dhe ndihmë ndaj njëri-tjetrit.

Këto mesazhe i përcolli edhe sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, prof. Ahmet ef. Sadriu, i cili mbajti hytben e xhumasë në xhaminë “Sulltan Mehmet Fatih” në Prishtinë. Ai tha se muaji Ramazan duhet të na shërbejë edhe më tepër për afrim dhe ndihmë të njërit-tjetrit. “Ramazani është një shkollë e cila na bënë më bujarë, më



solidarë dhe më të afërt me njëri-tjetrin. Ta shfrytëzojmë këtë muaj me shtim të ibadeteve dhe adhurimeve, e në fund të tij të dalim fitimtarë e të pastruar nga mëkatet” – shtoi mes të tjerash sekretari Sadriu.

Ekipet e Ramazanit nga Kryesia e BIK-ut, Fakulteti i Studimeve dhe Islame në Prishtinë dhe Medreseja

“Alaudin”, përgjatë muajit Ramazan vizituan një mori xhamishë e xhematesh në të gjitha komunat e Kosovës, ku përmes hytbeve të xhumasë, ligjëratave para namazit të teravisë, dhe duke iu pri xhemateve në faljen e këtyre namazeve, sollën freski te besimtarët.

### **PËRFAQËSUESIT E FONDACIONIT “SHEJH ZAYED” SOLLËN DHURATA PËR FËMIJËT E SHTRIRË NË SPITALIN E PEDIATRISË NË QKUK**

Më 4 mars 2024, përfaqësuesit e Fondacionit “Shejh Zayed” të Emirateve të Bashkuara Arabe, së bashku me drejtorin e Shoqatës Humanitare “Bereqeti”, Behxhet ef. Ajvazin, kanë vizituar spitalin e Pediatrisë “Sheikha Fatima”, ku u

pritën nga zëvendës-drejtori i QKUK-së, z. Osman Hajdari, si dhe nga drejtoresha e klinikës së Pediatrisë, znj. Violeta Grajçevci.

Gjatë takimit me zv.drejtorin e QKUK-së dhe drejtoreshën e klinikës,

u diskutua për nevojat e klinikës, si dhe për mundësinë e përmirësimit të kushteve për trajtimin e pacientëve.

Drejtoresha e klinikës, znj. Grajçevci, falënderoi për bashkëpunimin që kanë pasur në ndërtimin e klinikës, si dhe



më pas, i njohu mysafirët me punët që kryhen në këtë klinikë. Po ashtu u dakorduan që të bashkëpunojnë edhe më tutje në sjelljen e pajisjeve të ndryshme për këtë klinikë dhe klinika të tjera.

Gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e Fondacionit “Shejh Zayed”, fëmijëve pacientë të shtrirë në këtë klinikë, u dhuruan veshmbathje dhe produkte të ndryshme.

## “BEREQETI” SHTROI IFTAR NË SHESHIN “ADEM JASHARI” NË PRISHTINË

Më 16 mars 2024, në sheshin “Adem Jashari” në Prishtinë, u shtrua iftar madhështor, tashmë tradicional për mbi 800 persona nga të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Ky iftar i përbashkët, organizim i Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti” dhe organizatës “Swiss Barakah Charity” mbledhi në një vend qytetarë të shumtë, të cilët pavarësisht motit me shi e shijuan bashkërisht iftarin.

Drejtori i Bereqetit, Behxhet Ajvazi, foli rreth organizimit të iftari duke falënderuar të gjithë ata që kontribuan për këtë iftar.

Kurse përfaqësuesi i “Swiss Barakah Charity”, z. Ardian Mehmeti, foli rreth bashkëpunimit me Shoqatën “Bereqeti” dhe tha se shtrimi i iftareve do të organizohet edhe në komuna të tjera të vendit.



Përfaqësuesja e Shoqatës së Grave për Aktivitete Sociale dhe Këshillime Psikologjike, znj. Sabrie Rexhepi, falënderoi Shoqatën “Bereqeti” për mbështetjen e vazhdueshme. Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” me

bashkëpunëtorë gjatë gjithë muajit Ramazan do të shpërndajë ndihma për nevojtarë, si dhe do të organizojë iftare në shumë komuna të vendit.

## DELEGACIONI I KRYESISË SË BI-SË QËNDROI PËR VIZITË NË DIASPORË

Për nder të muajit të bekuar Ramazan, një delegacion i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i përbërë nga drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, kryeimami Vedat ef. Sahiti, anëtarët e Kryesisë, Agim ef. Hyseni, Orhan ef. Bisliraj, Valon ef. Myrta, Sylejman ef. Fejzullahu dhe nga Florentina Tërnkolli e Merita Boroci,

nga data 14 mars deri më 18 mars 2024, qëndruan për vizitë zyrtare në Zvicër.

Delegacioni fillimisht vizitoi Konsullatën e Kosovës në Cyrih, në të cilën u mirëpritën nga udhëheqësi i misionit, z. Vigan Berisha. Gjatë këtij takimi u bisedua për mundësinë e

koordinimit të mësimin të rregullt të gjuhës shqipe nëpër të gjitha qendrat shqiptare.

Më pas, delegacioni, u shpërnda nëpër xhamitë të ndryshme shqiptare, ku u pritën nga përfaqësuesit e këtyre xhamive dhe nga xhamatë të shumtë. Ata përcollën përshëndetjet dhe

urimet për muajin e bekuar Ramazan nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe nga Myftiu Tërnavë, si dhe më pas në kohë të ndryshme mbajtën ligjërata rreth vlerës së muajit të bekuar Ramazan. Ata falënderuan diasporën shqiptare myslimane për mikpritjen e ngrohtë, duke lutur Zotin e Madhëruar që t'i shpërblejë me të mirat e Tij. Diaspora shqiptare, sipas tyre, ka qenë gjithnjë pranë nevojave dhe kërkesave jo vetëm të familjeve të tyre në Kosovë, por edhe të Bashkësisë Islame të Kosovës, andaj në emër të të gjithë delegacionit, drejtori për Diasporë në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, falënderoi të gjithë ata të cilët çdoherë kanë qenë pranë kërkesave të BIK-ut, duke shpresuar kështu që një bashkëpunim i mirë i deritanishëm të vazhdojë edhe në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e besimtarëve tanë. Drejtori Simnica, më pas falënderoi edhe kryetarin e KMSHz-së, Mehas ef. Alija, për mikpritjen dhe për organizimin e kësaj vizite.



Në vazhden e këtyre aktiviteteve dhe vizitave, një delegacion i përbërë nga dekan i FSI-së, dr. Islam Hasani, anëtari i Kryesisë së BIK-ut, Sevdair ef. Haxhiu dhe nga profesori Jakup ef. Çunaku, qëndroi për vizitë në Austri. Ata fillimisht u mirëpritën nga udhëheqësi i ALKIG-ut, z. Vahidin Behluli, të cilin e falënderuan për pritjen dhe për organizimin. Ata më pas u shpërndanë nëpër xhamitë shqiptare në Austri, ku përcollën

mesazhe islame për paqe, harmoni dhe afrim të Zoti ynë. Ata shprehën një falënderim dhe një mirënjohje të veçantë për punën që janë duke bërë xhamitë shqiptare në diasporë për ruajtjen e trashëgimisë sonë fetare dhe vlerave tona familjare e kombëtare.

Vlen të përmendet se ky delegacion ka vizituar 41 xhami në Zvicër dhe 16 të tjera në Austri.

## KËSHILLI I BI-SË DHE KUVENDI KOMUNAL I OBILIQIT ORGANIZUAN TRIBUNË DHE IFTAR PËR NDER TË MUAJIT RAMAZAN

Më 30 mars 2024, KBI në Obiliq, në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Obiliqit, organizuan tribunë, dhe më pas edhe iftar me qytetarë në sheshin e qytetit.

Aktiviteti i mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri", filloi me fjalën përshëndetëse të organizatorit që e mbajti kryeimami i Këshillit, Izedin ef. Krasniqi, e më pas, në emër të bashkëorganizatorit, të pranishmit i përshëndeti kryetari i Komunës, z. Xhafer Gashi.

Të pranishmëve iu drejtua Ahmet ef. Sadriu, sekretar i Përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili i përshëndeti ata në emër të Kryesisë dhe Myftiut të Kosovës. Ai në fjalën e tij foli në pika të shkurtra për rëndësinë e muajit Ramazan dhe dhjetë netëshit të fundit të tij, ku mes të tjerash theksoi rëndësinë e bamirësisë dhe kontributeve të qytetarëve në mbarëvajtjen e aktivitetit të institucionit kompetent




për jetën fetare, pra Bashkësisë Islame të Kosovës.

Fjalimin qendror të paraparë në program e mbajti imami i qytetit, njëherësh edhe kryetar i KBI-së në Obiliq, Rexhep ef. Qerkezi.

Ai foli për rëndësinë e këtyre netëve, e sidomos për veçoritë e Natës së Kadrit, që është nata më e veçantë e

vitit për nga vlera dhe shpërblimet që Allahu xh.sh. i dhuron besimtarëve në të.

Pjesa e dytë e këtij manifestimi filloi me homazhet dhe lutjet të pllaka përkujtimore e dëshmorëve të Obiliqit, ndërsa më pas programi vazhdoi me iftarin në qendër të qytetit, i cili ishte organizuar për mbi 1200 qytetarë.



**Bashkësia Islame  
e Republikës së Kosovës**

# ZEKATI DHE SADAKATUL FITRI 2024

Peigamberi, a.s., e bëri obligim ZEKAT (SADAKATUL) FITRIN si pastrim për agjëruesin për fjalët e këqija,  
dhe ushqim për të varfrit. Prandaj, kush e jep para namazit (të Bajramit), ajo është sadaka e pranuar,  
e kush e jep pas namazit, konsiderohet sadaka e rëndomtë!

## PAGESAT MUND T'ËBËNI:

1. Në zyrat e këshillave të BIK-ut
2. Në secilën xhami të Kosovës
3. Në adresën bankare:

Bashkësia Islame e Kosovës  
NLB-Prishtina

Account no. & IBAN:

XK05 1700200100103672

SWIFT Code (BIC): NLPRXXKPR

3  
euro

5  
euro

10  
euro

4. dhe përmes platformës  
**Paypal.me/BIKFITRA**





**DITURIA ISLAME • Nr. 401 MARS 2024**